

MLLADEN JOVANOVIQ MANUAL PËR APLIKIMIN E STANDARDEVE PËR MBLEDHJEN E FONDEVE



SIGN
for
Sustainability

B | T | D

The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

This project has been financed by the European Union and co-financed by
Balkan Trust for Democracy

Copyright ©

FONDACIONI TRAG

Botues origjinal

SOUTH-EAST EUROPEAN INDIGENOUS GRANTMAKERS NETWORK (SIGN)

Botues Kontakti

TRAG FONDACIJA

Đevđelijska 19, PAK 145319 Beograd, Srbija

www.tragfondacija.org

e-mail: filantropija@tragfondacija.org

Për botuesin

BILJANA DAKIĆ ĐORĐEVIĆ

Editor

MARIJA MITROVIĆ

Kontakti për Kosovë

FORUMI PËR INICIATIVA QYTETARE (FIQ).

Lagjja Pejton, Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 20, Nr. 3

www.fiq-fci.org

Email: info@fiq-fci.org

Përkthimi në Shqip

TRANSLATION CENTRE

Redaktimi/Lektorimi në shqip

ARIETA DRAGUSHA

Përgatitja teknike dhe dizajni i kopertinës

KORAK STUDIO

KOSTA RAKIĆEVIĆ

NINA HADŽIVUKOVIĆ

Shtyp


GRAFIČKI CENTAR, ČAČAK

Tirazhi

300 COPË

Prishtinë, 2015

PËR RRJETIN SIGN



SIGN – Rrjeti i fondacioneve të pavarura në Evropën Juglindore është themeluar në vitin 2009 me qëllim të promovimit dhe mbështetjes së zhvillimit të filantropisë, komuniteteve lokale, partneriteteve ndërsektoriale dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të shoqërisë civile në Evropën Juglindore në nivel lokal, nacional, regional dhe të Bashkimit Evropian, me përfaqësim për kornizë më të mirë legjislativë, hulumtim, mbledhje, shkëmbim, promovim dhe nxitje të praktikave të mira në këto fusha.

Rrjeti SIGN përbëhet nga **Fondacioni Trag** (Trag fondacija - Serbi), **Fondacioni Mozaik** (Fondacija Mozaik – Bosnje dhe Hercegovinë), **Fondi për qytetari aktive** (Fond za aktivno građanstvo – fAKT – Mali i Zi), **Forumi për Iniciativa Qytetare – FIQ** (Kosovë), **HORUS** (Maqedoni) dhe Fondacioni

nacional për zhvillimin e shoqërisë civile (**Nacionalna zaklada za razvoj civilnoga društva** - Kroaci). Ky doracak është hartuar në kuadër të projektit “**SIGN për qëndrueshmëri**”, i cili ka për qëllim të kontribuojë në qëndrueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile dhe fuqizimin e ndikimit të tyre në procesin e demokratizimit në Ballkanin Perëndimor, përmes ndërtimit të ambientit më të favorshëm për zhvillimin e filantropisë dhe kontributeve për të mirën e përgjithshme, nxitjen e punës më transparente në organizatat e shoqërisë civile dhe mbledhjen e mjeteve në komunitetet lokale si dhe përfshirjen e një numri më të madh të qytetarëve dhe partnerëve lokal në nismat me rëndësi publike. Ky projekt realizohet në 6 vende të regjionit në kohëzgjatje prej 4 vjetësh dhe mbështet nga Bashkimi Evropian dhe Fondi Ballkanik për Demokraci.

Më shumë informata për rrjetin SIGN dhe aktivitetet në kuadër të projektit “**SIGN për qëndrueshmëri**” www.sign-network.org
Më shumë informata për qasje në Standardet për mbledhjen e fondeve <http://www.sign-network.org/standards-for-fundraising>

PËRMBAJTJE

HYRJE 8

Si përdoret ky manual?	14
Kujt u dedikohen Standardet dhe për çka shërbejnë?	16
Kur përdoren Standardet dhe si?	18

PARIMET NË MBLEDHJEN E FONDEVE 22

Standardet për mbledhjen e fondeve – dokumenti plotë	24
Parimi 1. Misioni, vlerat, parimet dhe objektivat strategjike të OSHC-ve, legaliteti dhe legjimiteti	28
Parimi 2. Llogaridhënia dhe transparenca	34
Parimi 3. Komunikimi i qartë, i hapur dhe transparent	38
Parimi 4. Parandalimi i keqpërdorimit të fondeve dhe pasurisë, masat në rast të keqpërdorimit	42
Parimi 5. Transparenca dhe komunikimi i hapur në procesin e mbledhjes së fondeve	48
Parimi 6. Shfrytëzimi i përgjegjshëm, efikas dhe efektiv i donacioneve të marra	52
Parimi 7. Menaxhimi i fondeve në rast të ndërprerjes së mbledhjes për shkak të forcës madhore, të mbledhjes të sasisë më të vogël apo më të madhe se sa ishte planifikuar	56
Parimi 8. Respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të përfituesve në mbledhjen e fondeve	62
Parimi 9. Informimi i përdoruesve për mbledhjen e fondeve	68
Parimi 10. Përfshirja e përfituesve në procesin e përcaktimit të qëllimit të mbledhjes së fondeve	72
Parimi 11. Informimi i donatorëve për mënyrën në të cilën përdoret donacioni	76
Parimi 12. Vlerësimi i kontributit të donatorëve dhe trajtimi i informacioneve në lidhje me donatorin	80

MATRICA E AKTIVITETEVE 84


Vlerësimi i kompleksitetit	87
Vlerësimi i nevojave financiare	88

MIRATIMI DHE ZBATIMI 100

Zhvillimi organizativ - Segmenti programor	104
Puna me shfrytëzues	106
Puna me donatorë	109
Informimi i palëve të interesuara dhe i opinionit	118
Zhvillimi organizativ– Burimet dhe kapacitete njerëzore dhe materiale	122
Zhvillimi organizativ–Menaxhimi dhe administrimi i financave dhe administratës	126
Monitorimi dhe vlerësimi	133

HYRJE

1. **HYRJE**
2. Si përdoret ky *manual*?
3. Kujt u dedikohen **Standardet** dhe për çka shërbejnë?
4. Kur përdoren **Standardet** dhe si?



HYRJE

Sa njerëz, po aq edhe teke. Secili, në mënyrën e vet, kërkon rrugën e vet drejt lumturisë, drejt arritjeve në jetë, për të cilat është i interesuar. Kemi të bëjmë me përcaktues të rëndësishëm të lirisë në jetën e njerëzve, pse jo edhe në organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Megjithatë, si të sigurohet që liria e tillë të mos kthehet në anarki të plotë në të cilën pikërisht më të fuqishmit janë në njëkohësisht edhe “më të lirët”?

Në rrugën drejt realizimit të qëllimeve të veta, njeriu has edhe në njerëz të tjerë, në synimet e tyre dhe rrugën e tyre drejt lumturisë. Për këtë arsye është e nevojshme të merremi vesh – si do të sigurojmë që edhe njëra, edhe pala tjetër të kenë gjasa të barabarta për të pasur sukses në rrugën e vet, por duke mos i dëmtuar të tjerët?

Nga ana tjetër, rreth një synimi nuk kemi mospajtim – të gjithë e synojmë zhvillimin. Të gjithë dëshirojmë të zhvillohemi, të rritemi, të kemi sukses. Mirëpo, çka do të thotë zhvillimi për

Quot homines, tot sententiae.

secilin prej nesh? A jemi të sigurt se mendojmë për të njëjtën gjëkur e shqiptojmë atë fjalë aq shumë të përdorur, ndoshta ngapak edhe të tepruar – *zhvillim*?

Në çdo profesion në botë, të ballafaquar me dilemën se çka është puna e kryer në mënyrë cilësore dhe si të matet ajo cilësi, kthesa e rëndësishme në zhvillim është shënuar gjithmonë me një lloj standardizimi. Shumë më herët se standardi ISO, ka ekzistuar një numër i madh i kodekseve, ujdive, memorandumëve dhe i dokumenteve të tjera që rregullonin standardet e punës dhe të sjelljes së një profesioni. Në këtë mënyrë, profesionet mbroheshin nga konkurrenca jo lojale, ndikimet negative të sunduesve ose i kanë zhvilluar marrëdhëniet me klientët dhe përdoruesit e tyre.

Ishte pikërisht procesi i standardizimit mbështetësi kryesor i zhvillimit të profesioneve dhe veprimtarive, si në aspektin e cilësisë së mallrave dhe të shërbimeve të ndryshme, ashtu edhe në pikëpamje të zhvillimit të raporteve në mes të njerëzvetë interesuar për këto procese, mallra dhe shërbime.

Standardet për mbledhjen e fondeve nxirren me një qëllim të ngjashëm – që përmes përcaktimit të parimeve, sjelljeve dhe mënyrës së dëshirueshme të punës, t'i kontribuohet zhvillimit të shoqërisë civile në hapësirat e Ballkanit Perëndimor. Pa qëllimin që të pengohet kërkimi i “rrugës vetanake” deri tek sukcesi, këto standarde shërbejnë si udhëzues, si prijës të vlefshëm dhe praktik në punën e OSHC. Duke i respektuar këto parime, OSHC-të ndërtojnë raporte cilësore me qytetarë dhe donatorë, ndërtojnë raport mirëbesimi me përfutuesit e tyre, me grupet e synuara, me bazën dhe me OSHC-të e tjera.

Duke respektuar dhe promovuar këto parime, shoqëria civile promovon përgjegjësinë përmes shembullit vetanak, i forcon lidhjet dhe mirëkuptimin në mes të përfutuesve të vet (të njerëzve problemin e të cilëve e zgjidhim apo nevojave të të cilëve u dalim në ndihmë) dhe donatorëve (njerëzit, organizatat dhe institucionet që dëshirojnë që me donacionet e tyre të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve).

Procesi i krijimit të standardeve për mbledhjen e fondeve ka qenë inkluziv, i udhëhequr nga ana e 5 fondacioneve në territorin e 5 shteteve, si dhe ka përfshirë mbi 400 OSHC në fazën e formulimit, si dhe 25 ekspertë të kësaj fushe, të cilët kanë dhënë komentet dhe mendimet e tyre. Përmes disa rrathëve të konsultimeve të mbajtura në Zagreb, Sarajevë, Podgoricë, Budvë, Beograd, Nish, Prishtinë dhe Shkup, është nxjerrë teksti përfundimtar i Standardeve, që deri në shtator 2015 është nënshkruar nga 130 OSHC nga 6 shtete të rajonit. Pritet që numri i organizatave nënshkruese të rritet në periudhën e ardhshme.


Ndoshta më e rëndësishme se masiviteti i kësaj iniciative të shoqërisë civile është çështja e aplikimit të këtyre standardeve. Kur kemi të bëjmë me vetë rregullimin e OSHC-ve, parashtrohet pyetja: si të sigurohet aplikimi i standardeve në nivel të organizatave nënshkruese? A mjafton që vetëm të nënshkruhen dhe promovohen këto standarde? Natyrisht se jo. Ky manual është krijuar si udhërrëfyes, përkujtues për OSHC-të se çka mund të bëjnë

vetë që t'i aplikojnë në masë sa më të madhe standardet dhe parimet e mbledhjes së fondeve në punën e tyre të përditshme.

Nevojitet të theksohet që në fillim se standardet nënkuptojnë se mbledhja e fondeve është e mundur nga burime të ndryshme – si nga donatorëndërkombëtare dhe vendorë, po ashtu edhe nga individë/e, nga kompani dhe institucione. Parimet janë përpunuar me idenë që në mesin e donatorëve mund të shfaqen vërtetë të gjithë këta akterë. Parimet e përkufizuara kështu vëjnë njësoj për të gjitha burimet e financimit për OSHC-të.

Me aplikimin e Standardeve për mbledhjen e fondeve, OSHC-të nuk e humbin lirinë e tyre. Përkundrazi, bëhen më të fuqizuara që me punën e tyre të arrijnë rezultate më efektive të cilat i synojnë, t'i shpenzojnë në mënyrë më efektive fondet e mbledhura dhe të vendosin raport të respektimit dhe të mirëbesimit me të gjithë akterët në punën e tyre.

Aplikimi i Standardeve është rruga përmes së cilës OSHC-ja realizon lirinë në punën e vet, duke respektuar nevojat dhe punën e organizatave të tjera, të përfituesve dhe donatorëve të vet.



SI PËRDORET KY MANUAL?

Manuali është i ndarë në 5 tërësi:

1. HYRJE.

Hyrja mundëson mbikëqyrjen në përbajtjen e tërë manualit. Aty do të gjeni edhe përbajtjen e plotë të Standardeve, si dhe përshkrimin kur dhe si aplikohen parimet e mbledhjes së fondeve. Shikoni listën e situatave më të shpeshta në të cilat ky manual mund të jetë i dobishëm.

2. PARIMET E MBLEDHJES SË FONDEVE.

Në këtë pjesë është dhënë sqarimi më i hollësishëm i çdo parimi, si dhe arsyetimi për ç'arsye është miratuar parimi. Përshkrimi i çdo parimi përmban shembullin e praktikës së mirë të aplikimit të parimeve, si dhe rreziqet potenciale dhe reale që dalin nga mosaplikimi i parimeve. Ky

kapitull do të paraqesë edhe aplikimet dhe përvojat konkrete të OSHC-ve, pa përmendur emrat e organizatave dhe të akterëve të tjerë në rastet e përshkruara.

3. MATRICA E AKTIVITETEVE.

Në këtë kapitull do të gjeni të gjitha aktivitetet e mundshme të cilat mund t'i ndërmerrni për të aplikuar parimet e mbledhjes së fondeve. Ky kapitull thekson tërë kompleksitetin e secilit aktivitet, shpenzimet që i bartin aktivitetet e tilla, si dhe lidhjen e aktivitetit dhe të secilit nga 12 parimet e Standardeve.

4. MIRATIMI DHE APLIKIMI I PARIMEVE.

Në këtë kapitull janë dhënë këshillat më të hollësishme, praktike se çka mund të bëjë OSHC-ja për ta miratuar një parim të caktuar dhe realisht edhe aplikuar atë parim në punën e vet. Kemi të bëjmë me aktivitetet e përshkruara hollësisht nga matrica e aktiviteteve. Të gjitha aktivitetet janë ndarë në fusha, në mënyrë që ta gjeni më lehtë atë që u intereson dhe që të mund të përcillni "kronologjinë" e dëshirueshme të aplikimit në organizatën tuaj. Natyrisht, bëhet fjalë për rekomandimet nga të cilat

secila OSHC mund të përzgjedh atë që e konsideron se i nevojitet më së tepërmi dhe që është më reale për të në momentin konkret. Nuk është reale të pritët që organizatat e mëdha dhe të vogla t'i aplikojnë këto rekomandime në mënyrë të njëjtë, mirëpo botuesit e Manualit i kanë kushtuar kujdes asaj që këshilla/rekomandime të dobishme mund të gjejnë edhe njëriedhe grupi tjetër.

5. BAZA "ON-LINE".

Këtu do të gjeni një numër të madh të shembujsh, dokumente të dobishme, udhëzime dhe udhërrëfyes të mbledhjes nga e tërë bota.

Kapitujt mund t'i lexoni me radhë dhe përtej radhës. Manuali është i organizuar ashtu që në mënyrë të thjeshtë dhe të lehtë mund të gjeni pikërisht atë që u intereson. Bie fjala, po qe se kërkonti më shumë informacione për parimin 3, do t'u mjaftojë plotësisht që në kapitullin 2 të lexoni përshkrimin vetëm të këtij parimi, në kapitullin 3 lehtë do të mund të gjeni listën e plotë të aktiviteteve të cilat i kontribuojnë realizimit të këtij parimi, kurse pastaj në kapitullin 4 – detajet dhe këshillat lidhur me atë se si të aplikohen këto aktivitete.

Aplikimi i standardeve brenda një organizatenuk është çështje e vendimit të liderit të organizatës. Këtu kemi të bëjmë me një proces që kërkon kohë dhe përkushtimin e tërë ekipit të një OSHC-je. Mbledhja e fondeve mbulon numër të madh të aktiviteteve të ndryshme dhe, deshën apo jo, në të vërtetë të gjithë anëtarët e OSHC-së tuaj janë pjesë e këtij procesi. Madje, edhe po qe se vullnetari i OSHC-së tuaj nuk është në gjendje për ta përfaqësuar mirë organizatën apo qee përfaqëson madje krejtësisht gabimisht punën e saj në opinion, kjo mund të ndikojë në sukses apo mos sukses në mbledhjen e fondeve. Për këtë arsye, të gjithë ju që sinjerisht dëshironi t'i aplikoni këto standarde, pranojeni këshillën dashamirëse – në procesin e miratimit dhe të aplikimit të Standardeve shikoni shkallë-shkallë, duke e përfshirë tërë ekipin.

KUJT U DEDIKOHEN STANDARDET DHË PËR ÇKA SHËRBEJNË?

Standardet u dedikohen të gjithë atyre që mbledhin fonde për t'i realizuar idetë e tyre jo fitimprurëse dhe jashtë partiake. Mund të jenë këto shoqata të ndryshme të qytetarëve, asociacione, federata, fondacione, fonde bamirësie, madje edhe grupe joformale. Mbledhja e fondeve mund të bëhet në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, por madje edhe në nivel të të punësuarve në ndonjë kompani apo institucion, në shkollë apo edhe me vendosje të kutive për donacione në restorantet e ushqimit të shpejtë. Donatorë mund të jenë të gjithë – komshiu i juaj, kuventet e banorëve, vetëqeverisja dhe institucionet lokale, ministritë, donatorët ndërkombëtarë, kompanitë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme... Gjatësia dhe përbërja e listës së donatorëve potencialë varen më së shumti nga kreativiteti juaj, nga idetë se si t'u qaseni njerëzve, sepse në instancën e fundit **mbledhja e fondeve është punë me njerëz, për njerëz, që e udhëheqin njerëzit**¹.

¹ Parafrasa e parimit të mbledhjes së suksesshme të fondeve e përkthyer nga gjuha angleze "Fundraising is peoples' business".

Sektori civil në Evropën Juglindore është në ekspansion. Numri i organizatave në të gjitha shtetet e rajonit është në rritje, kurse shkalla e angazhimit të tyre rritet në mënyrë të vazhdueshme. Prania e fuqishme e donatorëve ndërkombëtarë, si dhe e kompanive ndërkombëtare me programe të afarizmit shoqëror llogaridhënës, ka paraqitur një shtytje të madhe për zhvillimin e shoqërisë civile. Fryma aktiviste, e pranishme në këto hapësira, ka gjetur aleatë të mirë në këto programe. Në fund të dekadës së parë të këtij mileniumi të ri, organizatat në këtë pjesë të Evropës janë më të vetëdijshme për faktin që varshmëria tejet e madhe financiare nga donatorët ndërkombëtarë nuk sjellë qëndrueshmëri. Nga ana tjetër, resurset lokale, si burim i fondeve, kanë mbetur mjaft të pa përdorura, kurse OSHC-të kanë filluar të kuptojnë se me mobilizimin e tyre mund të sigurojnë fonde të rëndësishme, të qëndrueshme dhe mjaft fleksibile, që do t'u mundësonin që të jenë më të suksesshëm në realizimin më të qëndrueshëm të misioneve të tyre. Më shumë se kurrë, në këtë mënyrë ripërtërihet lidhja në mes të

OSHCve dhe komuniteteve lokale. Për dallim nga donatorët ndërkombëtarë, që rëndom kanë rregulla të përcaktuara në mënyrë precize dhe rigorozë për kushtet në të cilat i financojnë OSHC-të, rasti nuk është i këtillë kur kemi të bëjmë me individë, me kompani, e madje edhe me institucione publike. Me praktika të reja të mbledhjes së fondeve dhe, aq më shumë, me futjen e individëve dhe të kompanive në rolin e donatorëve të OSHC-ve, kanë pasuar edhe sfidat e reja. Duke qenë se komunitetë lokale nuk kanë mjaft përvojë "të gjallë" në filantropi²,

² Këtu duhet të theksohet se të gjitha shtetet e rajonit kanë një traditë të konsiderueshme filantropike, kontinuiteti i së cilës është ndërprerë pas Luftës së Dytë Botërore. Me këtë rast, komunitetet lokale gjatë tërë kohës kanë praktika mjaft aktive filantropike, mirëpo ato realizohen në një kornizë drastike ndryshe legislative dhe kulturologjike në periudhën 1945–1990. Për këtë arsye mungesat e tanishme e përvojës së komuniteteve me iniciativat filantropike kurrësi nuk duhet t'i kuptojmë si mungesë e filantropisë apo si pasojë e mosekzistimit ose të një lloji të "përgjashimit" të frymës filantropike në periudhën e pasluftës, sepse kjo thjesht nuk i përgjigjet të vërtetës. Do të ishte e drejtë të shqyrtohet gjendja aktuale nga prizmi i mungesës së përvojës në lidhje me aplikimin e praktikave bashkëkohëse filantropike dhe të legjisllacionit bashkëkohor, që në Evropën Juglindore ende nuk i ka arritur standardet demokracive bashkëkohore evropiane.

prijet e tyre me rastin e dhënies nuk janë të mëdha, ndërsa raporti ndaj OSHC-ve, për fat të keq, është përplot mosbesim. Në një situatë të tillë të posashfaqur, ku lirisht mund të themi se i tërë sektori civil është në tranzicion, arritja e pajtimit rreth parimeve të punës bëhet domosdoshmëri që e ndien numri gjithnjë e më i madh i organizatave.

Standardet për mbledhjen e fondeve u shërbejnë pikërisht OSHC-ve në rajon për të marrë orientimin se si ta zhvillojnë raportin e tyre me donatorët dhe me komunitetin lokal, si të ndërtojnë raportin e mirëbesimit në mes tyre dhe donatorëve, duke përfshirë qytetarët e komuniteteve lokale.

Standardet përbëhen nga 12 parime të mbledhjes së fondeve. Secili nga parimet përmban një sërë vlerash që është me rëndësi të përfillen me rastin e mbledhjes së fondeve. Po ashtu, parimet përcaktojnë praktikat dhe sjelljet e dëshirueshme të OSHC-ve në raport me aktetë kyç në procesin e mbledhjes së fondeve -para së gjithash me donatorët dhe përfituesit e tyre.

KUR PËRDOREN STANDARDET DHE SI?

Kjo pyetje shtrihet shpesh kur nënshkruajmë ndonjë dokument i cili përcakton standardet etike dhe profesionale të afarizmit. Standardet kanë funksion të shumëfishtë - shërbejnë për ngritjen e vetëdijes tek njerëzit nga sektori civil për standardet etike dhe profesionale, përcaktojnë se çka është e nevojshme të bëhet brenda një OSHC-je në mënyrë që raporti me donatorë të zhvillohet mirë dhe t'i identifikojnë mënyrat më të mira që OSHC t'i zhvillojnë raportet e tyre me komunitetet lokale dhe përfituesit. Po qe se një OSHC e mundon cilado nga këto pyetje, Standardet dhe ky manual mund të jenë një ndihmesë e madhe.

Disa nga situatat më të shpeshta kur Standardet dhe Manuali mund të jenë jashtëzakonisht të dobishëm janë si në vijim:

DONATORI KA SHPALLUR KONKURS APO KEMI DONATORIN E INTERESUAR PËR AKTIVITETET TONA. CILAT AKTIVITETE DO TË DUHEJTË PROPOZONIM PËR T'I FITUAR FONDET?

Standardet na përkujtojnë se është me rëndësi t'i kthehemi çështjes së misionit të organizatës dhe të bëhen pikërisht ato gjëra për shkak të të cilave ekziston organizata jonë. Sektori civil humb mjaft sa i përket prestigjit për shkak të asaj që njerëzit e identifikojnë si "marrje me gjithçka" apo "ekspertizë për gjithçka dhe çdo gjë". Edhe më shumë se kaq, OSHC humbasin mundësinë për t'u specializuar dhe për t'u bërë partner kredibil në fushën e caktuar, për t'u mundësuar të gjithë njerëzve zhvillimin profesional në fushën konkrete të interesit, të zhvillojnë raportin afatgjatë me përfituesit dhe grupet e synuara.

I KEMI FITUAR FONDET DHE NUK DIMË SE SI T'UA PREZANTOJMË DONATORËVE AKSIONET TONA.

Standardet ndihmojnë për t'i përcaktuar mënyrat më të mira të prezantimit para donatorëve dhe falënderimit për donatorë, por ua përkujtojnë se për çka është e nevojshme të arrihet

paraprakisht marrëveshje me donatorin në këtë aspekt.

OPINIONI NEVE NA SHEH SI "MERCENARË" DHE NJERËZ TË CILËT PUNOJNË PËR DONATORËT DHE INTERESAT E TYRE.

Mënyra më e mirë për t'u ballafaquar me këtë paragjykim është në mënyrë të hapurtë tregoni se kush i financon aktivitetet tuaja. Po ashtu, t'u tregoni në mënyrë të qartë njerëzve se ideja është e juaja, dhe ka lindë nga komunikimi me përfituesit dhe nga kërkesat e tyre, kurse donatori e ka identifikuar cilësinë e idesë suaj. Manuali do t'i prezantojë disa nga modelët të cilat mund të jenë të dobishme për organizatën tuaj.

KA NJERËZ NË NIVELIN LOKAL QË DO TË JEPNIN FONDE PËR IDETË DHE PËRFITUESIT TONË, MIRËPO NUK KANË BESIM TË MJAFTUESHËM NË OSHC-NË TONË.

Është e nevojshme të zhvillohen mekanizmat e brendshëm të cilët parandalojnë keqpërdorimet dhe t'u prezantohen në mënyrë të qartë opinionit dhe donatorëve potencialë. A i shpallim publikisht informacionet për fondet e mbledhura dhe të shpenzuara? A kemi informacione në ueb-faqen tonë apo në materia-

let tjera të cilat tregojnë se fondet i shpenzojmë në mënyrë efikase në të mirë të njerëzve për shkak të të cilëve ekzistojmë dhe në interesin e të cilëve punojmë? A zbatojmë auditim të pavarur financiar nëse jemi organizatë më e madhe dhe a i publikojmë raportet dhe gjetjet e auditimit?

KEMI AKSION TË MBLEDHJES SË FONDEVE, MIRËPO INDIVIDËT DHE KOMPANITË NUK NA JAPIN FONDE SEPSE EKZISTON BRENGOSJA SE DO TË MBLEDHIM SHUMË MË TË VOGËL SE AJO QË ËSHTË E DOMOSDOSHME.

OSHC-të do të duhej të kishin rregulla të përcaktuara sipas të cilave do të veprohej në atë rast, duke i mbrojtur interesat e donatorëve. Natyrisht, këto rregulla është e nevojshme që paraprakisht t'u prezantohen të gjithëve dhe të respektohen.

DO TË DËSHIRONIM QË PËRFITUESIT TANË TË MARRIN PJESË NË MBLEDHJEN E FONDEVE, MIRËPO ATA NUK E DËSHIROJNË NJË GJË TË TILLË.

Njerëzit, me të drejtë, frikësohen se privatësia apo dinjiteti i tyre do të rrezikohen. Është e nevojshme të sigurohen kushtet që përfituesit tanë të ndjehen mirë që marrin pjesë në aksion.

PËRFITUESIT TANË NUK KANË BESIM TË MJAFTËSHËM TEK NE DHE MENDOJNË SE KËTË E BËJMË VETËM PËR SHKAK TË DONATORËVE.

Standardet do t'u përkujtojnë se është me rëndësi që t'i kyçni përfituesit në përcaktimin e aktiviteteve që i planifikoni. Hulumtoni nevojat e tyre, kyçni në planifikim, pyetni se çka është e nevojshme të avancohet në punën e organizatës suaj. Është e nevojshme të ndërtohet raporti i mirëbesimit me përfituesit në mënyrë që ata ta ndjejnë se janë këta "projektet e tyre", ndërsa ju jeni "organizatë e tyre". Po qe se nuk është kështu, për kë dhe në emër të kujt punon organizata juaj? Dhe në fund, mos fshihni nga ata se sa para keni marrë nga donatorët. Ata gjithsesi se do të mësojnë për këtë, nëse dëshirojnë,

kurse fshehja nga ana juaj e informacionit të tillë do të mund të përjetohej si një lloj "mashtrimi".

DONATORI NUK KA KËRKUAR NGA NE RAPORT FINANCIAR, POR NE ME DËSHIRË DO TË RAPORTONIM PËR MËNYRËN E SHPENZIMIT TË FONDEVE.

Këtë pyetje e hasim shpesh tek organizatat që bëjnë mbledhjen e fondeve në nivelin lokal, ndërsa reagimi instinktiv se është e domosdoshme të raportohet është absolutisht i saktë. Raportimi për shpenzimin është rast i mrekullueshëm për të treguar se çka kemi bërë me paratë e mbledhura dhe që t'u falënderohemi donatorëve që kanë bërë të mundur realizimin e rezultateve tona.



Si të aplikohen Standardet në OSHC-në tonë? Aplikimi i Standardeve është *ndryshim i mënyrës në të cilën punojmë çdo ditë*. Çdo OSHC që nga ky moment e ka mënyrën e vet të punës në fushat në të cilat kanë të bëjnë Standardet. Bie fjala, mospublikimi i raporteve financiare apo i shumës së donacioneve tashmë është procedurë të cilën e aplikon organizata. Pa marrë parasysh faktin nëse në organizatë keni marrë vendim për këtë çështje apo jo, mospublikimi i këtyre të dhënave për opinionin e interesuar mund të flasë shumë. Për ta, mospublikimi është pasojë e vendimit me vetëdije të organizatës për ta bërë këtë, përkatësisht për t'i fshehë të dhënat.

Po qe se i mbledhim donacionet nga individët, ndërsa nuk kemi mënyra të mira që t'u falënderohemi, kjo tashmë është *akt* që dikush nga donatorët do ta interpretonte si mos falënderim. Pasojat e *mosveprimit* të këtyre janë negative, kurse mungesa e kohës apo e resurseve nuk paraqesin arsye-tim mjaft të mirë në opinion.

Nga të gjitha këto arsye, aplikimin e standardeve nuk duhet shikuar si futje të aktiviteteve të reja në organizatë, por si ndryshim të mënyrës së punës me rastin emblehdjes së fondeve. Kemi të bëjmë me ndryshimin, i cili kërkon kohë dhe përkushtim të tërë ekipit. Liderët e organizatave do të duhej të ishin të përkushtuar në këtë proces, mirëpo të durueshëm. Futja e ndryshimit në mënyrën në të cilën çdo ditë punojmë nuk është e lehtë, mirëpo është pikërisht kjo rruga e vetme e zhvillimit të ekipit dhe organizatës.

Roli i liderit të OSHC-së në këtë proces nuk është që ai/ajo t'i instalojë dhe aplikojë parimet, por që në mënyrë permanente të krijojë kushte shtytëse që të gjithë në organizatë t'i aplikojnë ato parime. Prandaj, rekomandim për të gjithë liderët është që të ndërtojnë me durim procesin në të cilin *kultura e organizatës* do të bëhet e tillë që të gjithë në ekip të synojnë veprimin transparent dhe llogaridhënës, si ndaj përfituesve, ashtu edhe ndaj donatorëve, bashkëpunëtorëve, konkurrencës dhe mjedisit.

PARIMET E MBLEDHJES SË FONDEVE

1. Standardet për **mbledhjen e fondeve**
2. Misioni, vlerat, parimet dhe objektivat strategjike të **OSHC-ve**
3. Llogaridhënia, hapja dhe transparenca
4. **Komunikimi** i qartë, i hapur dhe transparent
5. **Parandalimi** i keqpërdorimit të fondeve dhe pasurisë
6. **Transparenca** dhe hapja në procesin e mbledhjes së fondeve
7. Shfrytëzimi i përgjegjshëm, efikas dhe efektiv i donacioneve të marra
8. **Menaxhimi i fondeve** në rast të ndërprerjes së mbledhjes
9. **Respektimi** i të drejtave dhe dinjitetit të përfituesve
10. **Informimi** i përdoruesve për **mbledhjen e fondeve**
11. Përfshirja e përfituesve në **procesin e përcaktimit të qëllimit**
12. **Informimi** i donatorëve për mënyrën në të cilën përdoret donacioni
13. **Vlerësimi** i kontributit të donatorëve



STANDARDET PËR MBLEDHJEN E FONDEVE-DOKUMENT INTEGRAL¹

Rrjeti i fondacioneve lokale të Evropës Juglindore SIGN (Southeast European Indigenous Grant-makers Network) është rrjeti i fondacioneve kushtuar kultivimit të një mjedisi të hapur, transparent dhe llogaridhënës për zhvillimin e filantropisë, e afazizmit shoqëror llogaridhënës dhe aktivizmit qytetar në mënyrë që të mbështeten dhe avancohen kapacitetet e qytetarëve/qytetareve për t'i mobilizuar resurset në komunitetin lokal.

Ky dokument synon të vendos standarde për praktikën e mbledhjes dhe shpenzimit të fondeve, si dhe për raportim donatorëve institucional, korporativ apo individual, të bazuara në parimet e dakorduara të transparencës dhe llogaridhënies për organizatat e shoqërisë civile

¹ Në këtë pjesë të Manualit është paraqitur përmbajtja e tërësishme e dokumentit Standartet për mbledhjen e fondeve. Këtij dokumenti i kanë paraprirë më shumë versione dhe propozime të ndryshme që ishin prezantuar në sesionet me fondacionet dhe shoqatat në 5 shtete të Ballkanit. Versioni që është para jush është versioni final të cilin e ak miratuar rrjeti SIGN në bazë të propozimit nga sesionet në fjalë dhe debatet.

(OSHC)² të cilat dëshirojnë t'i mobilizojnë resurset për aktivitete për të mirën e përgjithshme në shtetet e tyre.

Këto standarde të praktikave janë vendosur me qëllim që të jenë standard për ata që i nënshkruajnë dhe do të aplikohen në shtetet e Evropës Juglindore. Qëllimi i këtyre standardeve është rritja e besimit të qytetarëve në aktivitetet e OSHC-ve në mënyrë që të zgjerohet rrjeti i tyre i mirëbesimit, legjitimiteti dhe të avancohet kështu qëndrueshmëria dhe ndikimi i tyre.

Organizatave të shoqërisë civile, të cilat e nënshkruajnë këtë dokument, deklarojnë se do t'u përmbahen parimeve të theksuar më poshtë.

Besojmë se përkushtimi i organizatave ndaj transparencës dhe llogaridhënies është një ndër parakushtet për kultivimin dhe zhvillimin e filantropisë në rajon.

² Grupet joqeveritare dhe jo fitimprurëse të cilat punojnë në përmirësimin e shoqërisë dhe avancimin e pozitës së njerëzve.

ME NËNSHKRIMIN E KËTYRE STANDARDEVE TË PRAKTIKAVE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PAJTOHEN SI NË VIJIM:

1. Se do të sillen në pajtim me misionin, vlerat, parimet dhe/ose objektivat e tyre strategjike, duke i respektuar ligjet, rregulloret, dokumentet e tjera zyrtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare që janë në fuqi në shtetin përkatës.

2. Sedo të jenë llogaridhënese, të hapura dhe transparente në procesin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse publike, me partnerët nga komuniteti, me donatorë, qeveri, media, si dhe në raport me bazën vetanake³.

3. Se do të kenë komunikim të qartë, real dhe të hapur për aktivitetet dhe rezultate e tyre, si dhe për shumat e fondeve me të gjitha palët e interesuara. Këto OSHC do të bëjnë publike prejardhjen e fondeve për palët e interesuara, me përjashtim të rastit kur donatori kërkon në mënyrë eksplicite

³ Me bazë nënkuptojmë grupin e drejtpërdrejtë të synuar të organizatës, përfutuesit e saj, anëtarësinë, vullnetarët dhe simpatizuesit.

që të mbetet anonim. Informacionet për shumat e pranuar të fondeve do të jenë të qasshme gjatë procesit të mbledhjes së fondeve, në mënyrë periodike, si dhe pas përfundimit të procesit të mbledhjes së fondeve.

4. Se do të mbrojnë përdorimin e mjeteve dhe do t'i krijojnë mekanizmat për parandalim të keqpërdorimit të fondeve dhe të pasurisë, si dhe do të ndërmarrin masat përkatëse po qe se ndodh keqpërdorimi.

5. Se do ta zbatojnë procesin e mbledhjes së fondeve në mënyrë transparente, duke komunikuar në mënyrë të hapur për qëllimin, aktivitetet dhe nevojat për shkak të të cilave i mbledh fondet dhe se nuk do të japin premtime të rrejshme apo të krijojnë pritje joreale tek donatorët nga të cilët kërkohet mbështetja.

6. Se do t'i shfrytëzojnë donacionet e pranuar në mënyrë të përgjegjshme, efikase dhe efektive në pajtim me qëllimin për çka e kanë marrë donacionin. Po qe se ndonjë pjesë e parasë së donacionit do të shpenzohet për shpenzime operative, kjo duhet të komunikohet paraprakisht.

7. Se do të përcaktojnë në mënyrë publike dhe të qartë si do t'i menaxhojnë fondet që janë mbledhur në kampanjat të cilat kanë përfunduar për shkak të fuqisë madhore apo të parashkrimit të shkakut për mbledhjen e fondeve, si dhe në rastet kur shumat e mbledhura janë më të mëdha apo më të vogla nga shumata e planifikuar paraprakisht e mbledhjes së fondeve.

8. Se do të sigurojnë që të drejtat e përfituesve dhe përfitueseve të respektohen dhe se dinjiteti dhe vetë-respektimi i tyre janë të mbrojtur gjatë procesit të mbledhjes dhe distribuimit të fondeve, si dhe gjatë raportimit mbi përdorimin e donacionit.

9. Se do t'i informojë me kohë përfituesit/përfitueset e tyre (potencialë) për donacionet e mbledhura dhe distribuimin e tyre, qoftë përmes raportimit periodik, përmes medieve, kontaktit të drejtpërdrejtë apo përmes mënyrave të tjera relevante të komunikimit.

10. Se do të synojnë që t'i përfshijnë përfituesit dhe përfitueset e tyre në procesin e përcaktimit të qëllimit të mbledhjes dhe distribuimit të fondeve; dhe t'i përfshijë në vendimmarrje rreth distribuimit të mëtejshëm të fondeve që kanë mbetur pa u shfrytëzuar, duke qenë se është përmbushur qëllimi fillestar e mbledhjes së tyre.

11. Se do t'i informojë donatorët lidhur me atë se si është shfrytëzuar donacioni i tyre, si dhe do të sigurojë përgjigje të shpejta, të sakta, voluminoze dhe të hapura për të gjitha pyetjet, në bazë të kërkesës së donatorit dhe procedurës së raportimit.

12. Se do marrë në konsideratë kontributet e donatorëve dhe do të sigurojë që të gjitha informacionet për donatorët do të trajtohen si konfidenciale dhe se do të ruhen në mënyrë të sigurt, në bazë të kërkesës së donatorëve dhe procedurave të shikimit.



PARIMI 1. MISIONI, VLERAT, PARIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË OSHC-SË, LEGALITETI DHE LEGJITIMITETI

OSHC-ja do të sillet në pajtim me misionin e vet, vlerat, parimet dhe/ose objektivat strategjike, duke i respektuar ligjet, rregulloret, dokumente e tjera zyrtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë në fuqi në shtetin përkatës.

Organizatat e shoqërisë civile formohen me ndonjë qëllim. Themeluesit nisen nga nevoja që disa probleme shoqërore të zgjidhen, që t'i ndihmohet ndonjë grupi të njerëzve

apo që të përmbushën nevojat e ndonjë grupi në nivelin lokal, nacional apo ndërkombëtar. Madje edhe kur organizata nuk e ka të miratuar deklaraten e misionit, të vlerave, parimeve dhe objektivave, vetë motivimi i themeluesit e përcakton organizatën në përzgjedhjen se çka do të punojë dhe, ndoshta edhe më e rëndësishme, çka nuk do të punojë.

Cili është misioni i organizatës dhe për çka shërben ai? Mos iu qasni kësaj pyetje tepër shumë sipas automatizmit. Organizatat me lehtësi pohojnë se i kanë misionin dhe objektivat e përcaktuara organizative, mirëpo si ta dimë se vërtet është ashtu? A ka mision organizata jonë nëse ai është vetëm i përcaktuar, i shkruar në letër dhe kjo është e tëra? Natyrisht se jo. Misionin e kemi vetëm atëherë kur ai është përcaktuar *qartë*, është i njohur brenda dhe jashtë

organizatës, për të cilin kemi kapacitete dhe që e zbatojmë në punën e përditshme.

MISIONI I ORGANIZATËS DUHET TË JETË I QARTË DHE, ËSHTË E DËSHIRUESHME, I PËRCAKTUAR THUKËT.

Kjo është deklarata e cila paraqet më së miri se kush dhe çka është organizata jonë. Është e nevojshme të përcaktohet misioni ashtu që:

- të përcaktojë qartë organizatën, përkatësisht të përkufizojë saktë:
 - çka punon
 - ku
 - për kë
- të motivojë njerëzit në organizatë, përfituesit tanë dhe akterët e tjerë
- të mundësojë evaluimin e efektit të organizatës me kohën në kohë.

Organizata e cila i përmbahet misionit, vlerave, parimeve dhe objektivave strategjike ndërton identitetin e saj edhe tek donatorët, edhe në komunitet. Ky nuk është vetëm standard i mbledhjes së fondeve, është një ndër parakushtet e suksesit afatgjatë të organizatës. Kur mendojmë tek shoqëria civile dhe mbrojtja e ambientit jetësor, shumicës së njerëzve në botë u shkon mendja tek organizata *Green Peace*. Kur mendohet për luftën kundër torturës, është këtu *Amnesty International*. Qëllimi juaj është që, kur njerëzit në komunitetin tuaj dhe donatorët të mendojnë për problemin që është pjesë e misionit tuaj (bie fjala, punësimi i të rinjve), asociacioni i parë të jetë OSHC e juaj.

Organizata për mbështetjen e rinjve në një komunitet lokal në Mal të Zi ka marrë ftesë nga OSHC e Podgoricës që të organizojnë tribunë në temën e promovimit të hyrjes së Malit të Zi në NATO. Pas një mendimi të gjatë, para së gjithash nga dëshira që t'u ndihmojnë miqve dhe partnerëve të kryeqytetit, por edhe me shpresë se në këtë mënyrë do të tërheqin donatorë të rinj, organizata e rinisë ka pranuar të organizojë tribunën në temën e cila shkakton kundërshtitë të shumta në atë komunitet. Tribuna ka tërheqë vëmendjen e madhe të opinionit dhe medieve, ashtu që shumica e qytetarëve të këtij komuniteti për herë të parë kishte dëgjuar për organizatën në këtë mënyrë. Gati dy vjet pas kësaj tribune, organizata ka pasur probleme me rastin e realizimit të programeve për të rinj, sepse opinioni i ka identifikuar objektivat dhe misionin e tyre në mënyrë të gabueshme.

Është posaçërisht e rëndësishme që **organizata të mund ta zbatojë misionin**. Që kjo të jetë e mundur, misioni duhet të jetë në pajtim me njohuritë dhe shkathtësitë tona, me kompetencat, resurset, kapacitetet dhe lartësinë e mjeteve financiare të cilat mund t'i mbledhim. A mund të jetë misioni yni në lidhje me ndryshimin e ndonjë ligji, në qoftë se nuk e njohim mirë kornizën ligjore në atë lëmi, praktikat e institucioneve publike, në qoftë se nuk kemi bashkëpunëtorë profesionalë apo qoftë edhe resurset e nevojshme për angazhimin e tyre?

Kur e kemi të përcaktuar misionin dhe konstatojmë se i kemi kapacitetet e domosdoshme, nevojitet që **të kujdesemi që misioni vërtet edhe të zbatohet përmes punës së përditshme të OSHC-së**. Për fillim, a është për të gjithë e njohur mirë deklarata e misionit në organizatë në përgjithësi, e pastaj edhe për përfutjesit dhe akterët e rëndësishëm për organizatën tonë?

Është me rëndësi po ashtu që deklarata e misionit të gjej zbatimin e saj, veçmas me rastin e marrjes së vendimeve. Misioni është orientimi më i rëndësishëm me rastin e marrjes së të gjitha vendimeve në organizatë, sepse na përkujton se kush jemi ne dhe përse ekzistojmë. Sa shpesh u kujtohet misioni me rastin e marrjes së vendimeve? Po qe se ky nuk është rast i shpeshtë, ka mundësi që deklarata juaj e misionit nuk është mjaft e qartë, apo nuk është e përdorshme sa duhet.

Misioni i organizatës, në një mënyrë, është kontratë joformale që e bën organizata me shoqërinë dhe njerëzit që jetojnë në komunitet. Përmes misionit organizata jonë merr përsipër një pjesë të obligimeve, një funksion të caktuar në shoqëri/komunitet. Falë misionit, komuniteti mund të mbështetet në ne, në atë që organizata jonë do të jetë aty për t'u marrë me një çështje të caktuar, për të mbrojtur interesin publik dhe interesin e komunitetit në çështjet që i mbulon misioni, përkundër interesave të shumta të cilat ky interes publik do t'i shkatërrojë. Humbja e përqendrimit, ndërrimi i përhershëm i fushave dhe i temave të punës së OSHC, sjell "prishjen e kontratës" që e kemi vendos përmes misionit. Komunitetet fillojnë ta shikojnë OSHC-në tonë si entitet i cili ekziston vetëm për vetvete dhe në të cilin më nuk mund të mbështetën. Fitohet imazhi "i marrjes me gjithçka".

Natyrisht, secila organizatë mund ta ketë "pulën e artë"⁴ të saj në aktivitetet që janë jashtë misionit, në saje të të cilave mbulohen shpenzimet e

aktiviteteve themelore të organizatës. Përderisa aktivitetet e "pulës së artë" nuk behën mbizotëruese në organizatë, është krejtësisht në rregull që të kemi nga ndonjë aktivitet të tipit të tillë. Mirëpo, vërtet vetëm ndonjë.

Në mënyrë të ngjashme organizata i përcakton vlerat, parimet dhe objektivat e saj strategjike. Të gjitha këto elemente dalin drejtpërdrejt nga misioni dhe kontribuojnë që misioni i organizatës të realizohet. Po qe se pjesë e misionit tonë është shoqëria e hapur dhe transparente, falë vlerave dhe parimeve ne e përcaktojmë në mënyrë më precize se çka do të thotë kjo për ne. Në fund, përmes objektivave strategjike e përcaktojmë se ku dëshiron që të jetë organizata jonë në periudhën prej 3–5 vite, të udhëhequr nga ideja që me ato objektiva vërtet ta zbatojmë misionin tonë.

Legaliteti i punës është elementi i dytë nësoj i rëndësishëm i parimit të parë. Legaliteti i punës është elementi i dytë nësoj i rëndësishëm i parimit të parë të Standardeve për mbledhjen e fondeve. Viteve të fundit kemi kryesisht një përmirësim të kornizës së gjerë legislative në shtetet e Evropës Juglindore. Kur kemi të bëjmë me parimin e legalitetit, përkatësisht të respektimit të ligjit, ky parim nënkupton jo vetëm respektimin e ligjit me rastin e mbledhjes së fondeve, por edhe respektimin e ligjit në punën e gjithëmbarshme të OSHC. Organizata e cila nuk arrin të paguaj tatimin apo kundër së cilës zhvillohet procedurë në të cilën mund të shqiptohet dënimi me të holla, rrezikon edhe destinimin e fondeve që i mbledh. Situata e këtillë nuk e rrezikon vetëm kredibilitetin e një organizate, por e rrënon mirëbesimin e brishtë në mes të qytetarëve dhe tërë sektorit civil.

4 Të shikohet analiza e i Gruber-Mohr-it, Robert E. Gruber, Marry Mohr.

PARIMI 2. LLOGARIDHËNIA, HAPJA DHE TRANSPARENCA

OSHC do të jenë llogaridhënese, të hapura dhe transparente në procesin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse publike, me partnerë nga komuniteti, me donatorë, qeveri, media si dhe në raport me bazën vetanake.

Llogaridhënia e qeverisjes është parim për të cilin një numër i madh i OSHC-ve angazhohen në punën e tyre. Mirëpo, sa merremi me çështjen e llogaridhënies sonë? A i japin dikujt llogari OSHC-të?

OSHC-të themelohen dhe obligohen që të punojnë në interesin publik. Gjithsesi se për këtë arsye llogaridhënia, hapja dhe transparenca në punë janë parakusht i funksionimit tonë në sferën e interesit publik.

Mirëpo, me shikim tëhollësishëm të kësaj problematike, vijmë në përfundim se ky “opinion i gjerë” dhe llogaridhënia në raport me te, ka një përkufizim aq të gjerë, sa që në të vërtetë nuk do të thotë shumë. Të jesh llogaridhënës ndaj të gjithëve! Çka në të vërtetë do të thotë kjo? Nëse ndalemi këtu dhe nuk e shqyrtojmë pak më mirë kush janë ata “të gjithë”, ky parim shumë lehtë shndërrohet në “të mos jesh llogaridhënës ndaj askujt”.

Në të gjitha publikimet, Shoqata Irlandeze e organizatave zhvillimore Dochas thekson se është e domosdoshme të dallohen 4 lloje të llogaridhënies, varësisht nga ajo se ndaj kujt drejtohet llogaridhënia:

- llogaridhënia nga poshtë lart – ndaj qeverisë dhe institucioneve, donatorëve dhe fondacioneve;
- llogaridhënia nga lart poshtë – ndaj bazës;
- llogaridhënia e brendshme – ndaj të punësuarve dhe anëtarëve të organizatës (me qëllim të ruajtjes së misionit dhe të vlerave, përkatësisht të kulturës organizative);

- llogaridhënia horizontale – ndaj kolegëve nga organizatat e tjera (me qëllim të avancimit të standardeve dhe cilësisë së punës, si dhe të avancimit dhe reputacionit të sektorit civil në tërësi)⁵.

Secili nga këto 4 lloje të llogaridhënies kërkon një qasje ndryshe. Derisa llogaridhënia ndaj qeverisë dhe institucioneve realizohet përmes pjesëmarrjes në debatet publike, kritikën konstruktive dhe zhvillimin e politikave publike, si dhe përmes sigurimit të të dhënave reale nga terreni, që mundësojnë vendime më cilësore në aktivitetet e tjera dhe të ngjashme, llogaridhënia ndaj donatorëve realizohet më së shumti përmes zhvillimit të ideve të projekteve të bazuara në nevojat reale. Këtu para së gjithash mendohet në planifikimin e vëllimit të aktiviteteve që u përgjigjet kapaciteteve të organizatës, si dhe në krijimin e projekteve reale të buxhetit.

⁵ Për më shumë informacione, shiko tekstin e mrekullueshëm të autorit A. Angjellkoviq, në lidhjen: http://wikiciv.org.rs/index.php/Povećanje_odgovornosti_i_transparentnosti#cite_ref-2.

Koalicioni „Otvoreni parlament” („Parlamenti i hapur“) në Serbi, që i prinë OSHC „CRTA”, promovon llogaridhëniën e pushtetit dhe kërkon transparenca në punën e sektorit publik.

Për të pasur kredibilitet për të kërkuar sjellje llogaridhënese dhe transparente të pushtetit, brenda koalicionit është marrë vendim që të gjitha anëtarët duhet t'i publikojnë raportet vjetore për punën e organizatës (të kuptueshme për qytetarë) si dhe të bëjnë auditimin vjetor financiar, rezultatet e të cilit duhet të publikohen në ueb-faqe e anëtareve.

Llogaridhënia ndaj bazës, përfshirë edhe përfituesit, realizohet në disa mënyra. Ky segment i llogaridhënies është trajtuar më hollësisht tek parimet në vijim, që janë në ndërlidhje me bazën dhe përfituesit.

OSHC llogaridhëne brenda vetës realizon llogaridhënien, para së gjithash, falë ekzistimit të mekanizmave të brendshëm të kontrollit. Ekzistimi real i Kuvendit dhe i këshillave drejtuese në OSHC mundëson, jo vetëm menaxhimin e suksesshëm të organizatës, por edhe kontrollin ndaj udhëheqjes, përmes realizimit të aktiviteteve në OSHC përkatëse ndaj të të punësuarve dhe anëtarëve të saj. Po qe se OSHC i punëson njerëzit, llogaridhënia realizohet përmes përcaktimit të qartë të të drejtave dhe detyrimeve të të punësuarve (kontratat me të punësuarit, përshkrimet e punëve, vlerësimi i efektit të punës), si dhe përmes respektimit të plotë të kushteve sipas marrëveshjes.

Shoqëria civile është segment i shoqërisë me një imazh të brishtë. Puna e OSHC mbështetet, para së gjithash, në mirëbesimin ndërmjet organizatave dhe qytetarëve. Besimi

fitohet me kohë, krahas një pune mjaft të mundimshme dhe me rezultate të cilat vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre “investimeve”. Besimi, që ndërtohet aq shumë gjatë, për fat të keq, humbet lehtë. Dhe këtu duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin që sjellja e papërgjegjshme e një OSHC-je rrënon prestigjin edhe të organizatave të tjera. Mënyra e vetme, që OSHC-të e caktuara të mbrohen nga sjellja e papërgjegjshme e të tjerëve, është vendosja dhe aplikimi i standardeve profesionale dhe etike.

Transparenca dhe puna publike e OSHC-ve është e pranishme në statutet thuaja se të të gjitha OSHC-ve në rajon. Mirëpo, në çfarë mënyrë kjo realizohet dhe çka do të thotë? Transparenca e OSHC aplikohet përmes sigurimit të mbikëqyrjes së plotë në informacionet për punë dhe rezultatet e organizatës të opinionit të interesuar. Duhet të theksohet se standardi i transparencës nuk nënkupton rolin “pasiv” të organizatës në përmbushjen e këtij standardi. Përkundrazi, OSHC është transparente nëse vetë punon në publikimin e informacioneve, nëse informacionet janë të qasshme përmes raportimit të rregullt të opinionit

(përmes ueb-faqes, në konferencat për shtyp, në paraqitjet mediatike...) edhe nëse informacionet e qasshme janë të kuptueshme për opinionin.

Prandaj nuk mund të themi gjithsesi se një OSHC është transparente për faktin që i ia parqet raportet e detyrueshme vjetore financiare shtetit, i cili pastaj i publikon në ndonjë ueb-faqe të saj. Këto informacione janë të pakuptueshme she shpesh edhe të pa qasshme për opinionin e gjerë.



Në prill të vitit 2010 policija ka arrestuar Kaatrina Rebraç, në atë kohë kryetare e Fondit bamirës „Katarina Rebrača” nga Beogradi, për shkak të dyshimit se ka përvetësuar më shumë se 300.000 EUR të destinuara për ndihmë humanitare përmes kësaj shoqate. Rrëfimi ka tërheqë vëmendjen e jashtëzakonshme të opinionit sepse kemi të bëjmë me një person të njohur në Serbi, manekine e suksesshme, e cila në atë kohë në opinion e promovonte aktivisht punën e fondit të saj. Të gjitha OSHC të cilat mbledhin fonde nga individët dhe kompanitë në Serbi shumë kohë pas këtij arrestimi kanë pasur probleme në komunikim me donatorë potencialë dhe zvogëlim të të hyrave nga ky burim i i rëndësishëm i financimit, ndonëse janë marrë me tema krejtësisht të ndryshme, kanë mbledhur madje edhe shuma dukshëm më të vogla në raport me fondin në fjalë, apo kanë pasur tashmë një numër të madh të aksioneve të suksesshme pas veti.

PARIMI 3. KOMUNIKIMI I QARTË, I HAPUR DHE TRANSPARENT

OSHC do të ketë komunikim të qartë, të vërtetë, të hapur dhe transparent për aktivitetet, rezultatet e veta dhe shumat e fondeve me të gjitha palët e interesuara. OSHC do të publikojë prejardhjen e fondeve palëve të interesuar, me përjashtim të rastit kur donatori në mënyrë eksplicite kërkon të mbetet anonim. Informacionet për shumat e pranuar të fondeve do të jenë të qasshme gjatë procesit të mbledhjes së fondeve, në mënyrë periodike, si dhe në përfundim të procesit të mbledhjes së fondeve.

Raportimi opinionit, donatorëve, partnerëve dhe përfituesve mund të zhvillohet në shumë mënyra të

ndryshme. Çdo komunikim për aktivitetet, rezultatet dhe financimi është formë e raportimit. Raportimi dhe komunikimi me opinionin në sektorin civil përjetohen shpesh si aktivitet i dobishëm, por jo sa duhet si detyrim që rrjedhë nga standardet profesionale dhe etike.

Raportimi dhe komunikimi i hapur janë kanal i ndërtimit të mirëbesimit. Kjo është njëherë edhe masë anti-korruptive të cilën e zbaton sektori. Është me rëndësi për çdo OSHC që t'i shpallë publikisht dhe t'i komunikojë qartë informacionet si në vijim: me çka merret (për këtë tashmë u bë fjalë në përshkrimin e parimit të parë), kush e përbën organizatën, cilat janë aktivitetet dhe cilat janë rezultatet e punës së organizatës, si dhe kush është donator dhe në cilën shumë i mbështet aktivitetet e organizatës. Azhurnimi i rregullt i këtyre të dhënave nga ana e OSHC-ve mbron tërë sektorin civil dhe mundëson që të mbrohet nga akuzat për vepra të natyrës korruptive.

Cilat informacione është më e dëshirueshme të publikohen?

MISSIONI I ORGANIZATËS.

Për këtë tashmë është shkruar në përshkrimin e parimit 1.

KUSH E PËRBËN ORGANIZATËN?

Organizatën e përbëjnë njerëzit, njohuritë, shkathtësitë, motivimi dhe interesat e tyre. Është me rëndësi të paraqitën informacionet për anëtarët e Këshillit Drejtues, të drejtorit/drejtores dhe të të punësuarve në organizatë, si dhe një informacion i shkurtë se kush janë këta njerëz. Rekomandohet që në ueb-faqe të publikoni edhe biografinë e shkurtë të njerëzve të organizatës nga e cila mund të kuptohet në mënyrë të qartë se ata njerëz kanë kompetenca, përvojë relative dhe motivim përkatës.

AKTIVITETET DHE REZULTATET E PUNËS SË ORGANIZATËS.

Po qe se ueb-faqet e organizatës suaj dhe materialet tuaja promovuese nuk përmbajnë informacionin për aktivitetet dhe rezultatet e punës, mund të gjendeni në situatë që opinioni t'u perceptojë

si jo aktiv, si organizatë që ekziston vetëm në letër. Nga ana tjetër, është e nevojshme t'i prezantoni rezultatet e OSHC-së në mënyrë që mos të vij deri dyfishimi i aktiviteteve në sektorin civil. Në të vërtetë, nuk është situatë e

Rrjeti SIGN përbëhet nga 6 fondacione nga shtete të ndryshme të Ballkanit. Fjala është për fondacionet të cilat i publikojnë rregullisht raportet vjetore, ueb-faqet e të cilave përmbajnë të dhëna për aktivitete dhe donatorët. Fondacioni „Mozaik” nga Bosnja dhe Hercegovina në ueb-faqen e vet në mënyrë interesante i ka paraqitur donatorët e tij, duke siguruar edhe publikim e emrave të individëve të cilët i kanë ndihmuar aksionet pas përmblytjeve të vitit 2014 (www.mozaik.ba/bs-lat/donatori-2015). Kjo praktikë i dërgon OSHC mesazh të rëndësishëm – të gjitha donacionet dhe të gjithë donatorët janë njësoj të rëndësishëm.

rrallë që, për shkak të komunikimit të pamjaftueshëm brenda sektorit dhe/ose komunitetit të donatorëve, thuaja se projektet identike të përsëriten nga viti në vit. Po ashtu, publikimi i të dhënave për rezultate mund të bëjë të mundur që edhe OSHC-të e tjera të punojnë në përmirësimin e rezultateve tashmë të arritura, duke krijuar sinergji të ideve dhe aksioneve të ndryshme.

KUSH JANË DONATORËT DHE SA PARA NDAJNË PËR CILAT AKTIVITETE?

Rekomandohet që në ueb-faqe dhe në material promovuese të theksohet në mënyrë të qartë se kush janë donatorë të organizatës, sa fonde ndajnë dhe për cilat projekte.

SI I SHPENZON ORGANIZATA FONDET E MBLEDHURA.

Për këtë segment do të bëhet fjalë më gjerësisht në paraqitjen e parimeve në vijim.

Është me rëndësi që paraprakisht të merreni vesh me donatorin se a dëshiron dhe si të paraqitet në materialet tona. Donatorët ndërkombëtarë i kanë rregullat e tyre, që në shumicën e rasteve janë pjesë përbërëse e kontratës për grantin. Kur i mblidhni fondet nga

Një ndër problemet e sektorit civil në të gjitha shtetet e Ballkanit janë të ashtuquajturat organizatat GONGO. Janë këto organizata joqeveritare që i ka instaluar pushteti që formalisht të veprojnë si OSHC në mënyrë që pushtetit apo partive t'u sigurojnë fonde shtesë të qasshme për organizatat jofitimprurëse apo që të ushtrojnë ndikim në lidhje me temat e caktuara brenda vendit apo në nivelin ndërkombëtar.


Është fjala për konkurrencë jo lojale që shfrytëzon mungesën gjenerale të informacioneve për punën e OSHC-ve dhe mosnjohje të opinionit në vështrim të temave të shoqërisë civile, ndërsa kontaktet e tyre të afërta me bartësit e pushtetit i përdorin për fitimin e fondeve. Mënyra e vetme që të ruhen organizatat autentike nga kjo konkurrencë është vendosja e standardit të afarizmit të OSHC që do të krijonte detyrimin e komunikimit të hapur dhe aktiv lidhur me atë se kush e përbën organizatën, kush janë donatorët dhe cilat projekte të organizatës i realizon. Kjo do t'u siguronte edhe vetë OSHC dhe opinionit që t'i identifikojnë më lehtë organizatat GONGO.

individët dhe kompanitë kjo më së shpeshti nuk është rast i tillë, ashtu që nuk rekomandohet që ju atyre t'u ofroni më shumë opsione se si mund ta paraqesinmbështetjen e tyre. OSHC-ja mund të ofrojë dukshmërinë në ueb-faqen e saj, në fletëpalosje dhe pllakatapromovuese, në manifestimet që i organizon, përmendjen e rregullt dhe falënderimin në rastet kur janë mysafirë të medieve. Një ndër opsionet mund të jetë edhe mos përmendja e emrave të donatorëve, me një udhëzim të qartë se donatori ka dëshiruar të mbetet anonim për opinionin e gjerë. Gjithsesi, informacioni për identitetin e donatorit duhet të ekzistojë në organizatë dhe të jetë e qasshme për organet shtetërore po qe se kërkojnë sipas mënyrës së rregulluar me ligj. Detajet për atë se si kjo të zbatohetnë vepër do t'i gjeni në përshkrimin e parimit 12, si dhe në kapitullin e tretë dhe të katërt të Manualit.

Kur OSHC bën fushatën e mbledhjes së fondeve nga individët dhe kompanitë, fushata mund të zgjatë më shumë dhe në mënyrë periodike edhe të përsëritët. Standardet për mbledhjen e fondeve e përkujtojnë

organizatën se është me rëndësi që rregullisht të publikohen informacione mbi shumën e mbledhur gjatë kohës së vazhdimt të fushatës për mbledhjen e donacioneve. Është fjala për parimin i cili nuk lidhet vetëm me transparencën, por është i rëndësishëm edhe për mbledhjen e suksesshme të fondeve, veçmas në gjysmën e dytë të fushatës më afatgjatë.

Në të vërtetë, me të filluar të fushatës, një numër i madh njerëzish interesohet që nga momenti i parë. Po qe se pas dy deri në tri javë opinioni nuk ka qasje ë informacione për sasinë e parave të mbledhura, atëherë donatorët potencialë nuk do të jenë të sigurt se a e ka vlejtur të "investohet" në atë kompani. A mos kompanisë i shkojnë keq punët dhe OSHC-ja nuk do t'ia dalë që t'i mbledh të gjitha fondet? Nëse do ti jepja paratë, ka mundësi që t'i jap për një ide e cila nuk do të ketë sukses? Janë këto pyetjet të cilat secili donator potencial (individ apo kompani) i shtrojnë në atë moment.



PARIMI 4. PARANDALIMI I KEQPËRDORIMIT TË FONDEVE DHE PASURISË, MASAT NË RAST TË KEQPËRDORIMIT

OSHC-të do të mbrojnë përdorimin e fondeve dhe do të krijojnë mekanizma për parandalim të keqpërdorimit të fondeve dhe pasurisë, si dhe do të ndërmarrin masa përkatëse po qe se vërejtet deri të keqpërdorimi.

Ky parim përmban në vete pyetjen senë ç'mënyrë sigurohet organizata që paratë e mbledhura dhe pasuria të përdoren për qëllimin për të cilin janë destinuar. Më shumë se kaq, si të dijë opinioni se organizata është në gjendje për të siguruar përdorimin përkatës të paratë dhe pasurisë.

Secila organizatë, edhe e madhja edhe më e vogla, i ka praktikatat e veta sipas të cilave vepron me paratë. Organizatat më të mëdha i kanë edhe procedurat e shkruara të cilat përshkruajnë në mënyrë të hollësishme se si zbatohen veprimet e pagesës, të furnizimeve të vlerës më të vogël dhe më e madhe, si mbahet evidenca e shpenzimeve dhe shumë procedura të tjera. Megjithatë, pa marrë parasysh madhësinë e organizatës dhe shkallën e formalitetit në punë, të gjitha organizatat hyjnë në afarizmin financiar dhe është e nevojshme të vendosen disa standarde në kryerjen e punëve vijuese⁶:

UDHËHEQJA E FINANCIVE

Brenda organizatës janë njerëzit të cilët janë përgjegjës për aspekte të ndryshme të veprimtarisë financiare

⁶ Për më shumë informacione shiko: Jenny Gilmore, NGO Policy and Procedures Manual, si dhe përshkrimet e hollësishme të aktiviteteve në kapitujt dhe 4 të këtij Manuali.

të OSHC-s. Punët në kuadër të afarizmit financiar janë të ndara qartë brenda ekipit i cili përbën organizatën dhe secili e kryen punën e tij në përputhje me përshkrimin e asaj pune. Është e domosdoshme që në afarizmin financiar OSHC t'i respektojë ligjet e shtetit të vet, si dhe kërkesat nga kontrata për donacion apo grant.

PLANI I SHPENZIMEVE

Para fillimit të çfarëdo aksioni goftë të mbledhjes së fondeve, është e domosdoshme të hartohet plani real i buxhetit që do të shpenzohet për destinimin për të cilin mbledhen fondet. Plan i shpenzimeve duhet të jetë real dhe duhet të sigurojë që aktivitetet për të cilat i mbledhim fondet mund të realizohen në vëllimin dhe përmbajtjen e premtuar.

Në kuadër të programit dyvjeçar Civil Society Forward, që e kanë zbatuar Instituti për Zhvillim të Qëndrueshëm (ISC) dhe USAID në Serbi, janë përzgjedhur 11 OSHC të cilat kanë kaluar përmes një procesi intensiv të avancimit të procedurave të tyre në fushat e afarizmit financiar, të furnizimeve dhe burimeve njerëzore. Objektivi i gjithë iniciativës ka qenë që në këto 11 organizata t'a ngrit shkallën e llogaridhënies në punën e tyre. Këto organizata edhe pas përfundimit të programit i përhapin praktikatat e mira të cilat i kanë përvetësuar. Më shumë informacione mund të gjeni në lidhjen: www.iscserbia.org/indexENG.html

OPERACIONET FINANCIARE

Organizata duhet t'i respektojë rregullat dhe ligjet të cilat parashikojnë raportin e OSHC-ve me bankat. Shtetet kanë rregulla të ndryshme në këtë aspekt, mirëpo në shumicën e shteteve kërkohet që, në afatin e kufizuar kohor dhe me një dokumentacion përkatës, të gjitha paratë e mbledhura në të gatshme të deponohen në llogarinë bankare. Është e domosdoshme që në organizatë të autorizohet personi për punë me llogarinë bankare, i cili në të njëjtën kohë është edhe penalisht edhe materialisht përgjegjës për këtë segment të afarizmit financiar. Rekomandohet që për çdo transaksion urdhëresën për pagesë ta nënshkruajnë më së paku dy persona nga organizata për t'u siguruar kontrolli i brendshëm shtesë dhe verifikimi, si dhe për t'u shmangur gabimet e panevojshme. Po ashtu, rekomandohet që për shpenzime në shuma më të mëdha OSHC të kërkojë miratimin e Këshillit të saj drejtues.

RAPORTIMI I RREGULLT FINANCIAR

Fjala është për raportimin mujor i cili përfshinë pasqyrën e shpenzimeve në periudhën për të cilën raportohet, gjenden në llogaritë e OSHC dhe krahasimin me planin e shpenzimeve. Në sajë të raportimit të brendshëm financiar, organizata jo vetëm se punon në parandalimin e keqpërdorimeve eventuale, por ia bën vetës të mundur që të reagojë shpejt në kërkesat e opinionit të interesuar lidhur me informacionet për fondet e mbledhura dhe të shpenzuara.

AUDITIMI I PAVARUR FINANCIAR

Fjala është për standardin e afarizmit i cili është kryesisht karakteristikë e OSHC-ve me një buxhet më të madh. Këtu nuk mendohet vetëm për auditimin e shpenzimeve në projekt, por para së gjithash në praktikën që OSHC-të në mënyrë të rregullt, një herë në vit, të bëjë auditimin vjetor financiar të gjithë afarizmit të saj. Këto raporte do të duhej të shpalleshin publikisht në ueb-faqen e organizatës.

DanChurchAID (DCA) është organizatë e cila është ballafaquar me rastet e korrupsionit lidhur me punën e tyre ndërkombëtare në mesin e dekadës së kaluar. Reagimi i tyre ka befasuar shumë kë - ata kanë filluar që rregullisht të publikojnë në ueb-faqen e tyre informacione për këto raste, si dhe çka ka bërë OSHC për t'i mbrojtur fondet dhe pasurinë. Edhe përkundër imazhit të keq që është shfaqur rreth këtyre rasteve, në sajë të këtij reagimi OSHC ka vazhduar që me sukses të mbledhë fonde, madje edhe i ka rritur të hyrat e saj nga individët në vitin 2009, duke e rritur buxhetin e saj në rreth 123 milionë euro. Për shkak të sjelljes së përgjegjshme dhe transparentet kësaj organizate, rastet e korrupsionit lidhur me punën e tyre nuk kanë ndikuar negativisht tek donatorët e tyre, përkundrazi! Më shumë për këtë dhe për raste të ngjashme mund të lexoni në lidhjen: <http://www.odihpn.org/humanitarian-exchange-magazine/issue-52/corruption-in-the-ngo-world-what-it-is-and-how-to-tackle-it>.

PROKURIMET DHE PAGESA E MALLIT DHE SHËRBIMEVE

Secila organizatë i bën këto prokurime, pa marrë parasysh madhësinë e saj dhe lartësinë e buxheteve projektuese. Është e rëndësishme që organizata t'u qaset me përgjegjësi këtyre punëve. Procedurat e prokurimit mund të jenë të shkruara dhe të pa shkruara, mirëpo është e domosdoshme të sigurohet që organizata me rastin e pagesës të jetë e sigurt se oferta e marrë është më e volitshmja në aspektin e raportit të çmimit dhe cilësisë së mallit dhe shërbimeve të kërkuara. OSHC-ja e cila i publikon thirrjet për oferta dhe furnitorë me rastin e realizimit të aktiviteteve të saj është më transparente se të tjerat dhe rrezikon më pak që të paditet për favorizimin e disa furnitorëve apo edhe për marrëveshje për kthimin e parave nga ana e furnitorëve të cilët janë angazhuar.

NDARJET PËR PAGA DHE SHPENZIME ADMINISTRATIVE

Është e dëshirueshme që opinioni të mund t'i marrë informacionet se çfarë përqindje e buxhetit të OSHC-ve shkon për paga dhe shpenzime administrative. Në këtë mënyrë OSHC-të u shmangen akuzave se ekzistojnë vetëm për shkak të pagave të tyre.

OSHC duhet po ashtu t'i respektojë ligjet lidhur me blerjen e pasurisë së tundshme dhe të patundshme, mbajtjen e evidencës së pasurisë dhe të inventarit të organizatës. OSHC-të mund të bëjnë edhe më shumë se që kërkon ligji, përmes procedurave të brendshme në lidhje me shënimin e pasurisë së organizatës, rregullat për dhënien e pajisjeve etj.

Në fund, çka bën organizata po që se vjen deri te keqpërdorimi i fondeve? Para së gjithash, procedurat e përshkruara paraprakisht sigurojnë jo vetëm që të vijë deri te parandalimi i keqpërdorimit, por që edhe të përcaktohen lehtë përgjegjësia dhe arsyeja e shfaqjes së keqpërdorimit. Është e domosdoshme që organizata të jetë në gjendje që aty për aty t'i ndërmerr masat që të mbrohet vetë nga pasojat e keqpërdorimeve. Çdo OSHC do të duhej që t'i zhvillojë mekanizmat e saj të reagimit në keqpërdorim, të cilat janë në pajtim me mënyrën në të cilën organizata menaxhon me fondet dhe pasurinë. Qëllimi i këtyre procedurave është që të sigurohet që vetë OSHC të jetë në gjendje që përpara të gjithë të tjerëve të detektojë keqpërdorimin e mundshëm apo tashmë të realizuar dhe të ndërmerr masat e mbrojtjes.

PARIMI 5. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI I HAPUR NË PROÇESIN E MBLEDHJES SË FONDEVE

OSHC do të zbatojë procesin e mbledhjes së fondeve në mënyrë transparente, duke komunikuar hapur për qëllimin, aktivitetet dhe nevojat për shkak të të cilave i mbledh fondet dhe nuk do të jep premtime të rrejtshme apo të krijojë pritje joreale tek donatorët nga të cilët kërkohet mbështetja.

Informacioni kyç i cili siguron transparencën e mbledhjes së fondeve është e dhëna nga kush OSHC kërkon fonde dhe kush i jep donacion asaj OSHC-je, para apo donacione të tipit tjetër, a janë këta vetëm donatorë ndërkombëtarë apo organizata ka

donatorë në mesin e individëve, kompanive dhe në sektorin publik.

Gjatë fushatës së mbledhjes së fondeve është me rëndësi që opinioni i interesuar mund të dijë lehtë se sa para keni mbledhur në cilin do moment të fushatës qoftë, si dhe të informohet lidhur me atë se kur ka përfunduar aksioni dhe kur pushon mbledhja e fondeve. Teknologji të bashkëkohëse sot krijojnë mundësi të mëdha që ky proces të realizohet në mënyrë të thjeshtë, madje edhe në aspektin vizual interesant. Përveç shumës, ndani informacionet për atë se kush ka thënë deri më tani fonde, sa dhe në ç'mënyrë (grant, donacion individual, blerje e produkteve në ankand të cilin e keni organizuar...), që është në të njëjtën kohë rast edhe për t'i falënderuar të gjithë ata që na kanë mbështetur.

Gjatë mbledhjes së fondeve duhet të jemi të qartë se cili është qëllimi i gjithë aksionit. Dhe këtu nuk guxojmë të mos jemi preciz. Nëse, për shem-

bull, pohojmë se i mbledhim fondet për ndërtimin e shtëpive të sigurta në Serbi, ndërsa kemi vendosur që t'i ndërtojmë vetëm në Vojvodinë, a jemi sa duhet të sinqertë ndaj donatorëve tanë potencialë? Po qe se pohojmë se me mbledhjen shumës së caktuar do të ndihmojmë që të sigurohet strehimi dhe ushqimi për 2000 refugjatë, kurse reale është që vetëm 1000 mund të marrin ndihmën përkatëse me atë shumë, a kemi qenë korrekt ndaj donatorëve? Kur e përcaktoni qëllimin e aksionit të mbledhjes së fondit, të jeni sa më preciz në planifikim dhe promovim. Të jeni të sigurt se qëllimi do të përmbushet me paratë e kërkuara, se do ta arrini ndryshimin të cilin e premtoni. Organizata duhet të jetë e vetëdijshme edhe për kufizimet në kapacitetet vetanake. Ndoshta me ndonjë shumë të parave edhe mund të arrihet qëllimi i mbledhjes së fondeve, mirëpo: a kemi ne kapacitete që ta realizojmë deri në fund këtë aksion? Ndoshta edhe mund të mbledhim para për t'u ofruar ndihmë 2000 refugjatëve?

Në fund të fundit, duke marrë në vitin 2015 shembullin aktual me krizën e refugjatëve, a është pikërisht ndihma që duam t'u ofrojmë tipi i ndihmës që u nevojitet refugjatëve? Si e dimë se është ashtu? A e kemi bërë hulumtimin përkatës të nevojave para se e kemi filluar grumbullimin e fondeve?

Catalyst Balkans në ueb-faqen e vet publikon raportet vjetore të filantropisë. Hulumtimi përfshinë 7 shtete të Ballkanit dhe është e mundshme qasja ndaj të dhënave më të ndryshme lidhur me donacionet dhe iniciativat për mbledhjen e fondeve në nivel të shteteve veç e veç dhe tërë rajonit. Në ueb-faqe mund të kërkoni numrin dhe shumën e donacioneve sipas tipit të donacioneve, tipit të donatorëve, destinimit, tipit të përfituesve të donacioneve dhe kritereve të tjera të shumta **Vizitoni lidhjen:** <http://catalystbalkans.org/en/home/resources>.

Nëse nuk e kemi bërë, aksioni ynë ndoshta do të pengojë që ndihma më se e nevojshme të shkojë në duar të duhura dhe në mënyrë të duhur, sepse një pjesë të mjeteve të përcaktuara për këtë situatë ndoshta i kemi shpenzuar kot së koti në gjërat që askujt nuk u nevojiten?

Një numër i madh i OSHC-ve e bën gabimin e ngjashëm kur aplikon tek donatorët ndërkombëtarë – hartojnë projekte tejte ambicioze. Të bindur se me veprimet tyre ambicioz do ta impresionojnë donatorin apo se ndoshta do të jenë më “konkurrues” në raport me projektet e tjera, një numër i madh i organizatave në përshkrimin e projektit të tyre fusin sa më shumë aktivitet, objektiva, rezultate të pritura. Përvoja në punë me OSHC tregon se këtu shpesh nuk ka qëllim të keq – përfaqësuesit e këtyre organizatave vërtet duan ta bëjnë gjithë këtë, duke investuar ndoshta edhe punën e tyre jashtë orarit dhe vullnetare. Mirëpo, mendimi i tillë mund të jetë i gabueshëm për shumë arsye. Në këtë mënyrë shfaqen projekte jo koherente. Këto janë ato projekte që nuk kanë një fokus të qartë, ndryshim saktësisht të theksuar për të cilin është i përkushtuar i tërë ekipi. Me

shtimin e numrit të objektivave dhe rezultateve të pritura, OSHC e humb fokusin dhe i përzgjedhë me vështirësi prioritetet me rastin e realizimit. Donatorët janë në gjendje ta identifikojnë rrezikun e tillë dhe shpesh i refuzojnë projektet e tilla, sepse duken tejte ambicioz dhe jo të fokusuar. Donatorët janë të vetëdijshëm për rrezikun që e bartë një qasje e tillë.

Situata e ngjashme është edhe me kompanitë dhe individët, mirëpo këtu ka një rrezik shtesë që duhet ta keni parasysh. Për dallim nga donatorët të cilët i kanë komitetet e tyre seleksionuese dhe njerëzit që i lexojnë të gjitha projektet tuaja, individët dhe kompanitë në shumicën e rasteve nuk janë të interesuara që t’u kushtojnë aq shumë kohë juve. Po qe se jeni tepër ambicioz dhe parashtroni më shumë objektiva, ekziston rreziku i madh që vetëm do t’i hutoni donatorët potencialë, se do të lëni përshtypjen e dikujt që në të vërtetë nuk është i sigurt se çka dëshiron. Në komunikim me këta donatorë është me rëndësi të paraqitet në mënyrë të qartë rezultati konkret të cilin duam ta arrijmë me aksionin tonë. Ky parim mund t’u ndihmojë që të zhvilloni raporte afatgjate me dona-

torë. Të gjithë donatorët dëshirojnë që t’i mbështesin tregimit e suksesshme, kurse fokusi juaj i qartë në punë do të kontribuojë për të përcaktuar më lehtë se cili është suksesi juaj, si ta arrini, e pastaj që për këtë edhe më lehtë të komunikoni me opinionin e interesuar. Kur ta realizoni suksesin kështu të përcaktuar, të gjithë do të jenë në gjendje që ta identifikojnë, e pastaj edhe vetë do të dëshirojnë të marrin pjesë në suksesin tuaj të radhës. Duhet të kihet parasysh që në këtë aspekt duhet përherë të jemi deri në fund të sinqertë me donatorë. Nganjëherë edhe vetë jemi të vetëdijshëm se ka fakte në lidhje me aksionin tonë që pukjanë në të mirën tonë. Duhet vërtet të gjendet mënyra që për këtë të komunikojmë me donatorët potencialë. Nëse i heshtim informacionet e tilla, kurse ato shfaqën në opinion pa pjesëmarrjen tonë, kredibiliteti i OSHC tonë mund të rrezikohet jashtëzakonisht.

Stacionari në SHBA ka ndërmarrë fushatën e mbledhjes së fondeve me qëllim që të ndërtohet krahuri i ri dhe të rritet kapaciteti i objektit nga 80

në 200 shtretër. Fushata ka filluar mirë sepse qëllimi i mbledhjes ka qenë jashtëzakonisht fisnik dhe i identifikuar si i rëndësishëm në komunitetin lokal. Një muaj më vonë, gazetari lokal ka konstatuar se për asnjë moment në periudhën trevjeçare nuk janë plotësuar më shumë se 65 shtretër në krahun ekzistues të stacionarit! Pas publikimit të rrëfimit, përfaqësuesit e fushatës ia kanë sqaruar opinionit s kapaciteti nuk është plotësuar për shkak të kushteve të këqija në stacionarin ekzistues, i cili po ashtu do të rregullohet me paratë e mbledhura. Fushata në fund nuk ka pasur sukses, sepse opinionin e ka humbur mirëbesimin – është dukur sikur i kanë fshehur me qëllim informacionet e rëndësishme. Nga ana tjetër, njerëzit që e kanë udhëhequr fushatën në fillim kanë vendosur që mos t’a paraqesin gjendjen e keqe ekzistuese në stacionar, sepse kanë menduar se kjo do ta rrezikonte fushatën. Pikërisht hapja e pamjaftueshme drejtpërdrejtë ka sjellë mospërfundim të mbledhjes së fondeve.

PARIMI 6. SHFRYTEZIMI I PËRGJEGJSHËM, EFIKAS DHE EFEKTIV I DONACIONEVE TË MARRA

OSHC do t'i shfrytëzojë donacionet e marra në mënyrë të përgjegjshme, efikase dhe efektive, në pajtim me qëllimin për të cilin janë dhënë. Po qe se një pjesë e parave të dhëna donacion do të shfrytëzohen për shpenzime operative, kjo duhet të komunikohet paraprakisht.

Krijimi i planit të shpenzimeve (buxhetit) para fillimit të mbledhjes së fondeve është shprehja e parë e përgjegjësisë së OSHC. Në këtë mënyrë OSHC i siguron vetës mundësinë që të jetë precize në përgjigjet në pyetjet siç janë: çka do të bëjë saktësisht me paratë dhe si do të sigurojë shpenzim efikas dhe

rezultate efektive në raport me fondet e mbledhura. Më vonë, kur organizata fillon shpenzimin, nevojitet të ndërmerren masa shtesë për t'u siguruar që shpenzimi të jetë efikas. Është e nevojshme të kihet kujdes për temat si në vijim:

ARSYETIMI I SHPENZIMEVE.

Lloji i shpenzimeve që i planifikoni duhet të jetë vërtetë iarsyeshëm. Kjo nuk do të thotë që të përpiloni buxhet në shuma minimale. Kjo, para së gjithash, do të thotë të parashikoni, sa më shumë që është e mundur saktë, të gjitha shpenzimet që janë realisht të nevojshme për të përmbushur detyrën që ia keni vënë vetës. Po qe se e harroni ndonjë shpenzim të rëndësishëm, do të keni problem – paratë që do t'i mblidhni nuk do të mjaftojnë për atë që dëshironi të realizoni. Po ashtu, kini kujdes që mos të përfshini shpenzime që vërtet nuk janë të nevojshme. A do t'u dedikohen të gjitha shpenzimet mujore administrative dhe pagat në zyrë realizimit vetëm të një aktiviteti? Arsyetimi konsiston edhe në vlerësimin sa më të saktë të vëllimit

Disa OSHC zbatojnë mbledhjen e fondeve ashtu që donatorëve potencialë ua ofrojnë “shopping listat”. Shopping lista përmban regjistrin e gjithë asaj që është e nevojshme për zbatimin e një aksioni, ndërsa donatorët paguajnë shumën e “zërit” nga “shopping lista”. Për ndërtimin e shtëpisë mund të jenë këto tulla, apo trarë druri, ku donatori e regjistron sasinë dhe e paguan shumën e caktuar. Është fjala për teknikë interesante në sajë të së cilës donatori e di saktësisht se çka ka siguruar donacioni i tij/saj. Multiple Sclerosis Society nga Mbretëria e Bashkuar është një nga organizatat e shumta të cilat në këtë mënyrë i mbledhin fondet me mjaft sukses.

të produkteve dhe shërbimeve që u nevojiten për realizimin e projektit, si dhe në çmimin real që është i qasshëm

EFIKASITETI NË SHPENZIME.

Këtu është kyçe çështja nëse me shumën e planifikuar dhe me paratë e mbledhura mund të bëjmë më shumë se që kemi planifikuar. A ka ndonjë mënyrë tjetër për ta zgjidhur problemin në komunitetin lokal, mënyrë që është më efektive dhe më e lirë? Këto janë disa nga pyetjet kyçe të efikasitetit të shpenzimeve. Po qe se me aksionin tonë mbledhim mjete për ndërtimin e banesave sociale, duhet të përpiqemi që shpenzimet që i kemi parashikuar të jenë maksimalisht efikase. Po qe se shpenzimet e ndërtimit për metër katror, në cilësinë e kërkuar, do të jenë të barabarta apo më të mëdha se çmimet ekonomike të investitorit në treg, kjo gjithsesi tregon se aktiviteti ynë është joefikas (investitorët në çmimin e tyre të metrit katrorë e llogaritin fitimin e tyre). Po qe se OSHC tjetër tashmë i ka rregulluar tre parqe për 50.000 EUR në mënyrën që i përmbushin nevojat e banorëve lokalë, do të jetë vështirë të mblidhen 100.000 EUR për një të cilësisë së njëjtë apo diç më të mirë nga tre parqet e përmendura.

FONDET SHPENZOHEM PLOTËSISHT PËR DESTINIMIN PËRKATËS.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të gjitha paratë e mbledhura t'i destinohet nëaktivitetin për të cilin i kemi mbledhur fondet. Nuk mund që nëmes të aksionit paratë e mbledhura për park t'i riorientojmë në ndërtimin e kopshtit të fëmijëve sepse na është dukur se është kjo mënyrë më e mirë e shpenzimit të mjeteve. Donatorët që i kanë dhënë fondet për park ndoshta nuk duan që ato para t'i japin për një destinim tjetër. Po ashtu, po që se pas mbledhjes së mjeteve dhe realizimit të aktivitetit na mbesin ende para, duhet ta kemi paraprakisht të përcaktuar destinimin për ato para. Për këtë do të ketë më shumë informacione në përshkrimin e parimeve të mëtuajtshme.

SHPENZIMET OPERATIVE U PARAQITEN PARAPRAKISHT DONATORËVE.

Po që se planifikoni që një pjesë të mjeteve të mbledhura ta shfrytëzoni për shpenzime operative (shpenzime të zyres, pr shpenzimin energjisë elektrike dhe shpenzimet regjisë apo për paga të të punësuarve), nevojitet që këtë t'u paraqitni në mënyrë të qartë donatorëve potencialë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur keni donatorë të cilët nuk kërkojnë buxhet të hollësishtëm nga ju.

Të gjithë donatorët janë jashtëzakonisht të interesuar se s'shpenzohen paratë e tyre dhe nuk dëshironi që dikush të jetë i dëshpëruar në këtë aspekt. Prandaj është me rëndësi të thuhet paraprakisht s'çfarë përqindjeje e buxhetit do të ndahet për paga dhe shpenzime administrative poqë se dëshironi që edhe këto shpenzime t'i mbulonin nga fondi i donatorëve. Lartësia e pagave të cilën e parashikoni duhet të jetë në pajtim me çmimin e punës në tregun lokal.

SHPENZIMET E VETË MBLEDHJES SË FONDEVE NUK GUXOJNË TË JENË NË SHPËRPPJESËTIM NË RAPORT ME SHPENZIMET E AKTIVITETIT PËR TË CILIN I MBLIDHNI FONDET.

Bie fjala, reklama televizive në stacionin lokal TVmund të jetë jashtëzakonisht e shtrenjtë. Po që se vet reklama kushton shumë më tepër se shuma që e mbledhim për ndonjë aktivitet, shtrohet pyetja përse nuk i kemi ndarë mjetet e përcaktuara për reklamë që t'u ndihmojmë drejtpërsëdrejti përfituesve tanë apo grupeve të synuara? Po që se shpenzimet e darkës së donatorëve janë shumë më të mëdha se shuma e fondeve të mbledhura, për çka atëherë darka e donatorëve? Është e dëshirueshme që OSHC t'i kyç furnitorët e saj në aksion në mënyrë që të sigurojmë kushte sa më të volitshme për zbatimin

e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve. Është plotësisht legjitime të kërkohej çmim më i volitshëm për emetimin e reklamave në stacionin TV apo shpenzime të mbuluara të darkës së donatorëve nga restoranti apo sponsori në emër të natyrës jofitimprurëse të aksionit tuaj.

EDHE KOHA ËSHTË RESURS QË NEVOJITET TË SHFRYTËZOHET ME EFIKASITET

Ky parim ka të bëjë edhe me kohën tuaj edhe me kohën e donatorëve tuaj. Nevojitet t'u sigurohet donatorëve potencialë sa më shumë mundësi për të dhuruar mjete dhe që vetë ati i dhënies së donacionit të mos kërkojë tepër shumë kohë dhe mund. Po që se është e nevojshme që donatori t'i paguaj paratë në llogari, gjë që do ta bënte më parë po që se ju e siguron dëftesën tashmë të plotësuar të cilën vetëm se duhet çuar në bankë p apo të përshkruhen të dhënat në programin për pagesë në internet. Dërgimi i mesazhit SMS me donacion është më i lehtë për donatorin se sa shkuarja në bankë. Nga ana tjetër, angazhimi i ekipit në organizatën tuaj dhe koha dhe munda kushtuar aksionit të mbledhjes së fondeve janë po ashtu faktor i rëndësishëm i planifikimit. Po që senjë koncert sjell efektin e njëjtë sikurse edhe festivali treditur, përse të organizohet i tërë festivali?

Ueb-faqja Amerikane www.charitynavigator.org përcjellë më shumë parametra të cilët tregojnë për cilësinë dhe standardet për mbledhjen e fondeve. Standardi i efikasitetit në lidhje me shpenzimet që i kanë përcaktuar është që të pritët që për çdo 50 centë të shpenzuar për shpenzime të vet mbledhjes së fondeve duhet të mblidhni më së paku 1\$. Të dhënat që i publikojnë në uebfaqe tregon që OSHC mesatarisht e suksesshme shpenzon rreth 15 centë për shpenzime të aktivitetit të mbledhjes së fondeve për çdo dollar të mbledhur. Në faqen e tyre donatorët potencialë marrin informacione se disa OSHC shpenzojnë në këtë mënyrë madje edhe deri në 40% të parave të mbledhura, që nuk u ndihmojnë drejtpërsëdrejti njerëzve të cilëve u dedikohen paratë. Në nën faqen 10 Inefficient Fundraisers i keni të dhënat për 10 OSHC Amerikane të cilat janë më efikasë në shpenzime, ku për vitin e kaluar në vendin e parë është fondacioni i cili ka \$1.75 për çdo dollar që kanë arritur ta mblidhin!

PARIMI 7. MENAXHIMI I FONDEVE NË RAST TË PËRFUNDIMIT TË MBLEDHJES PËR SHKAK TË FUQISË MADHORE, TË MBLEDHJES SË SHUMËS MË TË VOGËL APO MË TË LARTË SE QË ËSHTË PLANIFIKUAR

OSHC do të përcaktojë në mënyrë publike dhe të qartë se si do të menaxhojë me fondet që janë mbledhur në fushatat që kanë përfunduar për shkak të fuqisë madhore apo vjetërsimit të arsyeve për mbledhjen e mjeteve, si dhe në rastet kur shumatat e mbledhura janë më të mëdha apo më të vogla nga shumata paraprakisht e planifikuar e mbledhjes së fondeve.

Është e pamundur të parashikohen të gjitha rrethanat dhe ndikimet e mjedisit që mund ta rrezikojnë aksionin tonë të mbledhjes. Fatkeqësitë natyrore janë gjithsesi shembull, mirëpo edhe një gërshetim më i thekshtë i gjërave mund të sjellë deri tek problemet. Bie fjala, OSHC mbledhë fonde për paisjen e parkut publik në komunën vet, mirëpo në mes të aksionit vetë kuvendi i orienton mjetet për rregullimin e po atij parku. Apo rasti në të cilin OSHC mbledh fonde për blerjen e patundshmërisë për nevojat e ofrimit të shërbimeve të qendrës ditore të përfituesve të saj, mirëpo gjatë aksionit bëhet një ndryshim i madh i çmimit të patundshmërive. Lloji tjetër i rrethanave në të cilat nganjëherë është e pamundur të ndikohet janë situatat kur OSHC mbledhin më

Në kuadër të programit Akademia pwrQëndrueshmëri, i cili zbatohet përmes rrjetit SIGN në 6 shtete, një numër i organizatave të mbështetura lokale ka mbledhur më shumë fonde se shumatat e pritura. Duke qenë se rrjeti SIGN paraprakisht kishte siguruar trajnim për të gjitha organizatat, të gjitha ato e kishin të gatshëm planin se çka do të bëjnë me tepriçën e fondeve nwse fushatat e tyre drejt individëve dhe kompanive do të jenë më të suksesshme se pritja – janë parashikuar numra shtesë të fidanit të drunjve në njërin iniciativë, elemente shtesë të dhomës mësimore verore, te e dyta, blerja e pajisjes cilësore për

OSHC në iniciativën e tretë. Trajnimi ka përfshirë edhe përkufizimin dhe kumtimin e këtij mesazhi donatorëve, sepse mënyra në të cilën kumtohet ky mesazh mund t'i kontribuojë mjaftë suksesit në mbledhjen e fondeve.

pak fonde në krahasim me shumën e nevojshme për realizimin e aksionit. Si të veprohet në situata të tilla? Si të jeni të gatshëm edhe për rrethana të tilla të papritura?

OSHC NUK GUXON QË NË MËNYRË TË PAVARUR TË VENDOSË PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PARAVE TË MBLEDHURA PËR SHKAK TË FUQISË MADHOR APO SHFAQJES SË RRETHANAVE TË PAPARASHIKUESHME.

Shtetet e rajonit nuk e kanë të rregulluar me ligj procedurën lidhur me këtë çështje, dhe kjo hapë probleme të mëdha në rastet të cilat janë përshkruar në pasuset e mëparshëm. Në Mbretërinë e Bashkuar kjo procedurë është përcaktuar në mënyrë precize. Kemi të bëjmë me një procedurë komplekse për të cilën rekomandohet angazhimi avokatit. OSHC ia paraqet rastin e saj komisionit qeveritar kompetent për organizata të bamirësisë (Charity Commission) në Angli, përkatësisht Zyrës së Organit mbikëqyrës skocez për organizata të bamirësisë (Office for the Scottish Charity Regulator-OSCR) në Skoci. Madje edhe në rastet kur donatorët e japin pëlqimin për ndryshimin e destinimit të pasurisë që e kanë dhënë

si donacion, OSHC në MB duhet të kërkojnë pëlqime dhe udhëzime shtesë nga këta trupa, kurse në Skoci në kushte të jashtëzakonshme OSCR mund të mund të lejojë "riorganizimin" e buxhetit madje edhe pa lejen e donatorëve. Këto raste tregojnë se sa e ndjeshme është kjo çështje edhe në shtetet me praktikë dhe përvojë të pasur në këtë fushë.

Duke qenë se në Ballkan nuk ka trupa përkatës, vetërregulluese apo shtetërore, ekziston një hapësirë e madhe për manipulime, mirëpo edhe për "thirrjen" e OSHC në publicitet për shkak të të kuptuarit të pamjaftueshëm dhe interpretimeve të banalizuar të situatave ngjara e medieve apo të palëve të interesuara. Prandaj rekomandohet që OSHC t'u shmangen situatave në të cilat në përgjithësi e ndryshojnë destinimin e parave aq sa kjo është e mundur. Po qe se shfaqen rrethana të ndryshuara për shkak të të cilave destinimi origjinal vërtetë është pa mundësiuar plotësisht, rekomandohet që para ndryshimit të destinimit të ndërpritet fushata e mbledhjes së fondeve, që donatorët të njoftohen për situatën dhe të kërkohej nga ata në formë

Mungesa e standardeve në mbledhjen e fondeve dhe mungesa e njohurive në lidhje me parimet e mbledhjes së fondeve nga ana e familjes, si dhe moskuptimi i medieve në vështrim të kësaj teme, ka shkaktuar dëm të madh, më së shumti familjes Ognjanoviq, por edhe të gjithë atyre që merren me mbledhjen e fondeve nga familjet në Serbi.

Familja Ognjanoviq në pranverën e vitit 2013 apeloi tek qytetarët e Serbisë që t'i ndihmohet Tijanës së vogël e cila ka nevojë për transplantimin e zemrës. Çmimi i operimit dhe shuma që kanë dëshiruar të mbledhin ka qenë 750.000 dollarë. Aksioni ka hasur në përgjigje të madhe të opinionit dhe mediet shpejt raportuan se në llogarinë bankare janë derdhur madje 2,6 milionë euro. Për fat të keq, vazja nuk e priti transplantimin që duhej të bëhej në Hjuston. Vdiq në korrik të vitit 2013.

Familja Ognjanoviq pas kësaj e njoftoi opinionin se mjekimi i Tijanës ka kushtuar 1,1 milion euro, ndërsa mbetjen e parave do t'i paguajnë për nevojat e mjekimit të fëmijëve të tjerë. Mediet reagues me bujë, duke i akuzuar Ognjanoviqët për keqpërdorim të fondit (mjeteve), kurse Prokuroria e Lartë në Beograd e ka çbllokuar llogarinë e familjes në prill të vitit 2015, kur ishte konstatuar se nuk kishte pasur abuzime.

me shkrim vërtetimi që pajtohen me destinimin e ri të fondeve. Me këtë rast, është e dëshirueshme që destinomi i fondeve (mjeteve) të jetësa më i ngjashëm me idenë origjinale.

OSHC DUHET PARAPRAKISHT TË PARASHIKOJË SE ÇKA DO TË BËJË NË RAST SE NUK DO TË MBLIDHEN MJAFT PARA.

Vendimi i këtillë paraprak do të ketë një domethënie të madhe për organizatën, veçmas në situatat kur mbliidhen dukshëm më pak para nga shuma e nevojshme për realizimin e aktivitetit. Natyrisht, është me rëndësi që ky vendim t'u komunikohet paraprakisht donatorëve dhe opinionit, gjë që në masë të madhe mund t'i inkurajojë njerëzit që të japin donacion të mjeteve. Asnjë donator nuk dëshiron të investojë në diçka që ndoshta nuk mund t'a dalë. Një lloj i rrjetit të sigurisë është informacioni që OSHC, po qe se nuk mbledh mjaft para, shumën e mbledhur do t'a japë për ndonjë destinim tjetër në interesin publik.



OSHC DUHET PARAPRAKISHT TË PARASHIKOJË SE ÇKA DO TË BËJË PO QE SE MBLIDHEN MË SHUMË PARA SE SHUMA E PLANIFIKUAR.

Parashikoni paraprakisht se si do të veproni po qe se mbliidhni më shumë para dhe përpuni që destinomi të jetë i ngjashëm me destinimin origjinal. Po qe se keni lëshuar ta bëni në fillim, nevojitet që të jeni shumë të kujdesshëm. Në atë rast teprica e parave nuk guxon të shpenzohet sipas automatizmit. Është e nevojshme të njoftohen donatorët se aksioni ka qenë i suksesshëm përtej pritjeve dhe të pyetën se a është në rregull që paratë e donacionit t'i shfrytëzoni në ndonjë mënyrë.

Rekomandohet që paratë të shfrytëzohen për destinim të njëjtë, duke siguruar cilësi më të mirë të aktivitetit. Në shembullin e parkut, që e përdorim në Manual, me tepricën e fondeve ka mundësi të blihen mobilie shtesë. Po qe se paratë mbliidhen, bie fjala, për blerjen e inkubatorit për maternitetin lokal, mund të kërkojmë nga donatorët që t'na lejojnë që tepricën e fondeve t'i shfrytëzojmë për gëlqerosjen e maternitetit apo për blerjen e kondicionerëve në atë

departament. Pa marrë parasysh se është evidente se destinimi i tillë është "i përshtatshëm", kërkon paraprakisht pëlqimin e donatorëve tuaj. Edhe ata do të jenë të kënaqur që e dinë se aksioni ka qenë i suksesshëm dhe se është rasti që bashkërisht të bëjmë më shumë se që kemi planifikuar. Është me rëndësi, gjithsesi, që vendimin për destinimin e tepricës së fondeve mos ta merrni vetë.

PARIMI 8. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE DHE DINJITETIT TË PËRFITUESVE DHE PËRFITUESEVE NË MBLEDHJEN E FONDEVE

OSHC do të sigurohen që të drejtat e përfituesve dhe përfitueseve të respektohen dhe se dinjteti dhe vetë respektimi i tyre janë të mbrojtur gjatë procesit të mbledhjes dhe distribuimit të fondeve, si dhe gjatë raportimit për përdorimin e donacionit.

Përfitues janë individët ose grupet e qytetarëve për të cilët paratë nga aksionet e mbledhjes së fondeve janë dedikuar direkt apo indirekt, përmes

aktivitetit që ka si rezultat zgjidhjen e problemeve të tyre apo plotësimin e nevojave të tyre.

Është e dëshirueshme gjithsesi të përfshihen përfituesit në aksionin e mbledhjes së fondeve, para së gjithash përmes identifikimit preciz të nevojave të tyre, e më vonë edhe përmes paraqitjes së rezultateve dhe sukseseve të aksionit. Megjithatë, duhet të kemi kujdes për atë që ta mbrojmë privatësinë dhe dinjtetin e përfituesve tanë, veçmas kur merremi me grupe të ndjeshme apo në situatat në të cilat gjenden përfituesit.

Aksioni “Kapak për hendikep” („Čep za hendikep”) i Shoqatës së Paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve e Banatit ka një qasje interesante. Në të vërtetë, e gjithë ajo për çka nevojitet donacioni, janë kapakët plastik të shisheve të pijeve apo kanaçet e zbrazwta. Shoqata, me anë të riciklimit të kapakëve të mbledhur dhe të kanaçeve realizon të hyra të cilat i përdorw për blerjen e mjeteve ortopedike për personat me invaliditet. Në fushatën e mbledhjes së fondeve kjo shoqatë nuk i shfrytëzon të dhënat për përfituesit, por, në masën më të madhe, përmes zgjidhjeve interesante vizuale, u tregon njerëzve për atë se sa e lehtë është të ndihmohet me këtë mënyrë të donacionit. Shoqata ne ueb-faqen e saj publikon më vonë tregimet për përfituesit të cilët kanë marrë mjetet

ndihmëse (ortopedike), duke siguruar pëlqimin e tyre për të gjitha të dhënat e publikuara. Mediet reagues në mënyrë të shkëlqyeshme për këtë aksion, sikurse edhe organizatorët e manifestimeve më të mëdha kulturore në vend.

GRUPET E PËRFITUESVE TË FONDEVE DUHET TË PËRCAKTOHEN QARTË PARA AKSIONIT TË MBLEDHJES SË FONDEVE.

Po qe se përfituesi i drejtpërdrejt i fondeve të mbledhura person apo grup personash, është e domosdoshme të merret pëlqimin formën e shkruar nga të gjithë individualisht dhe të theksohet qartë në fushatë se ata janë personalisht përfitues të fondeve Po qe se është grup i përfituesve në të cilin të gjithë i kanë disa karakteristika të përbashkëta (bie fjala, gra viktimë të dhunës), duhet të jepni përshkrimin e qartë të grupit i cili vërtetë do të marrë mbështetjen falë fondeve të mbledhura. Në shembullin e mbledhjes së fondeve për gratë viktimë të dhunës, grupi i tillë i përkufizuar në përgjithësi nuk mjafton. Nevojitet të jepet informacion i qartë për atë se në cilën fushë do të realizohet aksioni dhe cilin lloj të mbështetjes do të marrin gratë falë fondeve të mbledhura (bie fjala, përfitueset e shtëpive të sigurta në territorin e Serbisë Perëndimore do të marrin mbështetjen përkatëse të psikologut). Në fund, ekziston mundësia që të mbledhni fonde për një aktivitet të caktuar që nuk i ka përfituesit e vet të drejtpërdrejtë – bie fjala, për hulum-

time mjekësore. Në atë rast është me rëndësi të jepet përshkrimi i qartë dhe i saktë i aktivitetit dhe përshkrimi qartë i epilogut i cili pritet.



Përfaqësuesit e sektorit të OSHC-sw shpesh në rastet kur janë mysafir në emisionet nw TV, flasin për nevojën që të sigurohen përmbajtjet për të rinjtë në komunitetin lokal. Si problem theksojnë se të rinjtë, në mungesë të përmbajtjes, u qasen narkotikëve, alkoolit dhe sjelljeve anti-sociale.

Duhet të parashtrohet çështja e efikasitetit dhe etikës së qasjes së tillë. A rekomandojmë ne në këtë mënyrë se të gjithë të rinjtë janë me ves për nga natyra e tyre? A mos, në të vërtetë, po i stigmatizojmë të rinjtë dhe po ndërtojmë një pamje në opinion e cila të rinjtë i promovon si jo llogaridhënës për nga natyra e tyre?

Shumica e aksioneve për të rinj nuk ka pasur mbështetjen e të rinjve, sepse OSHC e cila në këtë mënyrë e udhëheq fushatën tregon se nuk i kupton, nuk i identifikon nevojat e tyre dhe statusin e tyre në shoqëri.

AKSIONET E MBLEDHJES SË FONDEVE DO TË DUHEJ TË NIXITNIN EMPATI, JO TË SHKAKTOJNË KEQARDHJE NDAJ PËRFITUESVE TANË.

Dallimi në mes të empatisë dhe keqardhjes është i madh. Ndonëse nganjëherë duket se aksioni i mbledhjes së fondeve do të jetë i më së suksesshëm po qe se nxitim keqardhje, është e domosdoshme të kemikujdes për privatësinë dhe të drejtën në dinjitet të njerëzve për të cilët bëhet fjalë. Nxitja e keqardhjes mund të sjellë edhe deri tek stigmatizimi i disa grupeve, madje edhe tek reagimet negative për interpretimin tonë “keqardhës” të pozitës së individëve dhe grupeve. Nga ana tjetër, zgjimi i empatisë përmban emocion, mirëpo në një mënyrë krejtësisht ndryshe. Empatia nënkupton mundësinë që të dimë dhe të kuptojmë, të ndjejmë diçka që njerëzit e tjerë e ndiejnë, e përjetojnë, mendojnë. Empatia lë shumë më tepër hapësirë për veprim dhe nuk i shndërron përfituesit tanë në “viktimë”. Kompanitë tona do të duhej që t'i fuqizojnë përfituesit tanë, e jo që t'i bëjnë të pandihmë dhe t'i paraqesin si të pandihmë.

PUBLIKIMI I TË DHËNAVE PËR PERSONIN DUHET TË JETË NË PAJTIM ME KORNIZËN LIGJORE NË ATË FUSHË.

Po qe se dëshironi që përmes rrëfimit për individët dhe jetët e tyre ta paraqitni fushatën tuaj të mbledhjes së fondeve, është e nevojshme të sigurohen pëlqimet përkatëse. Korniza ligjore dallon nga shteti në shtet dhe është me rëndësi të dihet se në ç'mënyrë ndikojnë në punën e OSHC ligjet sistimore, veçmas ligji i cili rregullon mbrojtjen e të dhënave personale. Nevojitet që OSHC të sigurojë pëlqimin e përfituesit që të dhënat të shfrytëzohen në fushatë, e pastaj edhe që përfituesi të ketë të mundësi ta përcjellë procesin e përpunimit të të dhënave. Pas kësaj, është e dëshirueshme të merrni pëlqimin edhe për tekstet dhe format e tjera të përpunimit të të dhënave që shfrytëzohen në fushatën e mbledhjes së fondeve. Me fjalë të tjera, para se të shtypni fletëpalosjen e cila përmban të dhënat për personin (bie fjala, foto-grafinë), ia tregoni përgatitjen për shtyp përfituesit, të dhënat e të cilit publikohen. Në fund, ligji rëndom parashikon edhe të drejtat e personave të dhënat e të cilëve shfrytëzojmë për kopje të materialit dhe sigurohuni se kjo e drejtë është realizuar.

PUBLIKIMI I FOTOGRAFIVE.

Temë posaçërisht e ndjeshme, sepse fotografia mundëson që përfituesi ynë apo grupi i përfituesve të bëhen të njohur në një mjedis më të gjerë. Fotografinë trajtojeni sikurse edhe çfarëdo të dhëne tjetër personale. Rekomandohet që të mos shfrytëzohen fotografitë që ka mundësi të shkarkohen lehtë nga interneti dhe të cilat lehtë mund të gjenden në materiale të tjera. Dëshironi që fushata juaj të jetë autentike.

INFORMACIONET PËR GRUPET E RREZIKUARA NUK GUXOJNË TË STIGMATIZOJNË INDIVIDËT APO GRUPET.

Është me rëndësi të mendohet mirë për mënyrën në të cilën i paraqesim përfituesit, në mënyrë që mos t'i kontribuojmë imazhit negativ të grupit të përfituesve. Nevojitet që OSHC t'i zhvillojë njohuritë dhe shkathtësitë e saj në fushën e komunikimit mbi nevojat veçmas të grupeve të rrezikuara, pikërisht për t'u shmangur problemeve të dala nga mesazhet e kumtuara në mënyrë të gabueshme. Grupet e rrezikuara janë të shumta, kurse disa prej tyre janë fëmijët, gratë viktimat të dhunës, përdoruesit e narkotikëve, të rinjtë me sjellje të rrezikshme, të infektuarit me HIV...

PARIMI 9. INFORMIMI I PËRFITUESVE PËR FONDET E MBLEDHURA

OSHC do t'i informojë me kohë përfituesit e saj (potencialë) për donacionet e mbledhura dhe distribuimin e tyre, qoftë përmes raportimit periodik, përmes medieve, kontaktit direkt apo përmes mënyrave të tjera relative të komunikimit.

Këtu është e nevojshme të veçohen paraprakisht tri situata të mundshme, siç u paraqitën në parimin paraprak.

KUR I MBLEDHIM FONDET PËR NDIHMË TË DREJTPËRDREJTË INDIVIDIT APO GRUPIT TË NJERËZVE, PARAPRAKISHT TË ÇAKTUAR, NEVOJITET T'U SIGUROHET MBIKËQYRJE E RREGULLT DHE E PLOTË MBI SHUMAT E MBLEDHURA TË FONDEVE, LISTËN E DONATORËVE DHE TË GJITHA TË DHËNAT E TJERA RELEVANTE.

Aksioni i mbledhjes së fondeve nuk guxon të bëhet pa pëlqimin e personave për të cilët mbledhen fondet. Nevojitet të hapet llogari e veçantë e OSHC-së destinuar vetëm për fondet (mjetet) nga aksioni që i kushtohet individit apo grupit të njerëzve. Kjo llogari nuk guxon të shfrytëzohet për mbulimin e shpenzimeve të tjera të OSHC-së. Nevojitet po ashtu të hartohet paraprakisht buxheti dhe plani i shpenzimeve, ashtu që të evitohen mosmarrëveshjet eventuale në mes të përfituesve dhe OSHC-së në lidhje me shpenzimin e këtyre fondeve. Po qe se kemi të bëjmë me grup individësh i cili është aq i madh, sa që shpenzimet e komunikimit do të ishin disproporcionalisht të mëdha në raport me shumën e fondeve të mbledhura, ka mundësi të bëhet njoftimi përmes ueb-faqes dhe medieve, mirëpo me paralajmërim paraprak të përfituesve. Të gjitha këto aktivitete shërbejnë që përfituesit e drejtpërdrejtë të fondeve të kenë mbikëqyrje të përhershme në mënyrën e mbledhjes së fondeve dhe shpenzimin e mëvonshëm.

Shpesh dëgjojmë se mbledhja e fondeve nga individët është e pa zbatueshme kur kemi të bëjmë me aksionet në fushat siç janë të drejtat e njeriut dhe evokimi. Shembulli i organizatës *Amnesty International* MB tregon se nuk është ashtu. Në të vërtetë, qysh kah mesi i viteve të 90-ta kjo organizatë bëri të ashtuquajturin *Pen Pack*. Është fjala për letrën (zarfin) që ishte dërguar në një numër të madh adresash. Në zarf ishin letra dhe lapsi. Në letër, nga njëra anë, janë paraqitur rrëfimet se si janë shfrytëzuar lapsat në botë për torturë. Rrëfimet janë vërtetë tronditëse, por të besueshme dhe të sakta. Nga ana tjetër e letrës ishte titulli: “Lapsi mund të jetë instrument i ndryshimeve”, me thirrjen që me nënshkrimin e dëftesës që gjendet në fund të asaj faqeje qytetarët e ndihmojnë luftën globale kundër torturës. Aksioni ishte aq i suksesshëm sa që ka zgjatur 10 vite në Britani, është përhapur në tërë botën dhe ende e shfrytëzon *Al Australia*.

SITUATË TJETËR SHFAQET KUR I MBLEDHIM FONDET PËR GRUP PËRFITUESISH I CILI I KA DISA KARAKTERISTIKA TË PËRBASHKËTA, POR QË NUK DIHET PARAPRAKISHT SE KUSH ËSHTË PËRFITUES I DREJTPËRDREJTË I FONDEVE.

Janë këto aksione të cilat u ofrojnë mbështetje grupit të përfituesve dhe i zgjidhin problemet e grupit të njerëzve të cilët i kanë disa veçori të ngjashme – nxënësit e shkollave të mesme në komunë, personat e moshuar që jetojnë të vetmuar, gratë viktimat të dhunës. Këtu nuk kemi përfitues të drejtpërdrejtë të cilët duhet njoftuar, mirëpo, megjithatë ekzistojnë përfituesit e ardhshëm të aktiviteteve tona për të cilët mbledhim fonde. OSHC do të duhej që përmes medieve t'a njoftojë edhe opinionin, edhe përfituesit potencialë, jo vetëm për aksionin e mbledhjes së fondeve, por edhe për mënyrat sipas të cilave do t'i kyçin njerëzit nga grupet përfituese nëpër aktivitete. Nga ana tjetër, nëse ka shoqata që tashmë i tubojnë njerëzit nga këto grupe të përfituesve apo ekziston qoftë edhe ndonjë vend i tubimit të tyre, apo thjeshtë ekzistojnë vende në qytet në të cilat

më së shpeshti gjenden grupet, do të ishte jashtëzakonisht e dobishme që ta shfrytëzojmë këtë fakt dhe, përmes materialeve promovuese apo shkurtyeve të shpeshta, të arrijmë deri tek njerëzit që mbledhen aty...

NË FUND, KEMI SITUATA KU MBLEDHIM FONDE PËR NJË QËLLIM, PA PËRFITUES TË DREJTPËRDREJTË TË AKSIONIT.

Është ky rast i shpeshtë, kurse shembujt që, ndër të tjera, mund të përmendën, janë ftesa që qytetarët t'i financojnë hulumtimet mjekësore, aktivitetet e shoqatave për mirëqenien e kafshëve, apo të aksioneve avokuese në fushën e të drejtave të njeriut. Këtu nuk kemi përfitues të drejtpërdrejtë, mirëpo fokusi i njoftimit është i orientuar drejt akterëve më të interesuar të këtyre aksioneve. Hulumtimet mjekësore janë të rëndësishme për institucionet publike në shëndetësi dhe pacientë, ndërsa mirëqenia e kafshëve është një temë diç më e rëndësishme se të tjerat për të gjithë adhuruesit e kafshëve shtëpiake.

Kredibiliteti i aksionit tonë rrjedh nga ajo që, në një farë mënyre, neve përfaqësojmë pikërisht ato palë të

interesuar dhe interesat e tyre. Së këndejmi edhe nevoja që atyre t'u drejtohem. Natyrisht, në këtë mënyrë neve na jepet rasti që nga ata të kërkojmë fonde, sepse këtu i kemi donatorët potencialisht më të interesuar.

Madje edhe kur mbledhim fonde nga donatorë të jashtëm, do të duhej të kemi kujdes për atë që njerëzit, në emër të të cilëve i bëjmë projektet, të kenë informacione për aktivitetet e planifikuara, për lartësinë e fondeve të cilat i kemi marrë, si dhe për atë se si i shpenzojmë ato fonde.

Agjencia *Dunham & Company* më 2014 publikoi hulumtimin i cili tregoi se përdorimi i efikas i veglave "on-line", veçmas ueb-faqet e krijuara jo mirë të paramenduara, sjellin deri tek ajo që OSCH-të në mënyrë globale nuk arrijnë të mbledhin disa miliardë euro!

Një ndër shkaqet është edhe fakti që gjysma e OSHC-ve në botë as në ballinë të ueb-faqes, as në rrjetet sociale, nuk e ka të përshkruar qartë ndryshimin që e sjellë në jetët e grupeve përfituese dhe rezultatet e punës së vet paraprake.

Vetvetiu, me rastin e shikimit të shpejtë të faqes përfituesi nuk është në gjendje ta identifikojë qartë se çka në të vërtetë bën OSHC-ja. Duke qenë se shumica e përfituesve në të vërtetë në sekondat e para të vizitës së faqeve vendos nëse do të qëndrojnë aty dhe t'i lexojë informacionet shitesë, pjesa dërmuese nuk interesohet që të mësojë më shumë për organizatën, që është parakusht i çdo donacioni.

PARIMI 10. PËRFSHIRJA E PËRFITUESVE NË PROÇESIN E PËRKUFIZIMIT TË QËLLIMIT TË MBLEDHJES SË FONDEVE

OSHC do të synoj të përfshij përfituesit e vet në procesin e përkufizimit të qëllimit të mbledhjes dhe shpërndarjes së fondeve dhe do t'i përfshij në vendimmarrje për shpërndarjen e mëtejme të fondeve që kanë mbetur të pashfrytëzuara pasi të jetë plotësuar qëllimi fillestar i mbledhjes së fondeve.

Për çdo OSHC, burim i legjitimitetit para se gjithash janë vlerat e njerëzve⁷. Të kemi mbështetjen e

⁷ Shih: N. Tadros, Peoples' Advocacy, Manual for trainers, USA, 2010.

qytetarëve nuk i bie automatikisht që puna jonë është legjitime – në fund të fundit, a e konsideroni legjitime një organizatë e cila është në gjendje të mbledh njerëzit që promovojnë dhunën, urrejtjen, diskriminimin? Por, njëjtë, legjitimiteti nuk vjen vetëm nga vlerat tona të përforcuara me dije, aftësi dhe qëndrime. Legjitimiteti i një OSHC-je buron edhe nga ajo se ekzistojnë njerëz, “masa kritike” e cila dallon dhe mbështetë punën tonë. Këtu, para se gjithash mendohet për shfrytëzuesit e shërbimeve dhe aktiviteteve tona, por edhe në bazën më të gjerë.

Përfshirja e përfituesve në përkufizimin e qëllimit të mbledhjes dhe shpërndarjes së fondeve si parim është tejte i rëndësishëm. Ne që nga mbledhja e fondeve punojmë në legjitimitetin e organizatës tonë, respektivisht të aktiviteteve tona. Sado që OSHC-ja jonë njih mirë grupet e veta të përfituesve dhe të synuara, nuk mund të lejojmë të humbim

kontaktin me ata. Rrethanat, nevojat dhe problemet ndërrojnë shpejtë, ndërsa OSHC-ja jonë do të jetë e suksesshme jo vetëm nëse e ndjekë këtë dinamikë, por edhe nëse bashkë me përfituesit e vet tregojnë që është në gjendje të parashikojë rrethanat e rëndësishme, emergjente dhe të pashmangshme që janë para nesh.

Donatorët, para se gjithash, ndajnë fonde për të ndihmuar që njerëzit brenda komuniteteve të tyre të zgjidhin problemin e vet ose të plotësojnë ndonjë nevojë. Të gjithë donatorët i japin fonde organizatës tonë, pasi besojnë qëne me legjitimitet përfaqësojmë interesat dhe nevojat e përfituesve tanë. Nga ana tjetër, përfituesit tonë do të na besojnë vetëm nëse me të vërtetë ndjejnë ndonjë përfitim nga puna jonë. Roli jonë është që të jemi ndërmjetësues të shkëlqyer ndërmjet përfituesve dhe donatorëve, efikas financiarisht dhe në operacione.

Përfituesit mund të përfshihen në procesin e përkufizimit të mbledhjes në shumë mënyra të ndryshme – përmes debateve, intervistave, mbledhjeve të qytetarëve, anketave, hulumtimeve të literaturës dhe publikimeve... Për të gjitha këto aktivitete para se gjithash është karakteristik aspekti hulumtues. Megjithatë, siç është rasti i mbledhjeve të qytetarëve, nganjëherë këto aktivitete mund të marrin edhe formën e planifikimit të veprimeve dhe mbledhjes së ideve të mira të cilat i kanë përfituesit tanë. Kështu ndërtojmë një marrëdhënie me bazën tonë, për çka tashmë është folur në parimet e mëhershme.

Nëse OSHC-ja juaj kryen aktivitete të tilla gjatë përgatitjes së projekteve dhe nismave të reja duhet menduar edhe për mënyrën si të bëhet shpërndarja e fondeve gjithëpërfshirëse. Domethënë, nëse në mbledhjen e qytetarëve propozohet ndonjë aktivitet, nuk pengon që të diskutohet me përfituesit se çfarë resurse dhe

Këshillë shumë e shpeshtë që OSCH-të marrin nga ekspertët e marketingut është se nevojitet që ta “thjeshtësojnë rrëfimin e tyre” kur i drejtohen opinionit. Kjo këshillë jepet shpesh, por vërtetë vështirë aplikohet, sepse pikërisht nuk përfshinë kurrfarë përmbajtje, propozim apo kërkesë konkrete. Në ueb-faqe do të gjeni me mijëra shembuj dhe këshillash konkrete në temën e mbledhjes së fondeve. Një ndër këshillat më të rëndësishme është që numri i fjalëve dhe thjeshtësia në shprehje nuk guxojnë të behën më të rëndësishme se ajo që vërtetë dëshironin të porositni. Njerëzit duan që t’u drejtoheni si qenie inteligjente, që në përditshmërinë e tyre ballafaqohen me probleme të shumta reale – me grindje në familje, me konflikt në mes të gjeneratave, me të ardhura të ulëta... Njerëzit duan ta dëgjojnë të vërtetën, fjalët që do t’ua nxitin emocionet dhe mesazhin i cili do të thotë qartë se çka mund të bëjnë ata për t’i zgjidhur problemet tona.

materiale nevojiten për kryerjen e atij aktiviteti. Nga njëra anë, do të merni shumë informacione të dobishme, ndërsa nga ana tjetër do të informoni përfituesit dhe bazën e juaj se si do të zhvillojë buxhetin e projektit si dhe si do të zhvillohet ndarja e fondeve.


Nëse e përdorni anketën dhe aktivitetet e tjera ku nuk ka shumë mundësi për komunikim të dyanshëm, gjithmonë ekziston mundësia që në ueb-faqen tuaj të shpallni të dhënat për ndarjen e fondeve, duke ndarë në mënyrë të veçantë shpenzimet për paga dhe shpenzimet administrative. Më shumë për këtë, në kapitullin e ardhshëm.

Një situatë veçanërisht e ndjeshme krijohet kur mbledhim më shumë fonde se sa që nevojiten për realizimin e një veprimi të caktuar. Për këtë tashmë kemi folur në përshkrimin e parimit 7. Megjithatë, duhet shtuar edhe një këshillë për këtë parim. Preferohet të përfshihen edhe përfituesit në përkufizimin e ndarjes së kësaj “teprice” të fondeve të mbledhura.

Nëse kemi mbledhur fonde për rregullimin e parkut, shembulli i cili

tashmë u përdor së tepërmi në këtë manual, nuk duhet pyetur vetëm donatorët ku duan që të investohen mjetet e tyre. Ndoshta është edhe më e rëndësishme të pyesni shfrytëzuesit e parkut çka tjetër duan të përfitojnë në park nga “teprica” e fondeve të mbledhura?

Duhet të jemi të kujdesshëm me këtë rekomandim. Nuk janë të gjitha mbledhjet e fondeve të tilla që të mundësojnë përfshirjen legjitime të shfrytëzuesve në vendimin për ndarjen e fondeve. Duhet të jemi të vëmendshëm edhe për konfliktin e interesit. Nëse, për shembull, mbledhim fonde për ndërtimin e shtëpive të sigurta në territorin e Serbisë dhe mbledhim mjaft mjete për të ndërtuar një shtëpi më shumë, krahasuar me planin tonë, përfshirja e shfrytëzuesve nga shtëpitë e planifikuara do të mund të bënte që mjetet të shpenzohen për nevojat e tyre, pasi ata udhëhiqen me interesin e tyre natyral. Nga ana tjetër, ndoshta nevoja më e madhe për një shtëpi të sigurt është në një vend ku nuk kemi kontakt të drejtpërdrejtë me viktimat e dhunës, mu për shkak të arsyes se atje nuk ka shërbime të ngjashme.



Gjashtë OSHC të mëdha ndërkombëtare përmes një hulumtimi janë përgjigjur në pyetjen: cilat janë arsyet që donatorët u mbështesin pikërisht juve, e jo dikënga konkurrentët tuaj? Të gjithë i kanë dhënë përgjigjet e tyre. Pastaj pyetja e ngjashme u është bërë edhe donatorëve të tyre: cilat janë arsyet për shkak të të cilave u jepni para pikërisht këtyre organizatave, e jo të tjerave? Në asnjë rast përgjigjet nuk janë përrupthur. Secila organizatë ka besuar se mbledhja e fondeve për organizatën e tyre është një gjë, ndërsa për donatorët mbështetja e asaj organizate ka qenë krejtësisht diçka tjetër. Mos e humbni kontaktin me bazën dhe përfituesit! Nevojat dhe problemet e tyre reale duhet çdo herë të jenë të qarta për juve dhe donatorët tuaj. Është kjo mënyra e vetme që të siguron qëndrueshmëri për shtigje më të gjata, duke ndërtuar raporte mes jush, donatorëve dhe përfituesve, raporte të mbështetura në besim të ndërsjellë dhe realitet.

PARIMI 11. INFORMIMI I DONATORËVE PËR MËNYRËN SE SI SHFRYTËZOHET DONACIONI

OSHC do të informoj donatorët për mënyrën si është shfrytëzuar donacioni i tyre dhe do të ofroj përgjigje të shpejtë, voluminoze dhe të hapur në çdo pyetje në bazë të kërkesës së donatorit dhe procedurave të raportimit.

Edhe pse në sektorin civil nënkuptohet që në fund të projektit të paraqiten raportet për realizimin dhe shpenzimet, parashtrohen disa pyetje të cilat edhe më tutje mbesin të hapura kur flasim për raportim. Numri më i madh i OSHC-ve fondet i fitojnë nga fondacionet ndërkombëtare dhe vendore, ose nga sektori publik, të cilët kanë format e veta të hollësishme për raportim.

Shumica e organizatave kanë harmonizuar veprimtarinë e vet me këto kërkesa. Në këtë mënyrë, OSHC-të i qasen edhe raportimit në kompani të cilat mbështesin projektet e tyre dhe të cilat jo rrallë herë nuk kanë kërkesa dhe formularë specifik.

Ekziston një tendencë natyrale që në raportet e tilla OSHC-të të paraqesin rezultatet e projekteve të veta në një dritë më të mirë. Nga dëshira për t'i treguar donatorëve që "investimi" i tyre ishte i mirë dhe se ja vlen të vazhdohet me mbështetje të tillë, OSHC-të mundohen të paraqesin që kanë kryer çdo gjë që parashihte projekti. Por, me këtë praktikë bëhemi të pasinqertë edhe ndaj donatorëve edhe ndaj vetes. Nuk ekziston asnjë projekt në të cilin nuk janë paraqitur rrethana të paparashikuara ose në të cilin, gjatë realizimit, ndonjë nga aktivitetet e parapara nuk ishte plotësisht e suksesshme. Gabimi kyç gjatë raportimit të tillë është se jo vetëm që nuk i pranojmë gabimet, por edhe pengojmë vetveten dhe donatorët që të nxjerrim mësimet e rëndësishme që

mësohen nga çdo dështim. Në të vërtetë, me "zbukurimin e realitetit" ne në tërësi pengojmë procesin e mësimin nga gabimet, gjë që është pengesë e madhe në zhvillimin e mëtejshëm të organizatës dhe qasjes në aktivitetet. Mbi të gjitha, në këtë mënyrë nuk jemi mjaft të hapur dhe nuk ndajmë përgjigje të sakta në të gjitha pyetjet ose ndoshta i shmangemi pyetjeve që në të vërtetë janë të rëndësishme për neve ose donatorët. Gabim i shpeshtë që vërehet në praktikën e OSHC-ve është edhe qasja e raportimit vetëm në afatet e dhëna për raportet periodike dhe raportin përfundimtar. OSHC-të në këtë rast i qasen raportimit si një pune burokratike, ndërsa mjetet e monitorimit dhe të vlerësimit bëhen kryesisht mbështetje për këtë burokraci. Në këtë mënyrë mbikëqyrja dhe vlerësimi i dedikohen gati vetëm përcjelljes së indikatorëve të proceseve, respektivisht bëhen vetëm mjet i cili dëshmon që aktivitetet kryeshin në fushëveprimin e duhur. Vlerësimi i suksesit të rezultateve të arritura i lihet konkluzioneve të personit i cili harton raportin. Kjo

Po qe se i mblidhni fondet nga individët dhe kompanitë, është i rëndësishëm administrimi cilësor i listës së donatorëve potencialë dhe i donatorëve që u kanë mbështetur. Është e dëshirueshme të kemi bazë të mirë të dhënave për donatorët potencialë me informacionin për atë se kë dhe kur e keni kontaktuar, çfarë përgjigjeje keni marrë, kush tashmë u ka mbështetur dhe me çfarë shumash, a e keni falënderuar atë donator, etj... Kjo bazë do t'u ndihmojë më vonë edhe me rastin e raportimit sepse do ta keni listën kontaktit të donatorëve, por edhe të atyre që nuk u kanë mbështetur. Është e dëshirueshme t'u dërgoni raportin edhe njëherë, edhe palës tjetër, nevojitet të tregohet suksesi dhe të jeni të hapur sa u përket fondeve dhe rezultateve të aksioneve. Në këtë mënyrë organizata i parandalon thashë e thënat e pavolitshme, tregon profesionalizëm dhe llogaridhënie, i falënderon donatorët dhe fiton donatorë të ri potencialë për aksionet e ardhshme.

praktikë nuk është e mirë pasi asnjë person në organizatë nuk mund ti ketë të gjitha informatat e nevojshme e të rëndësishme për nxjerrjen e konkluzioneve kyçe lidhur me sukseset dhe dështimet. Gjithashtu, në këtë mënyrë mësimet e mësuara nuk ndahen brenda organizatës, gjë që rezultojn me atë që personat në ekip nuk kanë përshtypje të njëjtë se çka ishte e suksesshme e çka jo. Një praktikë më ndryshe paraqitet me organizatat të cilat mbledhin fonde nga individët dhe kompanitë përmes fushatave për mbledhjen e fondeve. Në këto raste nuk ekziston një formë e raportimit, ndërsa donatorët potencial vijnë nga strukturat më të ndryshme të shoqërisë. Si të sigurohemi që informimi dhe raportimi të jenë në pajtim me standardet? Rekomandohet që raporti në këto raste të përshkruajë vetë aktivitetin ose vlerave të aktivitetit, dhe gjithsesi të përmbajë këto grupe të informatave:

PËRSHKRIMIN E SHKURTË TË REZULTATEVE TË FUSHATËS.

Në këtë pjesë duhet paraqitur një përmbledhje të shkurtë për çka shërbente aktiviteti i mbledhjes së fondeve, sa para janë mbledhur dhe çka është bërë ose do të bëhet me ato para.

PËRMBLEDHJE E SHKURTË PARA FILLIMIT TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT.

Këtu duhet paraqitur të dhënat për problemin ose nevojën të cilën mundohemi ta zgjedhim me projektin tonë. Duhet

Pothuajse në të gjitha qytetet e mëdha në rajon hasim shpesh njerëz në rrugë të cilët mbledhin donacione për disa shoqata. Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me aksione të ndihmës ndaj fëmijëve apo grupeve të rrezikuara. Jo rrallë, aksionet këtilla nxitin mosbesim dhe dyshime se paratë e mbledhura, si dhe vullneti i mirë që dikujt t'i ndihmohet keqpërdorën. Vërejtja kryesore ndaj aksioneve të tilla është se nuk ka mënyrë që të informohen lidhur me atë se sa para janë mbledhur, as se çka është bërë me ato para. Veprimi i këtillë nuk guxon të jetë në kundërshtim me standardet e mbledhjes së fondeve, sepse drejt-përsëdrejti i kontribuon mosbesimit ndërmjet qytetarëve dhe tërë sektorit civil, që do të duhej të mbrohej nga praktikat e këtilla.

paraqitur të dhënat për gjendjen në fillim të projektit dhe poashtu çka kemi dashur të arrijmë në kontekst të rezultateve të pritura. A është ky përshkrimi i parkut i cili është në gjendje të keqe, ndërsa pas projektit e fiton një ushtrimore të hapur ose 30 banka? Ose ndoshta është zgjerimi i shtëpisë së sigurt për 50% të kapaciteteve që mungonin?

PËRMBLEDHJA E PLANIT TË BUXHETIT DHE FONDEVE TË MBLEDHURA.

Këtu duhet paraqitur sa para ose materiale kemi dashur të mbledhim dhe sa ia kemi dalë në atë. Do të duhej të përmendeshin donatorët më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm. Listën e kompletuar të donatorëve mund ta shpallim krejt në fund të raportit.

FONDET E MBLEDHURA NGA BURIMET E NDYRSHME.

Nëse kemi bërë fushatën për të mbledhur fonde nga individë dhe kompani, e gjatë aktiviteve fitojmë fonde edhe nga sektori publik ose donator ndërkombëtar, këtë duhet paraqitur qartë në raport. Me këtë i shmangemi akuzave që për “të njëjtën gjë” kemi pranuar fonde edhe nga individët edhe nga kompanitë edhe nga donatorët. Është e rëndësishme të paraqitet që përmbledhja

e përgjithshme e fondeve të pranuar është po ajo shumë të cilën e kemi kërkuar dhe të cilat i kemi shpenzuar në veprimin e premtuar.

PËRSHKRIMI I HOLLËSISHËM I REZULTATEVE.

Këtu duhet përshkruar çka kemi arritur duke iu falënderuar fondeve të mbledhura. Nevojitet të jemi sa më të saktë dhe të qartë.

PLANET PËR TË ARDHMEN.

Shfrytëzojeni raportin dhe informonin fund të tij mbi aktivitetet e juaja në të ardhmen. Ftoni të gjithë ata që veçse ju kanë mbështetur, por edhe ata të cilët nuk e kanë bërë, të marrin pjesë në aktivitetet tuaja në të ardhmen.

FALËNDERIMI PËR TË GJITHË DONATORËT.

Në fund të raportit përmendni të gjithë donatorët që ju kanë mbështetur (përveç atyre që kanë shprehur dëshirën të mbesin anonim) dhe falënderojni të gjithëve.

Pjesën më të madhe të këtyre aktiviteve dhe shpalljeve mund tabëni edhe gjatë aktivitetit të mbledhjes dhe gjatë realizimit të aktiviteve tuaja. Është e rëndësishme të informoni publikun rregullisht, e jo vetëm në fund të projektit.

PARIMI 12. NJOHJA E KONTRIBUTIT TË DONATORIT DHE TRAJTIMI I INFORMATAVE PËR DONATORIN

OSHC do të njoh kontributet e donatorëve dhe do të siguroj që të gjitha informatat për donatorë të trajtohen si konfidenciale dhe të ruhen në mënyrë të duhur, në bazë të kërkesave të donatorëve dhe procedurave të vizibilitetit.

Mënyra më e mirë për të siguruar mbështetje afatgjate dhe të vazhdueshme të donatorëve, është që OSHC t'i falënderohet secilit donator dhe të njoh kontributin e secilit donator. Ne të vërtetë ka shumë mundësi – në manifestimet që organizojmë, në materialet

tona të shtypura, ueb faqe, në muret e zyrës.

Kur e mendoni mënyrën si të njihni kontributin e donatorëve, në fillim mund të niseni nga hartimi i një liste me të gjitha manifestimet dhe materialet e juaja që do t'i përgatisni në periudhën e ardhshme. Pastaj duhet analizuar nëse këto janë raste të duhura për të njohur kontributin e donatorëve dhe se cilat janë mënyrat më të mira për ta bërë këtë.

Por, para se t'i falënderoheni donatorëve dhe të njihni pjesëmarrjen e tyre, duhet të jeni të sigurt që ata e duan këtë. Duhet marrë miratimin e donatorëve, si dhe informatën se si duan ata të jenë të përfaqësuar në materialet e juaja. Këtë mund ta bëni shumë thjeshtë – nëse keni kontrata për donacione, në formular leni vendin e zbrazët ku vetë donatori do të shkruaj si saktësisht dëshiron që emri i tij/saj ose i kompanisë të përmendet në materialet tuaja.

Donatorët ndërkombëtar zakoni-

Me rastin e realizimit të NIF-a08 (Forumi i investimeve Nishi 2008) organizatorët u kanë ofruar tri pako donatorëve. Secila pako ka qenë e shumës së ndryshme (e arta ka qenë 20.000 EUR, e argjendta 10.000 EUR, kurse e bronza 5.000 EUR) dhe donatorët korporativ kanë mundur të zgjedhin cilën do qoftë nga këto pako. Secila pako në start u ka ofruar dukshmëri të ndryshme kompanive si në forum, ashtu edhe në materialet e forumit të cilat janë shpërndarë para, gjatë dhe pas forumit. Në këtë mënyrë NIF 08ke mbledhur fonde të konsiderueshme për manifestimin e vet, kurse raporti me donatorët korporativ ishte rregulluar në detaje me anë të përmbajtjes së pakos së përzgjedhur.

sht kanë kërkesat e tyre lidhur me vizibilitetin, që janë pjesë përbërëse e kontratës. Në rastet kur donatori nuk ka kërkesa të tilla, është e dëshirueshme që OSHC të ketë sistemin e vetë, sipas mundësisë në formë të procedurës së shkruar, që parasheh mënyrat se si bëhet ky vizibilitet. Me këtë mbroni edhe vetë OSHC-në nga situatat kur donatori kërkon vizibilitetin për të cilin ju mendoni se është paarsyeshëm i madh krahasuar me donacionin, por njëkohësisht edhe krijoni kushte të njëjta për vizibilitetin e donatorëve të ndryshëm dhe shumave të donacioneve. Për të gjithë donatorët është e rëndësishme të kenë ndjenjën që vizibiliteti i tyre është adekuat krahasuar me vizibilitetin e donatorëve të tjerë në aktivitetin tuaj. Është e nevojshme që Organizata të ketë procedurë për raste kur donatori dëshiron të mbetet anonim. Procedura duhet të parasheh mënyrën se si donatori shpreh dëshirën e vet për të mbetur anonim, si ruhen të dhënat për

donatorët anonim brenda organizatës dhe në çfarë mënyre i prezantohet publikut çdo donacion anonim. Do të ishte e dëshirueshme të merret informata se në çfarë mënyre donatori anonim dëshiron të marrë raportin për rezultatet e aktivitetit dhe njëkohësisht të sigurohet që do t'i ruhet anonimiteti. Kur mbledhni fonde, zakonisht fondet e pranuar nuk janë në shumën e njëjtë. Do të ishte shumë përgjegjësi të falënderoheni dikujt kush ka dhënë një donacion të vogël dhe dikujt, donacioni i të cilit ndoshta përbën më shumë se gjysmën e fondeve të mbledhura. OSHC-ja, para fillimit të mbledhjes së fondeve ka plan si të falënderohet për donacione të vogla, të mesme dhe të mëdha. Gjithsesi, në fillim është e rëndësishme të përcaktoni se cili donacion është për juve donacion i vogël, cili i mesëm dhe cili i madh. Të dhënat për donator zakonisht nuk përfshijnë vetëm emrin e donatorit (personit fizik ose juridik). OSHC-ja, zakonisht pranon edhe disa të dhëna të tjera – numrin e telefonit, adresën e postës elektronike, adresën fizike, numrin amzë, të dhënat për personat kontaktues, dokumentacionin e donatorëve... Këto të dhëna duhet të trajtohen si konfidenciale në mënyrë

të duhur. Do të ishte mirë që OSHC-ja të mendoj mënyrën si do të trajtohen këto të dhëna, madje edhe të ketë një procedurë me shkrim për këtë çështje. Kjo procedurë i prezantohet edhe donatorëve. Nëse keni një fushatë të madhe publike për mbledhje të fondeve, kjo procedurë mund të vendoset edhe në ueb faqen e juaj që të gjithë donatorët të kenë informata e njëjtë. Procedura do të duhej të mbulonte edhe pyetjen se në çfarë mënyre janë informatat konfidenciale në dispozicion të të punësuarve në organizatë dhe në cilat raste.

Në rastin e OSHC-ve më të mëdha, çështja e konfidencialitetit të këtyre informatave do të duhej të bëhej



Në botë është është vendosur tashmë një praktikë që qytetarët të “ngulfatën” me letra në të cilat OSHC-të kërkojnë donacione.


Marrësit e letrave të tilla rëndom ndjehen sikur u është rrezikuar privatësia e tyre sepse letrat përmbajnë emrat e tyre, adresat e ndonjëherë edhe informacione të tjera. Kjo praktikë negative është shpesh pasojë e marrëveshjes së dy apo më shumë OSHC që mund të kenë në mes veti, që t'i këmbëjnë informacionet për donatorët. Në këtë mënyrë, duke mos pasur kujdes fare për konfidencialitetin e këtyre informacioneve, OSHC-të e sigurojnë regjistrin e njerëzve të cilët që në start tashmë kanë dhënë donacion dhe kanë shfaqur interesim për të mbështetur zgjidhjen e problemeve shoqërore. Duke u mbështetur në vetëdijen e tyre, OSHC-të vlerësojnë se do të fitojnë kështu donatorin edhe nga rrethi i miqëve të organizatës partnere. Kemi të bëjmë me një praktikë e cila është e padëshirueshme. Informacionet për donatorin duhet t'i trajtojmë me shumë kujdes dhe t'i ndajmë vetëm në mënyrën të cilën donatori na e lejon.

pjesë e marrëdhënieve ndërmjet OSHC-së dhe të punësuarve. Është e dëshirueshme që të punësuarit të nënshkruajnë një deklaratë me të cilën konfirmojnë se informatat për donatorin në të cilat kanë qasje ata, do të trajtohen si informata konfidenciale. Në atë moment të punësuarit zakonisht nënshkruajnë edhe që janë të vetëdijshëm për faktin se trajtimi i gabuar në këtë kontekst mund të rezultojë me iniciimin e procedurës disiplinore e madje edhe me largim nga puna.

Duhet kultivuar marrëdhënien me donatorin. Për këtë, OSHC-ja duhet të ndajë kohë, njerëz dhe resurse të tjera. Edhe pse shumica më e madhe e donatorëve nuk kërkon falënderime, njohja e kontributit të tyre i tregon donatorëve ekzistues ashtu edhe donatorëve potencial të aktiviteteve tuaja për kulturën e organizatës tuaj. Nëse kërkon donatorë për një aktivitet tuajin, që nga fillimi keni parashtruar gabimisht synimin e juaj. Ju, te donatorët potencial kërkon partnerë afatgjatë që do të marrin pjesë në ndryshimet që i bëni në jetën e njerëzve. Prandaj, çdo takim me donator shfrytëzohet për të ndërtuar raport me ata, e jo për të kërkuar para.

MATRICA E AKTIVITETEVE

1. Vlerësimi i **kompleksitetit**
2. Vlerësimi i **nevojave financiare**





Në këtë kapitull përmes tabelës janë paraqitur aktivitetet e ndryshme me të cilat mund të siguroni aplikimin e Standardeve në organizatën tuaj. Tabela ua bën të mundur që për secilin aktivitet të keni mbikëqyrje të qartë se cilave parime nga Standardet u kontribuohet.

Duke qenë se këto aktivitete nuk janë njësoj të aplikueshme për të gjitha organizatat, aktivitetet janë shënuar me vlerësime që tregojnë se sa kompleks është miratimi dhe e aplikimi, si dhe sa para nevojitet për t'u ndarë në mënyrë që të zbatohet aktiviteti përkatës.

VLERËSIMI I KOMPLEKSITETIT

Kemi të bëjmë me vlerësimin i cili tregon për shkallën e zhvillimit që do të duhej të arrinte organizata në mënyrë që të mund ta aplikonte me sukses ndonjërin nga aktivitetet. Vlerësimet janë në shkallën prej 1 deri në 5 dhe u përgjigjen përshkrimit narrativ si në vijim:

1. SHUMË THJESHTË

(i mundshëm për organizatat të cilat sapo nisin nga puna),

2. RELATIVISHT THJESHTË

(është e dëshirueshme që organizatat të funksionojnë më së paku një vit, krahas kapaciteteve dhe resurseve që janë në fillim të zhvillimit)

3. MESATARISHT KOMPLEKSE

(organizata do të duhej të ketë pas vetës vite të ekzistimit dhe zhvillim përkatës organizativ i cili siguron punësimin e 3–4 personave),

4. SFIDUES (KËRKUES)

(organizata, përveç viteve të punës, ka 5–10 persona në punë të përhershme, përshkrimin e punëve dhe një kontinuitet në realizimin projekteve dhe mbledhjen e fondeve),

5. JASHTËZAKONISHT KOMPLEKSE

(organizata ka të hyra të rregullta nga burime të ndryshme, më shumë se 10 persona të punësuar me përshkrim të qartë të punëve dhe qëndrueshmëri të siguruar financiare në periudhën afatmesme).

VLERËSIMI NEVOJAVE FINANCIARE

5. NEVOJITEN INVESTIME TË MËDHA FINANCIARE NË SHUMËN MË TË LARTË SE 5.000 EUR.

5.1. NEVOJITEN INVESTIME TË MËDHA FINANCIARE NË SHUMËN MË TË LARTË SE 5.000 EUR.

Disa nga aktivitetet e propozuara kërkojnë edhe investime të parasë. Për këtë arsye në matricë edhe kjo është paraqitur në shkallën prej 1 deri në 5, me ç'rast vlerësimet u përgjigjen përshkrimit si në vijim:

5.1.1. NUK NEVOJITEN KURRFARË MJETESH FINANCIARE PËR REALIZIM, OSE NEVOJITEN INVESTIME TË VOGLA NË LARTËSINË MË SË SHUMTI DERI NË 50 EUR,

Disa nga aktivitetet e propozuara kërkojnë edhe investime të parasë. Për këtë arsye në matricë edhe kjo është paraqitur në shkallën prej 1 deri në 5, me ç'rast vlerësimet u përgjigjen përshkrimit si në vijim:

1. NUK NEVOJITEN KURRFARË MJETESH FINANCIARE PËR REALIZIM, OSE NEVOJITEN INVESTIME TË VOGLA NË LARTËSINË MË SË SHUMTI DERI NË 50 EUR,

2. NEVOJITEN INVESTIME TË VOGLA FINANCIARE NË LARTËSINË 50-300 EUR,

3. NEVOJITEN INVESTIME FINANCIARE NË SHUMËN 300-1.000 EUR,

4. NEVOJITEN INVESTIME TË KONSIDERUESHME FINANCIARE NË SHUMËN PREJ 1.000-5.000 EUR,

5. NEVOJITEN INVESTIME TË MËDHA FINANCIARE NË SHUMËN MË TË LARTË SE 5.000 EUR.

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)											
	P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Të përcaktohet deklarata e misionit, vizionit dhe vlerës së organizatës	1	1	x									
Organizata me rastin e marrjes së vendimeve udhëhiqet nga misioni dhe vizioni i përcaktuar	1	1	x									
Organizata i njeh dispozitat ligjore dhe i respekton në punën e saj	1	1	x	x		x						
Organizata e realizon numrin më të madh të aktivitetëve në mënyrë që të jenë në pajtim me misionin dhe vizionin	1	1	x									
Organizata ua paraqet rregullisht raportet vjetore financiare institucioneve përkatëse shtetërore	1	1	x	x		x						
Organizata i planifikon aktivitetet e saj në pajtim me vlerësimin real të kapaciteteve të veta	1	1	x		x	x						

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)													
			P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Organizata e ka kuvendin dhe këshillin drejtues, anëtarët e të cilit nuk paguhen	1	1	x	x		x								
Kuvendi dhe këshilli drejtues i organizatës mbledhen rregullisht, e menaxhojnë organizatën dhe e mbikëqyrin udhëheqjen e organizatës	1	2	x	x		x								
Organizata ka në ueb-faqen e saj dhe/ose në materialet e tjera informacione të qasshme për fondet e mbledhura, projektet dhe donatorët	1	1		x	x	x	x				x		x	x
Organizata i ka të publikuara në ueb-faqen e saj informacionet për anëtarët e organizatës, për të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit Drejtues	1	1		x	x	x								
Organizata në ueb-faqen e saj i publikon rregullisht informacionet për aktivitetet dhe rezultatet e punës	1	1		x	x		x							

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)													
			P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Organizata krijon planin e shpenzimeve para se të fillojë mbledhjen e fondeve	1	1			x	x		x	x					
Organizata e ka dhe e përdor llogarinë rrjedhëse; Për çdo projekt të saj organizata ka llogari të posaçme rrjedhëse	1	1			x	x		x						
Organizata e organizon veprimtarinë e saj financiare ashtu që të jetë në gjendje që mbi baza mujore t'i përcjellë të hyrat dhe të dalat e saj	1	1				x		x			x			
Organizata në mënyrë të qartë dhe të saktë ua prezanton donatorëve dhe opinionit aktivitetet e saj, qëllimin dhe nevojat për të cilat i mbledh fondet, duke mos i fshehur informacionet e rëndësishme për procesin e mbledhjes	1	1		x			x							
Organizata i mbledh informacionet lidhur me atë se çka punojnë organizatat e tjera në fushën e njëjtë dhe i shmanget dyfishimit të aktiviteteve	1	1						x						

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit		Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)											
			P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Me rastin e hartimit të buxhetit, organizata mbledh të dhëna për çmimet reale në treg dhe i përfshinë në buxhet	1	1						x	x					
Organizata kujdeset që shpenzimet materiale të vetë mbledhjes së fondeve mos të jenë dis-proporcionalisht të mëdha në raport me shumën e mbledhur	1	1						x						
Organizata, para se të fillojë me mbledhjen e fondeve, merr vendim lidhur me atë se çka do të bëjë me paratë e mbledhura po qe se shumën e mbledhur nuk është e mjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve	1	1				x	x	x	x				x	x
Organizata, para se të fillojë me mbledhjen e fondeve, merr vendim lidhur me atë se çka do të bëjë me paratë e mbledhura po qe se shumën e mbledhur është më e madhe se shumën e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve	1	1				x	x	x	x				x	x

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit		Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)											
			P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Po qe se organizata nuk ka marrë paraprakisht vendim për këtë, ndërsa mbledh shumë më të madhe apo më të vogël se ajo që nevojitet, është e domosdoshme t'i konsultojë donatorët se çka të bëjë me ato para fillimit të shpenzimit	1	1				x		x	x				x	x
Në qoftë se mbledh shumë më të lartë se ajo që është e nevojshme, organizata nuk do të vendos në mënyrë të pavarur për shpenzimin e këtyre parave	1	1							x				x	
Para fillimit të mbledhjes së fondeve, organizata duhet të përcaktojë dhe informojë donatorët për atë se cilat grupe të përfutuesve dhe grupe të synuara do të kenë përfitim të drejtpërdrejtë nga projekti, në cilin territor dhe si janë përzgjedhur ata	1	1	x							x			x	

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)													
			P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Organizata nuk i përdor të dhënat mbi personalitetin (përfshirë edhe foto-/video-/ audio-materialet) për përfituesit e saj pa marrjen e pëlqimit me shkrim; informacionet shfrytëzohen në vëllimin me të cilin janë pajtuar përfituesit	1	1								x				
Organizata nuk e nis aksionin e mbledhjes së fondeve për ndihmë individit apo grupit paraprakisht të caktuar të individëve pa pëlqimin e tyre paraprak	1	1					x		x	x	x			
Organizata u raporton rregullisht individëve apo grupit paraprakisht të caktuar të individëve për të cilët i mbledh fondet për rrjedhën e mbledhjes së fondeve (mjeteve)	1	1			x	x	x			x	x			
Organizata përpilon raporte të sakta, përmbajtësore dhe precize për donatorë lidhur me atë se si është shfrytëzuar donacioni	1	2	x		x		x						x	

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)													
			P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Organizata e ka të zhvilluar sistemin e monitorimit dhe evaluimit që shërben për atë që të përcillet implementimi i aktiviteteve të projektit	1	2		x		x		x					x	
Organizata thekson emrin dhe të dhënat e tjera për donatorin me rastin e realizimit të aktiviteteve në pajtim me kontratën apo ujdinë me donatorin	1	1		x	x		x							x
Organizata ka mënyra për t'iu falënderuar të gjithë donatorëve të saj, duke pasur konsideratë edhe për ata që kanë dhënë donacione të mëdha, por edhe për ata që kanë dhënë donacione të vogla	1	1					x							x
Organizata bën në mënyrë të rregullt planifikimin strategjik	2	2	x											
Organizata zbaton në mënyrë të rregullt hulumtimin e nevojave në lidhje me përfituesit e saj apo me temën me të cilën merret	2	2		x						x		x		

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)		P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Po qe se mbledhja e fondeve zgjatë për një periudhë më të gjatë kohore, organizata publikon rregullisht sa para i ka mbledhur gjatë tërë asaj periudhe	2	2			x	x	x							
Organizata mban në mënyrë të rregullt listat e inventarit të pasurisë së saj, i shfrytëzon reversët me rastin e huamarrjeve dhe e mirëmban pasurinë e saj	2	1				x								
Organizata ka sistemin sipas të cilit e cakton përqindjen e buxhetit të projektit e cila do të ndahet për shpenzime administrative dhe paga, dhe këtë ua prezanton në mënyrë të qartë donatorëve potencialë	2	1					x	x						
Organizata bën publikimin e rregullt të raporteve vjetore narrative për punën e saj	2	1		x	x		x			x		x	x	


Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)		P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Organizata i ka në ueb-faqen e saj dhe/ose në materialet e tjera informacionet e qarta për përqindjen e parave të cilat ndahen për paga, shpenzime administrative dhe shpenzime programore në nivel vjetor	3	2		x	x	x	x	x			x		x	
Organizata ka procedurë sipas së cilës vepron kur donatori dëshiron të mbetet anonim dhe e respekton këtë procedurë	3	1			x									x
Organizata ka dhe aplikon politikën lidhur konfliktin e interesit, e cila mbulon edhe temat me rëndësi për raport me donatorë	3	1			x	x			x					
Organizata ka dhe i respekton procedurat që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe udhëheqjen e financave	3	1		x		x		x						
Organizata ka sistem dhe procedura sipas të cilave i realizon të gjitha furnizimet e saj, duke siguruar që më shumë se një person t'i nënshkruaj urdhëresat	3	1				x		x						

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)		P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Organizata ka procedura për rastin kur konstatohet se ka pasur keqpërdorim të fondeve dhe të pasurisë nga persona fizikë në organizatë dhe jashtë saj	3	1				x								
Organizata ka planin e komunikimit me publikun i cili ndihmon që grupet e përfituesve të mos stigmatizohen në opinion përmes procesit të mbledhjes së fondeve	3	1								x				
Organizata e ka të zhvilluar sistemin e vlerësimit të efektit të aktivitetit në ndryshimet dhe zhvillimin që dëshirojnë të arrijnë në shoqëri	3	3		x				x					x	
Organizata angazhon shtëpinë e pavarur e cila vlerëson suksesin e aktivitetit të projektit dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve të mbledhura	3	4		x		x		x					x	
Organizata ua dërgon raportet për fondet e mbledhura, shpenzimet, aktivitetet dhe rezultatet e projektit të gjithë donatorëve të saj, madje edhe po qe se nuk ekziston një kërkesë e tillë nga donatorët	3	2		x	x	x	x						x	

Aktiviteti	Kompleksiteti i aplikimit Mjetet e nevojshme (në shumën minimale)		P 1	P 2	P 3	P 4	P 5	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12
Organizata e ka të përcaktuar listën/ofertën se si dhe ku mund t'ia ofrojë donatorit pamjen	3	4												x
Të punësuarit në organizatë i kanë përshkrimet e punëve të tyre, kurse udhëheqja mirret me përshkrimin e punëve me rastin e delegimit të detyrave	4	1		x										
Të punësuarit në organizatë i kanë kontratat e punës në bazë të të cilave punojnë dhe respektohen plotësisht detyrimet në bazë të legjislacionit të punës	4	4		x	x									
Organizata bën rregullisht vlerësimin e efektit të punës së të punësuarve të saj	4	1												
Organizata ka auditimin e rregullt vjetor të pavarur financiar rreth afarizmit të saj	4	4		x	x	x	x				x		x	
Po qe se donatori dëshiron të jetë anonim, organizata ia prezanton planin sipas të cilit veprohet dhe me të cilin mbrohet privatësia si brenda organizatës, ashtu edhe në opinion	4	1												x

MIRATIMI DHE APLIKIMI

1. Zhvillimi organizativ - *Segmenti programor*
2. Puna me shfrytëzues
3. Puna me donatorë
4. Informimi i palëve të interesuara dhe i opinionit
5. Zhvillimi organizativ– *Burimet dhe kapacitete njerëzore dhe materiale*
6. Zhvillimi organizativ–*Menaxhimi dhe administrimi i financave dhe administratës*
7. Monitorimi dhe vlerësimi



MIRATIMI DHE APLIKIMI

Në këtë kapitull janë paraqitur aktivitetet e mundshme të organizatës në fushën e aplikimit të standardeve dhe parimeve për mbledhjen e fondeve. Të gjitha aktivitetet e mundshme janë paraqitur përmes kategorive vijuese:

ZHVILLIMI ORGANIZATIV

segmenti programor, resurset njerëzore dhe afarizmi financiar

PUNA ME PËRFITUES

PUNA ME DONATORË

INFORMIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE I OPINIONIT

(hulumtimi në kuptim të gjerë)

MONITORIMI DHE EVALUIMI.

Siç u theksua tashmë në kapitullin paraprak, nuk janë të gjitha aktivitetet e propozuara lehtë të aplikueshme në të gjitha organizatat. Organizatat më të vogla duhet të ndërmarrin aktivitete të cilat janë më pak komplekse, që u përgjigjen ndarjes së tyre të brendshme të punëve dhe përgjegjësisë, si dhe buxhetit të cilin e disponojnë. Nga organizata e mëdha duhet pritur që t'i miratojnë dhe aplikojnë sh micën e aktiviteteve të propozuara. Në matricën në kapitullin paraprak për secilin nga këto aktivitete mund të gjeni vlerësimin e kompleksitetit dhe të buxhetit të nevojshëm.



ZHVILLIMI ORGANIZATIV-SEGMENTI PROGRAMOR

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Të përcaktohet deklarata e misionit, vizionit dhe e vlerave të organizatës	Vizioni është përshkrim i shoqërisë përkatësisht i komunitetit që dëshironi të ndërtoni. Kjo është e pamundur të realizohet përmes punës së vet organizatës, por ai jep edhe udhëzimin e rëndësishëm për aktivitetin e organizatës. Misioni jep përgjigje në pyetjen se çka bën organizata për ta realizuar vizionin. Një qasje pak më bashkëkohëse thotë se misioni është përgjigje në pyetjen “Çfarë ndryshimi fut organizata juaj në jetët e njerëzve?”. Udhëzimi se si të bëhet misioni do ta gjeni në bazën “on-line” të të dhënave.	Dokument: <i>Si të hartohet deklarata për misionin</i>
Organizata me rastin e marrjes së vendimeve udhëhiqet me misionin dhe vizionin e përcaktuar	Në mbledhjet në të cilat merren vendimet kolektive mund t’u kujtohet deklarata e misionit dhe e vizionit në dy raste: • Keni dilemë në mes të dy apo më shumë vendimeve të cilat ka mundësi të merren – përcaktohuni për atë e cila i kontribuon më së shumti misionit dhe vizionit tuaj. Po qe se asnjëri nga vendimet nuk e bën këtë, ndoshta ato mund të mos jenë vendime të mira për organizatën tonë. • Dëshironi të vlerësoni nëse vendimi i marrë më herët dhe i zbatuar ka qenë i mirë. Hulumtoni se sa ka kontribuar realisht ky vendim në përmbushjen e misionit.	

ZHVILLIMI ORGANIZATIV-SEGMENTI PROGRAMOR

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata realizon numrin më të madh të aktiviteve në pajtim me misionin dhe vizionin	Me rastin e planifikimit të aktiviteve të ardhshme, organizata para së gjithash udhëhiqet nga misioni dhe vizioni. Nga ana tjetër, është e rekomandueshme që së paku një herë në vit të bëhet evaluimi i asaj se në ç’masë aktivitetet e vitit të kaluar kanë qenë në përputhje me misionin dhe çka është realizuar në fushën e vizionit.	Dokument: <i>Si Këshilli Drejtues mund ta vlerësojë punën e OJQ-së</i>
Organizata i mbledh informacionet lidhur me atë se çka punojnë organizatat e tjera në fushën e njëjtë dhe e shmangë dyfishimin e aktiviteve	Kur keni ndonjë ide, ndonjë projekt të ri apo iniciativë të re, verifikoni fillimisht se çka kanë bërë të tjerët në atë fushë. A ka pasur aktivitete të ngjashme? Nëse po, çfarë aktivitetesh kanë qenë ato dhe çka është arritur? Vetëm pasi t’i keni mbledhë të gjitha informacionet, qasuni përpunimit të idesë suaj.	
Organizata bën aplikimin e rezultit të planifikimit strategjik	Planifikimi strategjik është proces të cilin në shumicën e rasteve e udhëheq facilitatori i pavarur, person me mjaft përvojë që ndihmon në qëndrimet dhe interesat e ndryshme brenda organizatës të harmonizohen në një plan unik, me objektiva trevjeçare apo pesëvjeçare të organizatës, me vlera dhe parime të përcaktuara, si dhe me plan të përcaktuar të veprimit.	Dokument: <i>Hyrje në planifikimin strategjik</i>

PUNA ME PËRFITUESIT

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata bën hulumtimin e rregullit të nevojave në lidhje me përfituesit e saj apo me temën me të cilën merret	Organizatat mund t'i zbatojnë hulumtimet e tyre edhe përmes një forme më të thjeshtë të hulumtimit – bisedimeve me përfituesit dhe anketës. Megjithatë, është e rekomandueshme që organizata t'i zhvillojë disa nga kompetencat hulumtuese në radhët e saj ose që kohë pas kohe të angazhojë hulumtues profesionit, po që se ka mundësi të tilla.	Shtojcë: http://wikiciv.org/rs/index.php/Istraživanje_i_Razvoj

Para fillimit të mbledhjes së fondeve, organizata duhet të përcaktojë dhe t'i njoftojë donatorët lidhur me atë se cilat grupe të përfituesve dhe grupe të synuara do të kenë përfitim të drejtpërdrejtë nga projekti, në cilin territor dhe si janë përzgjedhur ata

Donatorët ndërkombëtarë këtë të dhënë e kërkojnë në format e tyre të aplikacionit. Forma e projektit të BE-së është ndoshta më konkreteja, sepse kërkon që t'i përcaktoni edhe grupet e përfituesve dhe ato të synuara, t'i paraqitni nevojat e tyre, numrin e njerëzve që do të përfshini dhe si do të përqipeni në nevojat e tyre. Kjo megjithatë nuk duhet të shikohet si kërkesë e BE-së, por si nevojë të çdo veprimi projektues. Njëlloj përgatitim planet edhe për donatorët tjerë, përfshirë edhe individët. Po qe se mblidhni fonde për një iniciativë që nuk ka grup të drejtpërdrejt përfitues (bie fjala, për hulumtime mjekësore), është e nevojshme të prezantohet se në ç'mënyrë do të ndikojnë këto aktivitete në mjedisin e vet.

PUNA ME PËRFITUESIT

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata nuk i përdor të dhënat mbi personalitetin (përfshirë edhe foto-video-/audio-materialet) për përfituesit e saj pa marrjen e pëlqimit me shkrim; informacionet shfrytëzohen në vëllimin me të cilin janë pajtuar përfituesit	Me rastin e mbledhjes së fondeve mund të shfrytëzohimë rrëfimet për njerëzit, për përfituesit tanë. Mirëpo, keni kujdes! Para çfarëdo mbledhjeje të të dhënave për personin, fillimisht informohuni për regulativën ligjore në këtë fushë. Në disa shtete ekzistojnë organet e pavarura shtetërore të cilat merren me këtë çështje. Janë këta rëndom komisioneritë dhe komisionerët për mbrojtjen e të dhënave të personit, kurse në ueb-faqet e tyre mund ti shihni të gjitha kërkesat që duhet të plotësohen.	Dokument: <i>Statement of Ethical Principles in Fundraising</i>
Organizata kujdeset për atë që mos t'i stigmatizojë grupet e përfituesve.	Është shumë me rëndësi të kuptohet se shfrytëzimi i të dhënave për personin, fotografive dhe sidomos i video-materialet është çështje jashtëzakonisht e ndjeshme për përfituesit. Kini kujdes që ndaj përfituesve të silleni me empati, e jo me keqardhje. Ju dëshironi që t'i përforconi përfituesit tuaj, që të siguroni që vetëbesimi i tyre si dhe konsiderata e komunitetit ndaj tyre të rritet. Parimet ndërkombëtare që janë paraqitur në bazën tonë “on-line” u japin sugjerime shtesë për zgjidhjen e kësaj çështjeje.	

PUNA ME PËRFITUESIT

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata nuk e nis aksionin e mbledhjes së fondeve për ndihmë individit apo grupit paraprakisht të caktuar të individëve pa pëlqimin e tyre paraprak	Po qe se mbledhni fonde për një grup të caktuar, kërkonti paraprakisht pëlqimin e këtyre njerëzve. Kjo është posaçërisht me rëndësi për organizatat të cilat financohen nga anëtarësia (bie fjala, shoqatat e personave me invaliditet). Është e dëshirueshme që të siguronit pëlqimin në formë të shkruar.	Dokument: <i>Statement of Ethical Principles in Fundraising</i>

Organizata u raporton rregullisht individëve apo grupit paraprakisht të caktuar të individëve për të cilët i mbledh fondet për rrjedhën e mbledhjes së fondeve (mjeteve)	Raportimi mund të realizohet duke iu drejtuar drejtpërdrejt grupëve të përfituesve (bie fjala, dhënia e raportit në letër të gjithë përfituesve apo duke i udhëzuar tek të dhëna publikisht të shpallura në ueb-faqe. Është një propozim që raportimi drejt përfituesve dhe drejt opinionit të barazohet sa më shumë, ashtu që ta shfrytëzojmë në mënyrë sa më efektive kohën dhe resurset tona, si dhe të rrisim shkallën e transparencës së punës tonë. Prandaj është më se e rekomandueshme që në ueb-faqen tuaj t'i publikoni rregullisht informacionet për shumate mbledhura.	
--	--	--

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata në mënyrë të qartë dhe të saktë ua prezanton donatorëve dhe opinionit aktivitetet e saj, qëllimin dhe nevojat për të cilat i mbledh fondet, duke mos i fshehur informacionet e rëndësishme për procesin e mbledhjes	Secila organizatë e përzgjedhë mënyrën e vet në të cilën komunikon me donatorë. Mënyra e komunikimit i është përshtatur tipit të organizatës dhe aktivitetit për të cilin mbledhen fondet, si dhe vetë donatorit. Me rastin e komunikimit me donatorë ndërkombëtarë dhe me sektorin publik, komunikimi shkon përmes shkrimit të projekt-propozimit dhe të raportit, ku do të duhej të fusnim informacione të sakta dhe precize, si dhe burimet e informacioneve që sigurojnë besueshmërinë e asaj për çka raportojmë. Sa u përket individëve dhe kompanive, është e nevojshme që të kujdesemi që paraprakisht t'i prezantojmë të gjitha informacionet që u interesojnë këtyre donatorëve, duke mos i fshehur edhe dobësitë dhe rreziqet e idesë sonë.	Shtojcë: http://wikiciv.org.rs/index.php/Prikupljanje_i_raspolaganje_resursima

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata përpilon raporte të sakta, përmbajtësore dhe precize për donatorë lidhur me atë se si është shfrytëzuar donacioni	Në këto raporte jepni pasqyrën edhe të indikatorëve zhvillimor të procesit. Me fjalë të tjera, paraqitni edhe atë se çka keni bërë (bie fjala, numrin e punëtorëve, numrin e analizave ...), por edhe atë që keni arritur (bie fjala, numrin e refugjatëve dhe numrin e bujtjeve në hapësirën që e keni ndërtuar, rezultatet më të mira të nxënësve në shkollë pas programit tuaj, rrëfimet për suksesin...). Në bazën “on-line” do të gjeni tekstin e Dragan Srećkovićit për atë se si t'i zhvillonin dhe përcillnin këta indikatorë.	Shtojcë: http://wikiciv.org.rs/index.php/Monitoring_i_evaluacija

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata ka sistemin sipas të cilit e cakton përqindjen e buxhetit të projektit e cila do të ndahet për shpenzime administrative dhe paga, dhe këtë ua prezanton në mënyrë të qartë donatorëve potencialë	Rekomandohet që shpenzimet tuaja administrative dhe pagat e njerëzve nga organizata mos të kalojnë 30% të buxhetit të gjithëmbarshtëm. Honorarët e bashkëpunëtorëve profesionalë që janë të kyçur drejtpërdrejt në realizimin e iniciativës (bie fjala, të psikologut që ofron këshillime për ata që i mbledhim fondet apo të arkitektit, i cili do të duhej të projektonte ndërtesën për shtëpi të sigurt) nuk hyjnë tek ky segment, por janë shpenzime programore. Është me rëndësi që këto informacione të jenë lehtë të qasshme për donatorët, në mënyrë që mos të gjendemi më vonë në një pozicion që donatorët të shprehin keqardhje për shkak të donacionit të tyre, sepse nuk kanë qenë të vetëdijshëm se i financojnë edhe këto shpenzime. Kjo është një situatë e shpeshtë kur punohet me individë dhe kompani në cilësinë e donatorëve.	Shembull: <i>Ekstrakt nga raporti i CDT</i>

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata, para se të fillojë me mbledhjen e fondeve, merr vendim lidhur me atë se çka do të bëjë me paratë e mbledhura po qe se shumta e mbledhur nuk është e mjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve, apo është më e lartë nga ajo që është planifikuar; ky vendim u komunikohet paraprakisht donatorëve potencialë	Merreni këtë vendim para fillimit të mbledhjes së fondeve. Është e dëshirueshme që destinimi i mjeteve të jetë sa më i ngjashëm me destinimin original. Komunikimi rreth kësaj teme do të duhej të ishte i qartë, por i bërë me kujdes në mënyrë që donatorët potencialë të mos nxjerrin përfundime të gabueshme për atë se parashikoni se aksioni nuk do të jetë i suksesshëm. Me marrjen e këtij vendimi ju u shmangeni situatave në të cilat më vonë do të kërkonti nga donatorët leje shtesë për shpenzimin e parave. Natyrisht, kjo para së gjithash ka të bëjë me mbledhjen e fondeve nga individët, sepse kompanitë donatore dhe sektori publik i kanë tashmë të vendosura rregullat në këtë aspekt.	

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Po qe se organizata nuk ka marrë paraprakisht vendim për këtë, ndërsa mbledhë shumë më të madhe apo më të vogël se ajo që nevojitet, është e domosdoshme t'i konsultojë donatorët se çka të bëjë me ato para fillimit të shpenzimit	Po qe se nuk keni marrë paraprakisht vendime çka do të bëni po qe se mbledhni më shumë apo më pak fonde nga planifikimi, është e domosdoshme që t'u drejtoheni donatorëve me propozim që njetet të përdorën ndryshe nga destinimi sipas marrëveshjes. Megjithatë, po qe se keni mundësi, organizoni takim me donatorë dhe këmbeni idetë rreth asaj se si të veprohet, e pastaj vetëm kërkonti konfirmimin e konsensusit që e keni arritur në mbledhje. Është me rëndësi që paratë mos t'i përcaktoni në mënyrë të pavarur për një destinim të caktuar. Po qe se është e pamundur që të arrihet marrëveshje me donatorët, ndërsa keni mbledhur më pak para se që nevojiten, do të ishte mirë që të keni mënyra që thjeshtë paratë t'ua ktheni donatorëve. Në bazën “on-line” të të dhënave mund të gjeni manualin <i>Charity Commission</i> , trupi valid që merret me këto çështje në Mbretërinë e Bashkuar. Ndonëse asnjë shtet i Ballkanit nuk ka situata të ngjashme, shembulli është dhënë me qëllim që të mësohet nga praktika e shteteve të zhvilluara.	Dokument: <i>Charities and Fundraising</i>

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata thekson emrin dhe të dhënat e tjera për donatorin me rastin e realizimit të aktiviteve në pajtim me kontratën apo ujdinë me donatorin	Donatorët ndërkombëtarë dhe fondacionet vendore i kanë rregullat e veta të qarta për nevojën e theksimit të shenjave, emrave të tyre dhe për nevojat e tjera lidhur me dukshmërinë e tyre. Poqe se nuk është rasti i tillë është mirë që organizata ta ketë planin e saj. Për këtë më gjerësisht në pasusin në vijim. Detyrimi sipas kontratës duhet të përmbushet me përpikëri.	

Organizata e ka të përcaktuar listën/ofertën se si dhe ku mund t'ia ofrojë donatorit pamjen	Disa donatorë nuk i kanë rregullat e veta për dukshmërinë. Kompanitë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, individët, e madje edhe sektori publik, nuk i kanë rregulla të përcaktuara në mënyrë rigoroze se ku dhe si t'i theksoni informacionet për mbështetjen e tyre. Organizata më të pjekura janë paraprakisht të përgatitura për situata të tilla. Po qe se tashmë nuk e keni bërë një gjë të tillë, kjo kështillë do të mund të ishte e dobishme: mbledhni tërë ekipin dhe regjistroni të gjitha materialet tuaja që planifikoni t'i përdorni në të ardhmen (fletëpalosje, bina në koncerte që i organizojmë, katalogët nga ekspozitat tona, reklama në stacionin lokal TV...); mendoni se cili nga këto materiale është rast i mirë për promovimin e donatorëve dhe caktoni çmimin për paraqitjen e kompanisë në secilin prej tyre. Shembulli nga baza tregon se nuk është e thënë të keni një ofertë tepër ambicioze për një hap të tillë.	Shtojcë: <i>Gift Acknowledgement Procedure</i>
---	--	---

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata ka procedurë sipas së cilës vepron kur donatori dëshiron të mbetet anonim dhe e respekton këtë procedurë	Nevojitet që organizata ta zhvillojë paraprakisht planin se si vepron po qe se donatori dëshiron të mbetet anonim. Donatorit në atë rast, para se t'i jap njetet si donacion, i bëhet e qartë se si vepron organizata në raste të tilla. Si të zhvillohet një sistem i tillë? Në bazën “on-line” do të gjeni Udhërrëfyesin për këtë temë. Kemi të bëjmë me një manual mbi procedurat dhe politikat e OSHC-së lidhur me zhvillimin e mbledhjes sëfondeve, në botim të AFP-a (<i>Association of Fundraising Professionals</i>).	Dokument: <i>Donor policies and procedures</i>

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Po qe se donatori dëshiron të jetë anonim, organizata ia prezanton planin sipas të cilit veprohet dhe me të cilin mbrohet privatësia si brenda organizatës, ashtu edhe në opinion	Po qe se donatori dëshiron organizata absolutisht duhet ta sigurojë këtë. Shirohet pyetja se në ç’mënyrë brenda organizatës siguron që të dhënat të jenë anonime. Informacionet për donatorët anonimë a janë të qasshme për të punësuarit në organizatë? Nëse po, cilët janë ata të punësuar dhe në ç’mënyrë i shfrytëzojnë ata këto informacione? Janë këto vetëm disa nga përgjigjet në pyetjet që do t’i kenë vetë donatorët. Nëbazën “on-line” do të gjeni listën e plotë të pyetjeve si dhe rekomandimet se nëç’mënyrë të bëni një sistem të mirë në organizatën tuaj.	Dokument: <i>Donor policies and procedures</i>

PUNA ME DONATORË

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata ua dërgon raportet për fondet e mbledhura, shpenzimet, aktivitetet dhe rezultatet e projektit të gjithë donatorëve të saj, madje edhe po qe se nuk ekziston një kërkesë e tillë nga donatorët	Në rajonin tonë është ky rast i shpeshtë, veçmas me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kurse ndonjëherë edhe me kompanitë e mëdha. Ndonëse shpesh nuk kërkojnë kurrfarë raporti, rekomandohet që megjithatë t’u përgatitet raporti në një formë sa më të thjeshtë. Raporti i tillë nuk është e thënë të përmbajë kopjen e faturës, por gjithsesi se do të ishte mirë të japë një pasqyrë të qartë të fondeve të mbledhura, të shpenzimit të tyre, informacione rreth aktiviteteve dhe rezultateve. Në këtë mënyrë ndërtoni raporte me donatorë dhe i rrisni gjasat që t’u mbështesin përsëri. Nga ana tjetër, vendosni standardin e bashkëpunimit që është shembull edhe për të tjerët.	Dokument: <i>Donor policies and procedures</i>
Organizata ka mënyra për t’iu falënderuar të gjithë donatorëve të saj, duke pasur konsideratë edhe për ata që kanë dhënë donacione të mëdha, por edhe për ata që kanë dhënë donacione të vogla	Zgjidhni mënyrat me të cilat falënderoheni. Mënyrat varen nga ajo se kush jeni ju, me çka merreni dhe çfarë është kultura juaj organizative. Teatri jo fitimprurës gjithsesi se do t’u falënderohet ndryshe donatorëve të vet në raport me laboratorin shkencor, apo jo? Po ashtu, mendoni rreth asaj se kush janë donatorët tuaj. Duhet që të përzgjidhet mënyra e cila për donatorët do të jetë domethënëse.	Dokument: <i>Donor policies and procedures</i>

INFORMIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE I OPINIONIT

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata bën publikimin e rregullit të raporteve vjetore narrative për punën e saj	Raportet vjetore për të cilët bëhet fjalë këtu janë dokumente të cilat me një fjalor të thjeshtë paraqesin e gjithë atë që ka bërë organizata gjatë një viti paraparak. Shembuj të raporteve të shkëlqyeshme ka në tërë rajonin.	Dokumentet: <i>Raportet vjetore të anëtarëve të rrjetit SIGN</i>
Organizata i ka të publikuara në ueb-faqen e saj informacionet për anëtarët e organizatës, për të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit Drejtues	Mblidhni të dhënat, fotografitë dhe biografitë e shkurta të anëtarëve të Këshillit Drejtues, të të punësuarve dhe anëtarëve kyç të organizatës që eventualisht nuk janë anëtarë të KD apo të punësuar. Paraqiteni këtë në ueb-faqen tuaj. Tregoni për ç’arsye jeni pikërisht ju organizata e cila merret me këtë çështje – tregoni se keni njerëzit, dijen dhe shkathtësitë që të merreni me çështjet të cilat i mbulon. Ndërtoni kredibilitetin me dije dhe shkathësi të cilat ua prezantoni në mënyrë të qartë edhe donatorëve, edhe të gjitha palëve të interesuara. Shembulli i ueb-faqes që është dhënë në bazën tonë “on-line” është faqja e Forumit për Iniciativa Qytetare nga Prishtina.	Shembulli: <i>http://www.fiq-fci.org/en/Staff</i>

INFORMIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE I OPINIONIT

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata në ueb-faqen e saj i publikon rregullisht informacionet për aktivitetet dhe rezultatet e punës	Bëhet fjalë për publikimin e të dhënave për aktivitetet e organizatës që nuk është pjesë e raportimit ndaj donatorëve apo e raportit vjetor. Këtu kemi të bëjmë me raportimin për aktivitetet ditore të organizatës. Një propozim për trajtim për organizatat më të pjekura: kur keni mbledhjen e rregullt javore të të punësuarve, me rastin e paraqitjes së aktiviteteve të javës paraprake dhe të planit për javën e ardhshme, për secilin prej këtyre aktiviteteve merrni vesh nëse do të publikohet në ueb-faqe. Në këtë mënyrë do të jeni të sigurt se asgjë nuk keni lëshuar.	Shembulli: <i>www.mozalk.ba</i>
Organizata ka në ueb-faqen e saj dhe/ose në materialet e tjera informacione të qasshme për fondet e mbledhura, projektet dhe donatorët	Është e dëshirueshme që në ueb-faqe dhe në raporte, eventualisht edhe në materialet e tjera, të ketë një pasqyrim të plotë lidhur me këtë temë. Pasqyrimi i plotë, para së gjithash, përfshinë: listën e projekteve, listën e donatorëve sipas projektit dhe shumën që e ka lejuar donatori për secilin projekt. Këto lista mund të rregullohen në mënyra të ndryshme, mirëpo do të ishte e domosdoshme të kishet pasqyra e këtyre të dhënave. Shembullin në bazën tonë “on-line” është ekstrakt nga raporti vjetor i organizatës CDT nga Podgorica.	Dokumenti: <i>Ekstrakt nga raporti i CDT</i>

INFORMIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE I OPINIONIT

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata i ka në ueb-faqen e saj dhe/ose në materialet e tjera informacionet e qarta për përqindjen e parave të cilat ndahen për paga, shpenzime administrative dhe shpenzime programore në nivel vjetor	Për dallim nga publikimi i informacioneve për projektet dhe fondet e mbledhura, këtu fillet për shpenzimin. Nuk është e rëndësishme vetëm se sa para kemi mbledhur, por nëse i kemi shpenzuar në mënyrë efektive dhe sipas destinimit. Është e dëshirueshme që raportit juaj të jap një pasqyrë të hollësishme dhe përqindjen e të dalave që ndahen për shpenzimet tuaja programore, në raport me pagat dhe shpenzimet administrative. Po qe se dëshironi të jepni një pasqyrë më të hollësishme të shpenzimeve tuaja, kjo do të ishte e mirëseardhur. Shembulli i raportit të CDT mund të shfrytëzohet edhe këtu (të shikohet faqja e datë e ekstraktit).	Dokumentet: <i>Ekstrakt nga raporti i CDT</i>

Organizata ka auditimin e rregullt vjetor të pavarur financiar rreth afatizmit të saj	Shitëpitë e pavarura të auditimit, me ftesë të organizatës, mund të hartojnë raport i cili do t'i theksojë praktikatat e mira dhe të këqija financiare në organizatë. Ky raport për këtë arsye nuk është vetëm segment i informimit, por edhe segment i kontrollit dhe i zhvillimit të organizatës. Revizioni financiar i tipit të këtyrë megjithatë kërkon shpenzime përkatëse dhe kohë të organizatës. Rezultateja e këtij raporti mund të gjendet edhe në raportin tuaj vjetor.	Dokumentet: <i>Raportet vjetore të anëtarëve të rrjetit SIGN</i>
---	--	---

INFORMIMI I PALËVE TË INTERESUARA DHE I OPINIONIT

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Po qe se mbledhja e fondeve zgjatë për një periudhë më të gjatë kohore, organizata publikon rregullisht sa para i ka mbledhur gjatë tërë asaj periudhe	Kjo është me rëndësi të bëhet në mënyrë që të mos bëhet dyfishimi i fondeve nga ana e donatorit tuaj, në mënyrë që të gjithë donatorët e interesuar ta dinë nëse aksioni i mbledhjes është i suksesshëm apo jo, në mënyrë që opinioni të mund të përcjellë rrjedhën e mbledhjes së fondeve. Ky rekomandim është posaçërisht i dobishëm për të gjithë që mbledhin fonde nga individët dhe kompanitë në një periudhë të gjatë kohore, sepse pikërisht qasja e kështillë mund të sigurojë që donatorët potencialë së bashku me ju të përpiqen për suksesin e mbledhjes së shumës së kërkuar për realizimin e aksionit. Në lidhjen nga baza jonë “on-line”, mund të gjeni udhëzimin se si në mënyrë të thjeshtë ta bëni një prej veglave vizuale më të njohura dhe më interesante për përcjelljen e mbledhjes së fondeve – <i>Termometrin Fundraising</i> .	Shembulli: http://www.brighthub.com/computing/windows-platform/articles/75680.aspx

ZHVILLIMI ORGANIZATIV- RESURSET NJERËZORE DHE MATERIALE DHE KAPACITETET

ZHVILLIMI ORGANIZATIV- RESURSET NJERËZORE DHE MATERIALE DHE KAPACITETET	
Aktiviteti	Udhëzimet
Organizata i planifikon aktivitetet e saj në pajtim me vlerësimin real të kapaciteteve të veta	Me rastin e planifikimit të çdo aktiviteti, organizata kujdeset për atë që aktiviteti t'i kontribuojë misionit dhe vlerave të organizatës, që të ketë kapacitete për ta realizuar dhe se mund të marrë mbështetjen adekuatë financiare dhe mbështetje tjetër për atë aktivitet. Po ashtu, është e rëndësishme të kihet parasysh që aktivitetet mund të përcaktohen ashtu që të sigurojnë edhe zhvillimin e kapaciteteve të organizatës. Udhëzimet se si ta zhvilloni këtë proces, mund t'i gjeni në prezantimin në bazën “on-line”.

Baza “on-line”

Prezantimi:
Trekëndëshi strategjik

Organizata e ka Kuvendin dhe Këshillin Drejtues, anëtarët e të cilit për punën e tyre në këto organe nuk paguhen, të cilët takohen rregullisht, e menaxhojnë organizatën dhe e mbikëqyrin udhëheqjen e organizatës	Udhëheqja dhe menaxhimi në një organizatë do të duhej të ishin të ndara. Përdërsa me udhëheqje merren Kuvendi dhe Këshilli Drejtues, menaxhimi është çështje e drejtorit të organizatës dhe e menaxherëve të saj. Me shumë informacione për këtë dallim, si dhe këshillat se në ç'mënyrë kjo të kthehet në praktikë, mund të gjeni në bazën “on-line” dhe në manualin e Merilin Vajat.
--	--

PDF:
Qeverisja eOJQ-së

ZHVILLIMI ORGANIZATIV- RESURSET NJERËZORE DHE MATERIALE DHE KAPACITETET

ZHVILLIMI ORGANIZATIV- RESURSET NJERËZORE DHE MATERIALE DHE KAPACITETET	
Aktiviteti	Udhëzimet
Të punësuarit në organizatë i kanë kontratat e punës në bazë të të cilave punojnë dhe respektohen plotësisht detyrimet në bazë të legjislationit të punës	Organizatat e konsoliduara kanë të punësuar persona, statusi i të cilëve është zgjidhur përmes kontratës së punës. Organizatat në shumicën e rasteve i përdorin format tashmë ekzistuese të kontratave të punës, të cilat paraprakisht janë harmonizuar me ligjin. Megjithatë, po qe se keni mjete dhe njohuri të duhura, nuk është keq të mendohet për atë që organizata juaj të krijojë formën e saj të kontratës së punës e cila do t'i përgjigjet në masë me të madhe natyrës së organizatës suaj dhe punës të cilën e kryen i punësuari.

Baza “on-line”

Dokument:
Manual për afarizimin financiar, kontabël dhe tatimor për shoqata dhe fondacione në BeH¹

¹ Në shtetet e ndryshme viejnë ligjet pak më ndryshe në këto fusha. Manuali në themel është punuar për legjislationin në territorin e BeH dhe është e nevojshme të merren në konsideratë disa nga udhëzime duke pasur parasysh këtë.

ZHVILLIMI ORGANIZATIV- RESURSET NJERËZORE DHE MATERIALE DHE KAPACITETET

Aktiviteti		Udhëzimet	Baza “on-line”
Të punësuarit në organizatë i kanë përshkrimet e punëve të tyre, kurse udhëheqja udhëhiqet me përshkrimin e punëve me rastin e delegimit të detyrave		Organizatat e konsoliduara ndarjen e tyre të punëve në ekip e shndërrojnë në dokumente – në përshkrim të punëve dhe sistematizim të vendeve të punës. Përshkrimet e punëve rëndom përmbajnë: emërtimin e plotë të pozitës, emërtimet e pozitave të epororëve , emërtimet e pozitave të varësve, listën e punëve të cilat im kryen personi, si dhe listën e kompetencave të nevojshme.	
Organizata bën rregullisht vlerësimin e efektit të punës së të punësuarve të saj		Vlerësimi i efektit të punës bëhet për secilin të punësuar veçmas, ndërsa ka plot sisteme të ndryshme të vlerësimit. Ndarja kyçe e sistemit të vlerësimit është çështje se kush vlerëson. Në disa modele të gjithë të punësuarit vlerësojnë të gjithë, madje edhe epororët e tyre. Në sistemet e tjera respektohet struktura hierarkike.	Dokument: <i>Vlerësimi i efektit të punës</i>

ZHVILLIMI ORGANIZATIV- RESURSET NJERËZORE DHE MATERIALE DHE KAPACITETET

Aktiviteti		Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata ka dhe aplikon politikën lidhur konfliktin e interesit, e cila mbulon edhe temat me rëndësi për raport me donatorë		Politikat e konfliktit të interesit parandalojnë që brenda organizatës të shfaqen situata në të cilat interesi privat apo afarist i ndonjërit nga të punësuarit apo i anëtarëve të organeve të organizatës të zbatohet pas perdes së interesave të organizatës, dhe anasjelltas. Në bazën “on-line” mund të gjeni një prej politikave të “Trag Fondacija” (më parë BCIF) në lidhje me konfliktin e interesit.	Dokument: <i>BCIF, Konflikti i interesit dhe politika e diskrecionit</i>
Organizata mban në mënyrë të rregullt listat e inventarit të pasurisë së saj, i shfrytëzon dokumentet përkatëse me rastin e huamarrjeve dhe e mirëmban pasurinë e saj		Pasuria e cila fitohet ose blihet përmes donacionit në shumicën e rasteve i takon vetë organizatës. Pa marrë parasysh nëse kemi të bëjmë me pasurinë e një vlere të madhe apo të vogël, ndaj pasurisë së tillë duhet të sillmi me vetëdijen se ajo është fituar për nevoja të implementimit të një ideje apo projekti. Për këtë arsye është e rëndësishme që çdo herë t'i kemi listat e rregulluara të inventarit dhe, me rastin e huamarrjes, të nënshkruhen dokumentet përkatëse për t'iu shmanhur rrezikut nga humbja apo harresa e pajisjes dhe e pasurisë. Në bazë, do të gjeni listën se çka do të duhej të parashikonin organizatat e pjekura me procedurat e këtylla.	Dokument: <i>Procedurat e aseteve materiale</i>

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCEVE DHE ADMINISTRATËS

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata i njeh dispozitat ligjore dhe i respekton në punën e saj	Njerëzit në organet udhëheqëse duhet ta njohin kornizën ligjore të shtetit të tyre. Para së gjithash, duhet të njihet ¹ : • Ligji për shoqatat apo OJQ • Ligji për fondacionet dhe ato të bamirësisë • Dispozitat tatimore • Kërkesat ligjore në lidhje me kontabilitetin dhe afarizmin financiar	Dokumenti: <i>Udhërrëfyes për fondacione dhe fonde bamirësi, Udhërrëfyes për shoqata</i>
Organizata ua paraqet rregullisht raportet vjetore financiare institucioneve përkatëse shtetërore	Secila organizatë ka për detyrë që shtetit t'i paraqesë raport të rregullt vjetor , në shumicën rasteve në formë të bilancit të gjendjes dhe të suksesit Ky aktivitet u lihet shtëpive të kontabilitetit. Organizatat e pjekura kanë menaxhmentin financiar, i cili bashkëpunon ngushtë me shtëpitë e kontabilitetit, përcjellë punën e tyre në këtë raport, bën kontrollin dhe këshillimin me rastin e hartimit të këtij raporti.	Dokumenti: <i>Udhërrëfyes për shoqata</i>

¹ Secili shtet i ka ligjet përkatëse në fushat e theksuar dhe ka mundësi të ketë emërtime të ndryshme të këtyre ligjeve nga shteti në shtet.

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCEVE DHE ADMINISTRATËS

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata harton planin e shpenzimeve para se të fillojë mbledhjen e fondeve	Para se të nisë me mbledhjen e fondeve, organizata duhet të përcaktojë buxhetin e saktë dhe shumën e gjithëmbarshme që është e nevojshme të mblihet për aksionin përkatës. Në këtë mënyrë paraprakisht vendosen rregullat e lojës dhe sigurohet qëdonatori potencial ta dijë saktësisht se cilat shpenzime dhe në çfarë shume i financon. Baza “on-line” ofron një pjesë të <i>Manualit për organizatat joqeveritare</i> , në botim të Qendrës Rajonale për mjedis/ambient jetësor për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) dhe Zyra për Bosnjë dhe Hercegovinë (REC BiH).	Dokumenti: <i>Hartimi i buxhetit</i>

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCEVE DHE ADMINISTRATËS

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCEVE DHE ADMINISTRATËS		
Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Me rastin e hartimit të buxhetit, organizata mbledh të dhëna për çmimet reale në treg dhe i përfshinë në buxhet	Hapi i parë është që të parashikohen të gjitha shpenzimet e nevojshme. Sa u përket pagave dhe shpenzimeve administrative, organizatat e pjekura do të mbështeten në planin e tyre vjetor buxhetor dhe do të caktojnë edhe përqindjen e cila është e nevojshme për projektin konkret. Organizatat më të vogla duhet të parashikojnë mënyrën e angazhimit dhe shumat përkatëse për paga. Sa u përket shpenzimeve programore, kini kujdes për mundësitë dhe kërkesat e donatorëve – fondet nga BE dhe Qeveria Amerikane janë të lira nga TVSH. Donatorët dhe përfituesit mund të jenë të sigurt se paratë i shpenzojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe efikase.	Dokumentë: <i>Hartimi i buxhetit</i>

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCEVE DHE ADMINISTRATËS

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCEVE DHE ADMINISTRATËS		
Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata kujdeset që shpenzimet materiale të vetë mbledhjes së fondeve të mos jenë dis-proporcionalisht të mëdha në raport me shumën e mbledhur (minimium në 1 euro të investuar në mbledhjen e fondeve, të fitohen 2 euro për zhvillimin e aksionit)	Shpenzimet e mbledhjes së fondeve janë mjaft të ulëta kur këtë e bëjmë përmes shkrimit të projekteve për donatorë ndërkombëtarë, donatorë vendorë dhe sektorin publik. Megjithatë, kur i mbledhim fondet nga individët dhe kompanitë, atëherë hyjmë në mini-kompani për mbledhjen e fondeve, që mund të kushtojë mjaft. Shembulli ekstrem është si në vijim: organizimi i koncertit me grupe muzikore jashtëzakonisht të shtrenjta mund të tërheqë numër jashtëzakonisht të madh të njerëzve, mirëpo shpenzimet mund të jenë shumë më të mëdha se shumata që do të mund ta mbledhim nga shitja e biletave. Reklammat në stacionet nacionale TV mund të jenë po ashtu tepër të shtrenjta në raport me shumën që do të mbledhim. Në bazën “on-line” do të gjeni se si organizata e cila merret me monitorimin e mbledhjes së fondeve në Amerikë i mbledh dhe paraqet këto të dhëna, para se gjithash duke i mbrojtur donatorët dhe përfituesit në këtë proces. Pasqyrën e teknikave të mbledhjes së fondeve mund ta gjeni në tekstin e Marija Mitrovic në platformën <i>Ēikiv</i> .	Shtojcë 1: http://www.charitynavigator.org/index.cfm?bay=topten.detail&listid=10#.VhZ-HrxYndQ Shtojcë 2: http://wikiciv.org/rs/index.php/Prikupljanje_i_raspodelaganje_resursima

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCVE DHE ADMINISTRATËS

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata e ka dhe e përdorë llogarinë rrjedhëse; për çdo projekt të saj organizata ka llogari të posaçme rrjedhëse	Është e dëshirueshme që për çdo aksion të mbledhjes së fondeve dhe çdo projekt organizata të hap llogari të veçantë. Në këtë mënyrë i siguroni vetës përcjelljen më të lehtë të shpenzimeve, por po ashtu i siguroni edhe donatorët dhe e evitoni dyshimin se keni burime të dyfishta të financimit apo që me një shpenzim të arsyetoni sasinë më të madhe të parave tek më shumë donatorë.	
Organizata ka dhe i respekton procedurat që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe udhëheqjen e financave	Kemi të bëjmë me procedurat të cilat rregullojnë se kush janë personat përgjegjës, cilat janë veprimet me rastin e planifikimit të buxhetit dhe shpenzimit të parës në organizatë, të raportimit dhe arkivimit të dokumentacionit dhe punë të tjera. Për organizata të madhësive të ndryshme është e domosdoshme të përpunohet qasja e ndryshme në përkufizimin e mënyrave të kryerjes së punëve. Megjithatë, parimet kyçe mbesin të njëjta – përgjegjësia në planifikim dhe shpenzim, mundësia e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm duhet të ekzistojë, qasja në të gjitha informacionet është e siguruar.	Dokumenti: <i>Manual për afarizmin financiar, kontabël dhe tatimor për shoqata dhe fondacione në BeH</i>

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCVE DHE ADMINISTRATËS

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata e organizon veprimtarinë e saj financiare ashtu që të jetë në gjendje që mbi baza mujore t'i përcjellë të hyrat dhe të dalat e saj	Në organizatat e mëdha është me shumë rëndësi që të keni mundësinë që të dini në çdo moment se çfarë është gjendja juaj financiare – sa para keni në llogaritë tuaja dhe të gatshme, sa kërkesa dhe borxhe keni, sa para pritni nga donatorët nga kontratat e nënshtruara, por ende të papaguara. Në këtë mënyrë siguroni edhe planifikim dhe reagim më të mirë ndaj rrethanave të paparashikueshme, e po ashtu edhe e thjeshtoni procesin e shpalljes së këtyre informacioneve.	

ZHVILLIMI ORGANIZATIV - MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA E FINANCVE DHE ADMINISTRATËS

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata ka sistem dhe procedura sipas të cilave i realizon të gjitha furnizimet e saj, duke siguruar që më shumë se një person t'i nënshkruaj urdhëresat	Organizatat e mëdha do të duhej të siguronin që më së paku dy persona, në disa raste edhe tre, t'i nënshkruajnë urdhëresat për pagesë dhe të bëjnë kontrollin nga këndi i përgjegjësisë së tyre. Në organizatat e madhësisë mesatare këta mund të jenë, bie fjala, menaxheri financiar dhe drejtori, kurse në organizatat e mëdha mund të jetë ky edhe një person, siç është koordinatori i programit. Sa më e madhe të jetë shumta e furnizimit, procedurat e furnizimit duhet të jenë më rigorozë, për të siguruar që opinioni të dijë se i shpenzimet në mënyrë efektive fondet e tyre. Për këtë arsye një numër i donatorëve për furnizime më të mëdha kërkon shpalljen e tenderëve dhe/ose marrjen e së paku tri ofertave, kurse organizatat e mëdha e kanë limitin përtej të cilit është i domosdoshëm miratimi i Këshillit Drejtues për shpenzim (kjo mund të jetë kërkesë edhe për blerje e tipit të caktuar – bie fjala, me rastin e blerjes së patundshmërisë, të automjeteve apo angazhimit të avokatit). Kërkesat e tilla i parashtron edhe BE-ja përmes të tëashtuajturit PRAG të rregullave të programeve të tyre (shiko lidhjen në bazën “on-line”).	Shtojcë: http://ec.europa.eu/europeaid/prag/?header_description=DEVCO+Prag+to+financial+and+contractual+procedures+applicable+to+external+actions+financed+from+the+general+budget+of+the+EU+and+from+the+11th+EDF&header_keywords=ePrag%20+europa

MONITORING I EVALUACIJA

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata e ka të zhvilluar sistemin e monitorimit dhe evaluimit që shërben për atë që të përcillet implementimi i aktivitetëve të projektit dhe realizimi i projekteve dhe iniciativave	Monitorimi dhe evaluimi në një mënyrë fillojnë që nga zhvillimi i iniciativës sonë. Në të vërtetë, nevojitet që në fillim të përcaktohet gjendja, pozita e grupeve tona përfutuese dhe çështjet e tjera me rëndësi për iniciativën tonë. Pastaj, nevojitet që të përcaktohet se çka saktësisht duam të arrijmë. Këtu kemi të bëjmë me indikatorët dhe objektivat. Monitorimi dhe evaluimi do t'i përfshijnë veglat me të cilat përcjellim dhe masim ndryshimin që shfaqet në sajë të projektit tonë. Teksti nga platforma <i>Wikiciv</i> do t'u udhëheq më së miri nëpër detajet e këtij procesi.	Shtojcë: http://wikiciv.org.rs/index.php/Monitoring_i_evaluacija
Organizata e ka të zhvilluar sistemin e vlerësimit të efektit të aktivitetit në ndryshimet dhe zhvillimin që dëshirojnë të arrijnë në shoqëri	Shumë ngjashëm me aktivitetin paraprak, mirëpo këtu është me rëndësi të theksohet edhe një këshillë – gjatë zbatimit të aktivitetit kërkoni në mënyrë aktive rrëfime të suksesit. Shembull i mirë i suksesit është shpesh prijës i rëndësishëm edhe për punën e ardhshme të organizatës, si dhe për pritjet e ardhshme të përfutësve dhe donatorëve. Udhërrëfyes i shkëlqyeshëm i përkohësimit të kësaj kulture të ndërtimit dhe i tregimit të rrëfimeve reale është ueb-faqja http://nonprofit-storytellingconference.com .	Shtojcë: http://nonprofit-storytellingconference.com

MONITORING I EVALUACIJA

Aktiviteti	Udhëzimet	Baza “on-line”
Organizata angazhon shtëpinë e pavarur e cila vlerëson suksesin e aktivitetit të projektit dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve të mbledhura	Organizatat më me përvojë dhe më të mëdha kanë shpesh aktivitete komplekse, rezultatet e të cilave ka mundësi të maten, por ekziston nevoja që të fitohet leximi neutral i këtyre rezultateve. Për këtë nevojë angazhohen evaluuesit neutralë. Detyrë e evaluuesit neutral nuk është që t'ua thotë se jeni të mirë ose të këqij. Ai nuk është këtu për t'u vlerësuar. Evaluuesi ua thekson atë që e bëni mirë, e që do të mund të ishte edhe më mirë. Evaluimi i pavarur u nevojitet juve. Me këtë rast, mund të bëni ndaras evaluimin e vet procesit të mbledhjes së fondeve dhe të procesit të implementimit të projektit tuaj.	Shtojcë: http://wikiciv.org.rs/index.php/Monitoring_i_evaluacija

Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore në Manual: Autori dhe botuesi vlerësojnë nevojën për përdorim të gjuhës së ndjeshme gjinore. Të gjitha termat e përdorura në gjininë gramatikore mashkullore në këtë dokument kanë të bëjnë pa diskriminim ndaj grave.



Fond za aktivno građanstvo



SIGN
for
Sustainability



The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

This publication has been produced with the assistance of the European Union. The contents of this publication are the sole responsibility of Trag foundation and can in no way be taken to reflect the views of the European Union